



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ", GJIROKASTËR

RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë

Master Profesional

në

"Mësues në Arsimin Special"

Grupi i Vlerësimit të brendshëm:

- | | | |
|------------------------------|---------|--|
| 1. Prof. Asoc. Mimoza ÇARKA | Kryetar | |
| 2. Dr. Loreta MAMAN | Anëtar | |
| 3. Dr. Zhuljeta LILO | Anëtar | |
| 4. Msc. Aida SOTIRI | Anëtar | |
| 5. Flutura MULLAI (studente) | Anëtar | |

Shtator/2023



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Përshkrim përmbledhës; (200 -400 fjalë)

Programi i studimit *Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special"*, është program i ciklit të dytë të studimit, koha e plotë, me 120 ECTS, pjesë e programeve të studimit të Njesisë Bazë të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies. Programet e studimit në Njësine Bazë të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies kanë nisur qysh në vitin 1981.

NJBEMM është pasardhëse e Katedrës së Pedagogjisë dhe Psikologjisë e krijuar në vitin 1981, vit ku Instituti i Lartë Pedagogjik 3-vjeçar i themeluar në vitin 1971, me Vendim të Këshillit të Ministrave, shndërrohet në Institut të Lartë Pedagogjik 4-vjeçar. Në vitin akademik 1981-1982 hapet për herë të parë dega CIKLI I ULËT klasa 1-4 të arsimit 8-vjeçar. Hapja e kësaj dege ishte e një rëndësie shumë të veçantë, se për herë të parë u përgatitën mësues të arsimit fillor me diplomë universitare.

Me VKM Nr. 414, datë 12.11.1991, mbi bazën e ILP "Eqrem Çabej" në Gjirokastrë krijohet Universiteti i Gjirokastrës, me tri fakultete:

1. Fakulteti i Shkencave Natyrore, me degët Matematikë-Fizikë dhe Biologji-Kimi.
2. Fakulteti i Shkencave Shoqërore, me degët Gjuhë-Letërsi dhe Histori-Gjeografi.
3. Fakulteti i përgatitjes së mësuesve të Ciklit të Ulët.

Gjatë viteve 1991-2007 ka funksionuar Fakulteti i Edukimit me dy seksione:

1. Seksioni i Pedagogji-Psikologjisë; 2. Seksioni i Arsimit Parashkollor.

Bazuar në Ligjin Nr. 9741, datë 21.05.2007, i ndryshuar, "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", me Vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. 823, datë 05.12.2007, krijohet Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore. Pjesë e Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore u bë dhe Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies sot Njësia Bazë e Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies (NJBEMM).

Futja e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore në procesin e Bolonjës solli sfida të reja për t'u përballuar. Kështu, u hartuan modalitetet e programeve të studimit në Bachelor në "Mësuesi për Arsimin fillor Kl.1-6" dhe Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" me parametrat e Sistemit të Bolonjës. NJBEMM në përpjekje të vazhdueshme për përshtatje me tregun e punës në vitin akademik 2018-2019, hap për herë të parë programin i ciklit të dytë të studimit *Master Profesional në "Mësuesi Ndhmës në Edukimin Gjithëpërfshirës"*, me kohë të plotë, me 60 ECTS, me Urdhër Nr. 452, MASR, datë 25. 07.2018 "Për hapjen e programit të ciklit të dytë të studimit *Master Profesional në "Mësuesi Ndhmës në Edukimin Gjithëpërfshirës"* në Universitetin "Eqrem ÇABEJ" Gjirokastrë. Duke studjuar hapësirat ligjore të Ligjit të Arsimit të Lartë dhe ndryshimet në Kurrikulën e Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë u bë e mundur hartimi i programit të studimit me një kurrikul, që do të plotësonte të gjitha boshllëqet që kishin tashmë në treg mësuesit ndihmës, të emëruar si pjesë ndihmëse në edukimin e fëmijëve me aftësi ndryshe në kuadrin e edukimit gjithëpërfshirës.



Gjatë kësaj periudhe në këtë program studimi pati një interes shumë të madh për të ndjekur këtë program studimi nga viti në vit. Numri i studentëve të diplomuar nga viti 2018 deri në vitin 2022 është 247. Pjesa më e madhe e tyre sot janë mësues ndihmës në institucionet e Arsimit Parauniversitar në shumë rajone të Shqipërisë.

Mbështetur në shkresën Nr. 5280 Prot. datë 28.09.2021 “Për riorganizimin sipas ligjit të një programi të ciklit të dytë të studimit në fushën e mësuesisë”, në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë”, Neni 83 “Programet e studimit në fushën e mësuesisë”, Programi i ciklit të dytë të studimit *Master Profesional në “Mësuesi Ndihmës në Edukimin Gjithëpërfshirës”*, me kohë të plotë, me 60 ECTS, riorganizohet mbi masën 20%, të shprehur me kredite në *Master professional në “Mësues në Arsimin Special”*, me kohë të plotë, me 120 ECTS, me 4 (katër) semestra, 2 (dy) vite akademike, Njësia Bazë e Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies, Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, Universiteti “Eqrem ÇABEJ”, Gjirokastër.

Programi i ciklit të dytë të studimit ofron zgjerimin dhe thellimin në mënyrë më specifike dhe inovatore të njohurive teorike dhe praktike në fushën e edukimit gjithëpërfshirës të fëmijëve me aftësi ndryshe/nevoja të veçanta/vështirësi në të nxënë të marra në formimin e tyre të përgjithshëm.


Programi është riorganizuar e zhvilluar në mënyrë të tillë, që të mundësojë zhvillimin e aftësive, shprehive dhe kompetencave për çështje të ndryshme dhe të pashkelura në institucionet e arsimit parauniversitar si dhe në qendrat e edukimit të trajtimit special. Programi gjithashtu ofron dije të avancuara në fushën e kërkimit shkencor, duke i aftësuar studentët të njohin, kuptojnë dhe integrojnë në punën e tyre, gjetjet e studimeve bashkëkohore në këtë fushë, të ndërmarrin studime aktuale në kontekstin shqiptar dhe të transmetojnë këto gjetje në punën e tyre në grupet e interesuara.

Nëpërmjet këtij programi studentët do të kenë mundësinë për të punuar mësues ndihmës në institucionet e arsimit parauniversitar apo në qendra të specializuara për fëmijë me vështirësi në të nxënë/aftësi ndryshe/nevoja të veçanta në pozicione të ndryshme mësimdhënëse por edhe drejtuese: mësues, specialist në administratën arsimore në fushën e arsimit, në institucione kërkimore që merren me çështje të edukimit, në qendra ditore dhe qendra rezidenciale si terapist zhvillimi.

Në përfundim të këtij programi të ciklit të dytë të studimi, *Master professional në “Mësues në Arsimin Special”*, me 120 ECTS, studentit do të marrë diplomë:

1. *Diplomë universitare me titull: Master professional në “Mësues në Arsimin Special”*
2. Çdo student do të marrë edhe suplementin e diplomës, ku do të përfshihen detaje të programit akademik që ka ndjekur si dhe vlerësimet akademike.

Nëpërmjet këtij programi do të adresohen aspektet e gjithëpërfshirjes në Sistemin Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, ku të diplomuarit do të specializohen për të kuptuar karakteristikat e veçanta të individëve duke ju qasur atyre në mënyrë shkencore dhe holistike. Roli i mësuesit ndihmës tashmë merr një rëndësi të veçantë për të gjitha vendet e civilizuarra dhe në mënyrë



specifike edhe në sistemin tonë arsimor, i cili shfaq mangësi dhe nuk i përgjigjet cilësisht nevojave të fëmijëve me aftësi ndryshe/nevoja të veçanta/ vështirësi në të nxënë. Programi aftëson të diplomuarit të ofrojnë mbështetje thelbësore në nivel mikro në klasë dhe mbështetje në nivel makro në jetën e tyre në shoqëri me qëllim zvogëlimin e përjashtimit dhe marginalizimit të tyre.

Programi i studimit është hartuar në përputhje të plotë me kornizën ligjore në fuqi, Ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, datë 22.07.2015., VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Larta”, VKM Nr. 879, datë 18.12.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.41, date 24.1.2018”, VKM Nr. 185, datë 25.03.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.41, date 24.1.2018” etj, Statutin e Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër dhe rregulloret institucionale.

Stafi i NJBEMM angazhohet dhe mbështetet gjerësisht në kërkimin shkencor, i cili është vënë në shërbim të rajonit dhe më gjerë, duke realizuar projekte kërkimore të përbashkëta me njësitë vendore, universitete brenda dhe jashtë vendit, në funksion të përditësimit, rifreskimit e zgjerimit të bazës teorike dhe praktike të kurrikulës së studimeve. Në këtë kuadër, modelet bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies të implementuara garantojnë edhe suksesin e këtij programi të ciklit të parë të studimeve, për transformimin rrënjësor të mësimdhënies, në strukturë dhe përmbajtje.

Realizimi me sukses i objektivave kryesore:

1. Hartimi dhe funksionimi i programit të studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Fillor Kl.1-5.
2. Respektimi i standardeve akademike, programi mësimor dhe metodat e mësimdhënies/nxënies.
3. Kapacitete akademike, profesionale dhe logjistike.
4. Infrastruktura bashkëkohore në shërbim të studentëve.
5. Kontrolli i njohurive dhe vlerësimi i studentëve.
6. Kontrolli i vazhdueshëm i performancës së personelit akademik.
7. Shërbimi për grupet e interesit.








[Handwritten signatures]

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM;

Përshkrim përmbledhës; (200-400 fjalë)

Procesi i vlerësimit të brendshëm për programin e studimit **Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”** ka nisur me propozime të Njesisë bazë të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies, si njësi përgjegjëse e këtij programi për akreditim. Ky aplikim është kryer nga Koordinatorja institucionale në sistemin AMS në datën 14.12.2023 dhe është përcjell zyrtarisht pranë ASCAL me shkresën Nr. 1685 Prot, datë 15.12.2022. ASCAL me shkresën Nr. 117/1 prot, datë 06.03.2023 “Konfirmim i aplikimit për akreditimin e 20 programeve të studimit”, ka konfirmuar aplikimin e UGJ dhe nëpërmjet sistemit AMS është dërguar Axhenda e fazës së vlerësimit.

Bazuar në sa më lart, u ngrit GVB me **Vendim Nr.2, datë 04.04.2023** bazuar në propozimin e drejtuesit të Njesisë Bazë të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies me përbërje si mëposhtë:

- | | | |
|------------------------------|---------|---|
| 1. Prof. Asoc. Mimoza ÇARKA | Kryetar |  |
| 2. Dr. Loreta MAMAN | Anëtar |  |
| 3. Dr. Zhuljeta LILO | Anëtar |  |
| 4. Msc. Aida SOTIRI | Anëtar |  |
| 5. Flutura MULLAI (studente) | Anëtar |  |

Grupi mori pjesë në trajnimin me përfaqësuesit të ASCAL të zhvilluar në datën 11.09.2023, ku u njoh me procedurat, dokumentacionin, aspekte e këshilla të tjera të nevojshme për realizimin e procesit.

Në hartimin e raportit grupi i punës ka patur si qëllim të përshkruaj e të nxjerr në pah përmushjen e standardeve të cilësisë, sipas përcaktimeve të Kodit të Cilësisë miratuar me vendimin Nr. 824, datë 24.12.2021.

Ky raport është produkt i një procesi gjithëpërfshirës që ka si qëllim sigurimin e një vlerësimi sa më korrekt dhe të matshëm të përmbushjes së standardeve dhe garantimit të cilësisë së programit të studimit.



Tabela me shkurtime:

Shkurtimi	Emërtesa
AADF	Albanian- American Development Foundation
AMS	ASCAL Managment System – Sistemi i Menaxhimit të ASCAL
ASCAL	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë
NJBEMM	Njësia Bazë e Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies
DSHNA	Drejtorisë së Shërbimeve Ndhimësakademike Administrative
ECTS	Sistemi Evropian i Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve
FESHSH	Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore
IAL	Institucioni i Arsimit të Lartë
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
NJSBC	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
QSHA	Qendra e Shërbimeve Arsimore
RASH	Rrjeti akademik Shqiptar
SSCK	Sektori i Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikilave
UGJ	Universiteti “Eqrem Çabej”,Gjirokastrë
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
MP MNEGJ	Master Profesional në “Mësue ndihmës në edukimin gjithëpërfshirës”
MP MAS	Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”
BA	Bordi i Administrimit
GVB	Grupi i Vlerësimit të Brendshëm
SA	Senati Akademik



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional

Në


“Mësues në Arsimin Special”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Kriteret	Vlerësimi
<p>Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.</p> <p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë (UGJ), ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare. Këto programe studimi synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. Kjo parashikohet në Statutin e Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, (Evidenca I.1. Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni. 2, Neni. 8, Neni.5), si dhe në Zhvillimin strategjik të Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, për periudhën 2020-2025. (Evidenca I.3. Strategjia e zhvillimit të Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, për periudhën 2020-2025, Misioni. fq 8, Vizioni. fq 8).</p> <p>Misioni i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë është të mbështesë prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit, të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë në vend. (Evidenca I.1. Statuti i Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni.8, pika 5; Neni. 5, shkronja d)</p> <p>Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë ofron programe studimi në përputhje me standardet më të larta akademike dhe profesionale, në përgatitjen e profesionistëve në fusha të ndryshme, me qëllim që të përgatisë profesionistë të këtyre fushave që do të çojnë përpara kërkimin shkencor në këto fusha (Evidenca I.1. Statuti i Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni.63, pika 7)</p> <p>Programi i studimit synon jo vetëm të çojë përpara zhvillimin e traditës së Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë në fushat e mësuesisë dhe të edukimit por edhe t’u sigurojë studentëve aftësi akademike, kulturore dhe etike të nevojshme që mund t’i ndihmojë ata të jenë në gjendje të kontribuojnë në shërbim të zhvillimit rajonal dhe kombëtar. (Evidenca I.1. Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni.4; Evidenca I. 9. Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, Neni. 1, Neni. 2, Neni.3)</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>UGJ-ja si institucion i arsimit të lartë ka për mision: të mbështesë prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit. (Evidenca I.1. Statuti i UGJ-së, Neni. 8, pika 5).</p> <p>Programi i studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special” (MPMAS) është hartuar dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e UGJ-së, si dhe fushën e veprimtarisë së tij, të rregulluara edhe në aktet e brendshme të</p>



	<p>tij. (Evidenca I. 1. Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni. 4, Neni. 5, Neni.8; Evidenca I.3. Strategjia e zhvillimit të Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Misioni. fq 8, Vizioni. fq 8; Evidenca I.6. Strategjia e zhvillimit të FESHSH, Misioni Fq.9, Vizioni Fq.9, Prioritetet strategjike Fq.10)</p> <p>UGJ si institucion i arsimit të lartë ka për mision: të mbështesë prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit. Programet e studimit të ofruara nga UGJ, përfshirë dhe programin Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, synojnë ruajtjen e konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. (Evidenca I.1.Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni. 5).</p> <p>Edhe programi i studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special” (Evidenca I.20 Akti i hapjes së programit MP në MNEGJ me 60 ECTS; Evidenca I.20.1 Riorganizimi i MP në Mësues në Arsimin Special me 120 ECTS; Evidenca I.20.2 Miratimi i Riorganizimit nga MAS MPMNEGJ me 60 ECTS në MP në MAS me 120 ECTS), është plotësisht në përputhje me qëllimet dhe misionin e UGJ-së, si dhe me fushën e veprimtarisë së tij. Programi ka si qëllim të ndihmojë studentët të përceptojnë më qartë përmbajtjen e programit të studimit, duke iu dhënë mundësinë të përcaktojnë ritmin gjatë studimeve të tyre. Gjithashtu, ky program studimi synon të specifikojë dhe të përcaktojë qartë disa procedura thelbësore për studimin me qëllim që të arrihet asimilimi sistematik i njohurive dhe zhvillimi sa më i madh i aftësive praktike, duke bërë të mundur që të diplomuarit të jenë të aftë për t’iu përgjigjur nevojave bashkëkohore në drejtim të përgatitjes dhe formimit profesional të mësuesit ndihmës dhe jo vetëm. Programi është riorganizuar e zhvilluar në mënyrë të tillë, që të mundësojë zhvillimin e aftësive, shprehive, kompetencave për çështje të ndryshme dhe të pashkelura në institucionet e arsimit parauniversitar, si dhe në qendrat e edukimit të trajtimit special. Programi gjithashtu ofron dije të avancuara në fushën e kërkimit shkencor, duke i aftësuar studentët të njohin, kuptojnë dhe integrojnë në punën e tyre gjetjet e studimeve bashkëkohore në këtë fushë, të ndërmarrin studime aktuale në kontekstin shqiptar dhe të transmetojnë këto gjetje në punën e tyre dhe në grupet e interesuara. (Evidenca I.9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, Neni1, Neni. 2)</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, është hartuar dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillimin të Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë (Evidenca I.3. Strategjia e zhvillimit të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë 2020-2025, Misioni. Fq.8, Vizioni Fq.8; Evidenca I.6. Strategjia e zhvillimit të FESHSH-së) të Statutit të Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, (Evidenca I.1.Statuti i Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni.62, Neni.63, Neni. 66) dhe Rregullores së Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, (Evidenca I.2. Rregullore e brendshme e Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni.42, Neni. 46, Neni. 50). Programi i studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin special”, është hartuar dhe ofrohet në përshtatje dhe me fushat e drejtimet akademike institucionale.</p> <p>Programi është hartuar në përputhje me misionin e UGJ-së, i cili ka për qëllim të kontribuojë në krijimin, zhvillimin dhe të përcjellë e të mbrojë dijet përmes</p>



	<p>mësimdhënies/mësimnxënies, kërkimit shkencor, si dhe të nxisë e të zhvillojë artet, edukimin fizik dhe sportet; të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë në vend; të ofrojë mundësi të barabarta për të përfitur nga arsimit të lartë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës. Të kontribuojë në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit të shoqërisë dhe në përgatitjen e studentëve për një shoqëri të tillë. (Evidenca I.1.Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Neni.5)</p> <p>Më specifikisht programi i studimit Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special" ka për mision të mundësojë zhvillimin e aftësive, shprehive dhe kompetencave për çështje të ndryshme dhe të pashkelura në institucionet e arsimit parauniversitar si dhe në qendrat e edukimit të trajtimit special. Programi gjithashtu ofron dije të avancuara në fushën e kërkimit shkencor, duke i aftësuar studentët të njohin, kuptojnë dhe integrojnë në punën e tyre gjetjet e studimeve bashkëkohore në këtë fushë, të ndërmarrin studime aktuale në kontekstin shqiptar dhe të transmetojnë këto gjetje në punën e tyre dhe në grupet e interesuara. Programi Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special" ofrohet si një reflektim dhe mbështetje profesionale ndaj ndryshimeve kurrikulare në Arsimin Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë dhe kërkesave të reja të tregut të punës. Studentët pajisen me kompetenca të përgjithshme për jetën dhe punën, zhvillojnë kompetencat e duhura për qasjen ndaj informacionit dhe përpunimin e tij në mënyrë të pavarur. Gjithashtu, programi ka si qëllim të aftësojë studentët për të zgjidhur problemet dhe situatat praktike, si dhe të zotërojnë kompetenca dixhitale. (Evidenca I. 9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special", Neni 2, Neni. 3)</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Programi i studimit <i>Master Profesional "Mësues në Arsimin Special"</i> me 120 (ECTS), është rrjedhojë e riorganizimit të <i>Masterit Profesional në "Mësuesi ndihmës në edukimin gjithëpërfshirës"</i> me 60 ECTS Urdhër Nr.452, datë 25.07.2018 "Për hapjen e programit të ciklit të dytë të studimit "Master Profesional në "Mësuesi ndihmës në edukimin gjithëpërfshirës" Universitetin "Eqrem Çabej", Gjirokastrë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (Evidenca I.20 Akti i hapjes së programit MP në MNEGJ me 60 ECTS; Evidenca I.20.1 Riorganizimi i MP në "Mësues në Arsimin Special" me 120 ECTS; Evidenca I.20.2 Miratimi i Riorganizimit nga MAS i MP MNEGJ me 60 ECTS në MP në MAS me 120 ECTS). Ky riorganizim mbi masën 20 % të shprehur në kredite, mbështetet në shkresën Nr. 5280 Prot. datë 28.09.2021 "Për riorganizimin sipas ligjit të një programi të ciklit të dytë të studimit në fushën e mësuesisë", të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë", Neni 35 "Hapja, mbyllja dhe riorganizimi i programeve të studimit në institucionet e arsimit të lartë", Neni 75 "Programet e ciklit të dytë të studimeve", Neni 76 "Pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve"; Neni 83 "Programet e studimit në fushën e mësuesisë"; Vendimit Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"; Vendimit Nr. 879, datë 18.12.2019, Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, të Këshillit të</p>



Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”; Vendimit Nr. 185, datë 25.03.2021, Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar si dhe Udhëzimit Nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, Kreu IV “Hapja, riorganizimi dhe mbyllja e programeve të studimit”, B “Dokumentacioni dhe procedura për riorganizimin e programeve të studimit mbi masën 20% të shprehura në kredite”, Statutin e Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastë, të miratuar nga MASR urdhër Nr. 328, datë 13.09.2021, Rregulloren e Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër Nr.1092/3 Prot, ndryshuar me vendim Senati Akademik Nr 26, datë 08.09.2020. Programi ka filluar në vitin akademik 2022-2023, me Urdhër Nr. 526, datë 09.09.2022 “Për riorganizimin e programit të studimit të ciklit të dytë nga Master Profesional në “Mësuesi ndihmës në edukimin gjithëpërfshirës”, në Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special” në Universitetin “Eqrem Çabej Gjirokastër, Ministria e Arsimit dhe Sportit. (Evidenca I.20 Akti i hapjes se programit MP në MNEGJ me 60 ECTS; Evidenca I.20.1 Riorganizimi i MP në Mësues në Arsimin Special me 120 ECTS; Evidenca I.20.2 Miratimi i Riorganizimit nga MAS MPMNEGJ me 60 ECTS në MP në MAS me 120 ECTS) Programi është riorganizuar e zhvilluar në mënyrë të tillë, që të mundësojë zhvillimin e aftësive, shprehive dhe kompetencave për çështje të ndryshme dhe të pashkelura në institucionet e arsimit parauniversitar si dhe në qendrat e edukimit të trajtimit special. Programi gjithashtu ofron dije të avancuara në fushën e kërkimit shkencor, duke i aftësuar studentët të njohin, kuptojnë dhe integrojnë në punën e tyre gjetjet e studimeve bashkëkohore në këtë fushë, të ndërmarrin studime aktuale në kontekstin shqiptar dhe të transmetojnë këto gjetje në punën e tyre dhe në grupet e interesuara. Programi Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special” ofrohet si një reflektim dhe mbështetje profesionale ndaj ndryshimeve kurrikulare në Arsimin Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë dhe kërkesave të reja të tregut të punës. (Evidenca I.9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special” Neni 1, Neni 2, Neni 3)

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>UGJ-ja është një institucion i arsimit të lartë i kategorisë Universitete, themeluar në 1971. (Evidenca I.18. Vendimi i hapjes së ILP-së; Evidenca I.18.1. Vendimi mbi krijimin e universitetit "Eqrem Çabej") Institucioni ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike për ofrimin e programit Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special". (Evidenca I.21. Vendim i Akreditimit Institucional periodik)</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special", është program i nivelit 7 sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe është hartuar në përputhje me misionin e UGJ-së, ai ofrohet nga NJBEMM, si pjesë e FESHSH-së. Struktura dhe organizimi i këtij programi studimi është në përputhje me legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë. (Evidenca I. 1.Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 5, Neni.63, Neni 66)</p> <p>Për programin e studimit Master Profesional në "Mësues në Arsimin special", fusha e përgjithshme, shkencë arsimit dhe fusha specifike, është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore. (Evidenca I.6. Plani Strategjik i Zhvillimi të FESHSH, Misioni. Fq.9, Vizioni. Fq.9; Evidenca I.9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Mësues në Arsimin special", Neni. 2, Neni 3)</p> <p>NJBEMM, bazuar në Neni.n 86 të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimin Nr. 310, datë 11.5.2022 "Për Specifikimet dhe Përbajtjen e Kodifikimit të Programeve të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë të Republikën e Shqipërisë" të Këshillit të Ministrave, ka propozuar kodifikimin kombëtar të programit të studimit Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special" dhe është në pritje të aprovimit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS). (Evidenca II.22 Përcjellja në MAS e propozimeve për kodifikimin e programeve; Evidenca I.22.1 Pasqyrimi i propozimeve për kodifikimin e programeve FESHSH)</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special" është një program studimi i ciklit të dytë. Forma e studimeve është me kohë të plotë dhe gjuha e mësimin është në gjuhën shqipe.</p> <p>Programi i studimit Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special", është i organizuar në lëndë mësimore, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program ka kohëzgjatje normale 2 vite akademike dhe një total prej 120 ECTS, ku çdo vit akademik ka 60 pikë krediti dhe një semester 30 pikë krediti. (Evidenca I.4. Rregullore e studimeve UGJ-së, Neni.13, pika 1; Evidenca I.9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në</p>



<p>një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>“Mësues në Arsimin Special”, Neni. 5; Evidenca II.9.1. Plani mësimor Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, viti akademik 2023-2022) Elementet e programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, janë në përputhje të plotë me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 41, datë 24.01.2018, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë". dhe Vendimin Nr. 879, Datë 18.12.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, Datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë” dhe Vendimin Nr. 185, datë 25.3.2021 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, Datë 24.1.2018, “Për Elementet e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, të Ndryshuar. (Evidenca II. 3. VKM Nr. 41, datë 24.01.2018; II.3.1. Evidenca VKM Nr. 879, datë 18.12.2019; Evidenca II. 3.2. VKM Nr. 185, datë 25.3.2021)</p> <p>Pas plotësimit të kushteve për diplomim në përfundim studentit i jepet diplomë Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”. (Evidenca I.2. Rregullore e UGJ-së Neni. 50; Evidenca I.4. Rregullore e studimeve të UGJ-së, Neni. 13, pika 2; Evidenca I.9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, Neni. 5; Evidenca II.5 Modeli i diplomës Master Profesional në “MNEGJ”)</p>
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional “Mësues në Arsimin Special” është brenda profilit të UGJ-së, FESHSH-së dhe të NJBEMM-së. Universiteti, Njësia kryesore dhe Njësia bazë kanë një përvojë shumëvjeçare dhe arritje në fushën e shkencave të arsimit. (Evidenca I. 1. Statuti i UGJ-së, Neni. 4, Neni. 5, Neni. 8; Evidenca I.3. Strategjia e zhvillimit të UGJ-së, Misioni. fq 8, Vizioni. fq 8; Evidenca I.6. Strategjia e zhvillimit të FESHSH, Misioni Fq.9, Vizioni Fq.9, Prioritetet strategjike Fq.10; Rregullore e progrsmit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special” Neni. 2, Neni. 3)</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Programi mundëson monitorimin e punësimit të diplomuarve të vet, nëpërmjet ruajtjes së kontakteve me studentët e diplomuar dhe nëpërmjet krijimit të një data baze për të parë se sa në përshtatje është formimi i të diplomuarve dhe rezultatet e tyre të të nxëniet, me kërkesat e tregut të punës. Një element shumë i rëndësishëm që shërben për të parë dhe analizuar nevojat e studentëve që diplomohen është dhe angazhimi i tyre në modulet e trajnimit që kryen NJBEMM për mësuesit e Arsimit Parauniversitar të shprehura këto në kredite dhe të akredituara nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar. Për koordinimin e trajnimeve në UGJ është ngritur dhe funksionon Qendra e të mësuarit Gjatë Gjithë Jetës (LLL centre) e krijuar si produkt i projektetit për ngritjen e kapaciteteve TEAVET</p> <p>Gjatë periudhës 2017-2020 Universiteti “E. Çabej” Gjirokastrë, ka qenë partner në projektin ndërkombëtar TEAVET. Bazuar në projektin “Zhvillimi i kompetencave të mësuesve për një sistem gjithëpërfshirës të zhvillimit profesional të mësuesve në Shqipëri (TEAVET- ERASMUS+)” universitetet</p>



pjesëmarrëse në project patën si qëllim koordinimin ndërinstucional për zhvillimin profesional të mësuesve në sistemin e arsimit parauniversitar, nëpërmjet trajnimeve të mësuesve. Pjesë e këtij projekti kanë qenë dhe personel akademik nga NJBEMM. Gjatë këtij angazhimi të zbatimit të projektit me partner brenda dhe jashtë vendit personeli akademik i angazhuar u aftësua për përmirësimin e kompetencave didaktike në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, duke përgatitur dhe module trajnimi për zhvillimin e kompetencave të mësuesve për një sistem gjithëpërfshirës të zhvillimit profesional. Këto module të përgatitur edhe nga personeli akademik i NJBEMM u akredituaran nga Komisioni i akreditimit të programeve/moduleve të trajnimit (KAPT), në bashkëpunim me Institutin e Zhvillimit të Trajnimeve (sot ASCAP) në varësi të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Universiteti “EqremÇabej” është agjenci akredituese me të drejtën e trajnimit të mësuesve të arsimit parauniversitar me këto 16 module të akredituara. Personeli akademik pranë NJBEMM ka organizuar trajnimet gjatë vitit akademik 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022 me mësuesët e Arsimit Parauniversitar, të cilët janë pajisur me çertifikatat (me kredite), zyrtarisht nga Universiteti “EqremÇabej”, Gjirokastër. Për koordinimin e trajnimeve në Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër është ngritur dhe funksionon Qendra e të mësuarit Gjatë Gjithë Jetës (LLL centre) e krijuar si produkt i projektit për ngritjen e kapaciteteve TEAVET (Evidenca II.30 Memorandum Marrëveshja për krijimin e qendrës; Evidenca II.32. Modulet TEAVET, Evidenca II. 35 Modulet ASCAP; Evidenca II.35.1 Zhvillimi i trajnimeve me mësuesit e Arsimit Paruniversitar në UGJ). Qendra filloi veprimat në 15.11.2019, në të cilën janë instaluar të gjitha pajisjet dixhitale (të përfituara nga projekti), të nevojshme për procesin e trajnimit. Kjo qendër vazhdon të koordinoj dhe trajnimet e fituara nga Agjencia akredituese Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër, sipas vendimeve të komisionit të akreditimit të programeve/moduleve të trajnimit.

Gjatë periudhës 2019-2023 Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër dhe NJBEMM, ka qenë *project partner* në projektin ndërkombëtar TEComp (Strengthening Teaching Competences in Higher Education in Natural and Mathematical Sciences) të programit erasmus+.

Në kuadër të këtij projekti anëtarë të departamentit morën pjesë në trajnime të vazhdueshme për aplikimin e metodave të reja të mësimdhënies duke përdorur teknologjitë e informacionit dhe komunikimit. Këto trajnime janë kryer si në distancë (online) ashtu dhe me pjesëmarrje fizike në universitetet partnere të cilat pasqyrohen edhe në faqen zyrtare të projektit

Projekt-TeComp, <http://www.tecomp.ni.ac.rs/training-events>

Me vendim Nr.102, datë 20.05.2022 “Për akreditimin e moduleve të trajnimit për agjencinë trajnuese Universiteti i Gjirokastrës”, komisioni i akreditimit të programeve/moduleve të trajnimit vendosi;

1. Akreditimin e 2 (dy) moduleve të aplikuar nga personeli akademik pranë NJBEMM dhe vlefshmërinë e tyre nga data 20.05.20-20.05.2026;



	<p>2. Modulet e trajnimit të akredituara, identifikohen sipas kodeve dhe numrit të krediteve, bashkëlidhur këtij vendimi. [Evidenca II.35 Modulet ASCAP (Vendimi Nr.102, datë 20.05.2022 “Për akreditimin e moduleve të trajnimit për agjencinë trajnuese Universiteti i Gjirokastrës”)]</p> <p>Me vendim Nr.2, datë 13.02.2023 “Për akreditimin e moduleve të trajnimit për agjencinë trajnuese Universiteti i Gjirokastrës”, komisioni i akreditimit të programeve/moduleve të trajnimit vendosi;</p> <p>1. Akreditimin e 5 (pesë) moduleve të aplikuar nga personeli akademik pranë NJBEMM dhe vlefshmërinë e tyre nga data 13.02.23-13. 02.2027;</p> <p>2. Modulet e trajnimit të akredituara, identifikohen sipas kodeve dhe numrit të krediteve, bashkëlidhur këtij vendimi. [Evidenca II.35 Modulet ASCAP (Vendimi Nr.2, datë 13.02.2023 “Për akreditimin e moduleve të trajnimit për agjencinë trajnuese Universiteti i Gjirokastrës”)]</p> <p>(Evidenca II.30 Memorandum Marrëveshja për krijimin e qendrës; Evidenca I.9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, Neni. 3; Evidenca II.32 TEAVET-modulet; Evidenca II.33 Projekti 1. Klasa dixhitale NJBEMM-UGJ; Evidenca II.34 Projekti 2. Ndikimi i personalitetit... NJBEMM; Evidenca II.35 Modulet ASCAP-MAS NJBEMM; Evidenca II.35.1 Zhvillimi i trajnimeve me mësuesit e Arsimin Paruniversitar në UGJ).</p> <p>Prej viti 2020 e në vazhdim NJBEMM dhe personeli akademik kanë kryer një numër të konsiderueshëm trajnimesh me mësuesët e arsimit paruniversitar. Pjesë e këtyre trajnimeve kanë qenë studentët ekzistues dhe studentët e diplomuar në Universitetin e Gjirokastrës.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.


Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit	Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programeve të studimit, marrëdhëniet e bashkëpunimit brenda institucionit rregullohen përmes Statutit dhe Rregullores së Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë dhe janë në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Veprimtaria e Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë drejtohet



<p>nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>e kontrollohet nga autoritetet dhe organet drejtuese të saj, që veprojnë sipas hierarkisë, me kompetenca të përcaktuara në ligjin e arsimit të lartë, në statut, në rregullore dhe në aktet e brendshme vetërregulluese të institucionit. (Evidenca I. 1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Kreu II, III, IV, dhe V; Evidenca I. 2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Kreu II, III, IV dhe V)</p> <p>NJBEMM siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit.</p> <p>(Evidenca I. 1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Nenet 11, 47; Evidenca I. 14. Organograma Universiteti “Eqrem Çabej”; Evidenca I.15. Organograma Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore; Evidenca I. 16. Organograma Njësia Bazë e Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies).</p> <p>Veprimtaria akademike, ndihmës akademike dhe administrativo-financiare e institucionit, pasqyrohet në analizën vjetore institucionale. (Evidenca I. 11. Raporti vjetor viti akademik 2018-2019 i Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë; Evidenca I. 11.2. Raporti vjetor viti akademik 2019-2020 i Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë; Evidenca I. 11.4. Raporti vjetor viti akademik 2020-2021 i Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë; Evidenca I. 11.6. Raporti vjetor viti akademik 2021-2022 i Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë)</p> <p>UGJ-ja për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit mes Njësive Bazë të FESHSH-së: të Historisë dhe Gjeografisë; të Gjuhës Shqipe; të Letërsisë Shqipe; të Gjuhëve të Huaja; të Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit, Grek; dhe nëpërmjet marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, si dhe me universitete partnere.</p> <p>(Evidenca I. 1 Statuti i Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni. 13; Neni. 46. Neni 50; Evidenca I.29 Tabela treguese e angazhimit të personelit akademik NJBEMM për vitin akademik 2020-2021 (PAE dhe PAK); Evidenca I.29.1 Tabela treguese e angazhimit të personelit akademik NJBEMM për vitin akademik 2021-2022 (PAE dhe PAK); Evidenca I.29.2 Tabela treguese e angazhimit të personelit akademik NJBEMM për vitin akademik 2022-2023 PAE; Evidenca I.29.3 Tabela treguese e angazhimit të personelit akademik NJBEMM për vitin akademik 2022-2023 PAK)</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me</p>	<p>Universiteti i Gjirokastrës ka të përcaktuara qartë, në strategjinë e zhvillimit të tij institucional, prioritetet e politikës së tij të bashkëpunimit (Evidenca I. 3 Strategjia e zhvillimit të Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë 2020-2025, Lidhjet komunitare dhe kombëtare fq.31, Roli Ndërkombëtar fq. 32).</p>



<p>institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni ka nënshkruar marrëveshje të ndryshme bashkëpunimi. (Evidenca I.23. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë; Evidenca I. 24. Lista e projekteve të Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë; Evidenca I.25. Lista e mobiliteteve të Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë). Njëpërmjet marrëveshjeve, sigurohen marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi ku përfitues janë studentët dhe personeli akademik. Aktivitetet e kryera në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit, pasqyrohen edhe në raportet vjetore institucionale. (Evidenca I. 11. Raporti vjetor Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë viti akademik 2018-2019; Evidenca I. 11.2. Raporti vjetor Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë viti akademik 2019-2020; Evidenca I. 11.4. Raporti vjetor Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë viti akademik 2020-2021; Evidenca I. 11.6. Raporti vjetor Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë viti akademik 2021-2022).</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë ka nënshkruar marrëveshje të posaçme për realizimin e praktikave profesionale për programin e studimit. (Evidenca I.23. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë; Evidenca I.31 Marrëveshjet institucionale për praktikat mësimore FESHSH)</p> <p>Për realizimin e programit të studimit Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special", UGJ ka rritur dhe zhvilluar marrëdhëniet zyrtare me Zyrën Arsimore Rajonale Arsimin Parauniversitar Fier, Zyrat Vndore Arsimore të Qarkut Gjirokastrë dhe Bashkinë Gjirokastrë, duke bashkëpunuar me punëdhënësit në lidhje me përfundimin dhe mbikëqyrjen e praktikave mësimore. Studentët gjatë kryerjes së praktikave profesionale mbikëqyren nga personeli akademik i ngarkuar dhe nga mësuesit ndihmës të përgjedor nga marrëveshjet e bashkëpunimit. (Evidenca I. 30. Rregullor për praktikat mësimore/profesionale FESHSH)</p> <p>Ndërkohë, bashkëpunimi me institucionet publike, private, Bashkinë e Gjirokastrës, njësitë administrative, organizatat jo fitimprurëse etj, synon të zhvillohet edhe më tej. Praktika profesionale është pjesë përbërëse dhe shumë e rëndësishme e programeve të studimit në Njësinë Bazë të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies (NJBEMM).</p> <p>Praktika profesionale, bazohet në lidhjen e ngushtë midis universitetit, pushtetit vendor dhe shkollave të Sistemit Parauniversitar, në Republikën e Shqipërisë, si partnerë bazë.</p> <p>Praktika profesionale në Programin Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special" ka një rëndësi shumë të madhe në këtë program studimi, për t'i rritur vlerën cilësore dhe kompetencat praktike çdo student. Ajo është e shtrirë në tetë javë mësimore. Kjo periudhë e studimeve është një moment i rëndësishëm në përfitimin e përvojave të para arsimore të studentëve në punën e klasave gjithëpërfshirëse me fëmijët dhe specifikisht me fëmijët me aftësi</p>

	<p>ndryshe. Praktika profesionale është pjesë e programit lëndor dhe zhvillohet si lëndë me 8 (tetë) ECTS, në vitin e dytë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 4 javë mësimore praktikë profesionale pasive në semestrin e parë, të vitit të dytë • 4 jave praktikë profesionale aktive në semestrin e dytë, të vitit të dytë <p>Qëllimi i praktikës është aftësimi profesional i studentëve nëpërmjet praktikës në institucionet shkollore. Rol të rëndësishëm në këtë periudhë, luan ndihma e mësuesve mentore dhe mësuesve ndihmës të kualifikuara në arsimin gjithëpërfshirës, të cilët i ndihmojnë studentët me karakteristikat individuale, historikun, evidentimin e nevojave që kanë ata, mënyrën si organizojnë ditën mësimore.</p> <p>Studentët do të njohin aspektet dhe problematikat e punës me fëmijët me aftësi ndryshe, familjet dhe psikologjen shkollore. Një praktikë e mirë i pajisë studentët me njohuri për karrierë dhe krijon përvojë reale për kërkesat e përditshme të profesionit që kanë zgjedhur. Kjo do të thotë se studentët do të jenë më të përgatitur për t'u hedhur në tregun e punës. Studentët do të zhvillojnë një sërë aftësish komunikuese dhe praktike me fëmijët dhe grupin e punës (mësuesja e klasës dhe mësuesja ndihmëse). Ato kanë lidhje të drejtpërdrejta me formimin e tyre, me zhvillimin profesional dhe me ushtrimin e profesionit. Në përfundim të praktikës institucionet ku studentët e kryejnë atë vlerësojnë studentët për aftësitë e tyre në periudhën e zhvillimit të praktikës profesionale.</p> <p><i>(Evidenca I. 30. Rregullor për praktikën mësimore/profesionale FESHSH); Evidenca I. 9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special", Neni. 3; Evidenca II.9.2 Plani mësimor Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special, 2022-2023 ;Evidenca II.27.1 Programeve lëndore (syllabuset) të Programit të studimit Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special" viti akademik 2022-2023, 2023-2024)</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Njësia Bazë e Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies (NJBEMM), ku ofrohet programi i studimit Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special", harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p> <p><i>(Evidenca I.28 Raport projekti TeComp; Evidenca I.28.1 Projekti ICT në mësimdhënie; Evidenca I.28.2 Forcimi i kompetencave të mësimdhënies (TeComp); Evidenca I.32 Projekti ENTRAL; Evidenca II.31 Projekti TEAVET; Evidenca II.32 TEAVET-modulet; Evidenca II.33 Projekti 1. Klasa dixhitale NJBEMM-Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë; Evidenca II.34 Projekti 2. Ndikimi i personalitetit... NJBEMM Evidenca II.35 Modulet ASCAP-MAS NJBEMM; Evidenca II. 35.1 Zhvillimi i trajnimeve me mësuesit e Arsimit Parauniversitar në UGJ). Këto të dhëna pasqyrohen edhe në raportet e veprimtarisë mësimore-kërkimore vjetore të NJBEMM, (Evidenca</i></p>



	<i>I.13. Raporte vjetore e NJBEMM, 2018-2019; Evidenca I. 13.1 Raporte vjetore e NJBEMM, 2019-2020; Evidenca I. 13.2 Raporte vjetore e NJBEMM, 2020-2021; Evidenca I. 13.3 Raporte vjetore e NJBEMM, 2021-2022).</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special” është një program studimi i ciklit të dytë. Forma e studimeve është me kohë të plotë dhe gjuha e mësimi është në gjuhën shqipe.</p> <p>Programi i studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special” është i organizuar në lëndë mësimore, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimit. Ky program ka kohëzgjatje normale 2 (dy) vite akademike dhe një total prej 120 ECTS, ku çdo vit akademik ka 60 pikë krediti dhe një semester 30 pikë krediti. (Evidenca I.4. Rregullore e studimeve të UGJ-së, Neni.13, pika 1, pika 3; Evidenca I.9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, Neni. 6, Neni.7, Neni 8; Evidenca II.9.1. Plani mësimori programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, viti akademik 2022-2023)</p> <p>Elementet e programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, janë në përputhje të plotë me udhëzimet e MAS për riorganizimin mbi masën 20 % të shprehur në kredite, mbështetur në shkresën Nr. 5280 Prot. datë 28.09.2021 “Për riorganizimin sipas ligjit të një programi të ciklit të dytë të studimit në fushën e mësuesisë”, të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë”, Neni 35 “Hapja, mbyllja dhe riorganizimi i programeve të studimit në institucionet e arsimit të lartë”, Neni 75 “Programet e ciklit të dytë të studimeve”, Neni 76 “Pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve”; Neni 83 “Programet e studimit në fushën e mësuesisë”; me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 41, datë 24.01.2018, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”. dhe Vendimin Nr. 879, Datë 18.12.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, Datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë” dhe Vendimin Nr. 185, datë 25.3.2021 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, Datë 24.1.2018, “Për Elementet e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, të Ndryshuar. (Evidenca II. 3. VKM Nr. 41, datë 24.01.2018; II.3.1. Evidenca VKM Nr. 879, datë 18.12.2019; Evidenca II. 3.2. VKM Nr. 185, datë 25.3.2021)</p> <p>Pas plotësimit të kushteve për diplomim në përfundim studentit i jepet diplomë Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”. (Evidenca I.2. Rregullore e UGJ-së Neni.50; Evidenca I.4. Rregullore e studimeve të UGJ-së, Neni. 13, pika 1, pika 3; Evidenca I.9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, Neni. 6, Neni 7, Neni 8; Evidenca II.5, Modeli i diplomës Master Profesional në “MNEGJ”; Evidenca I.20 Akti i hapjes së programit MP në MNEGJ me 60 ECTS; Evidenca I.20.1 Riorganizimi i MP në Mësues në Arsimin Special me 120</p>



	ECTS; Evidenca I.20.2 Miratimi i Riorganizimit nga MAS i MPMNEGJ me 60 ECTS në MP në MAS me 120 ECTS)
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, synon të përgatit studentë me një formim profesional i cili u vjen në ndihmë jo vetëm institucioneve në Arsimin Paruniversitar për problemet e ndryshme tek fëmijët me vështirësi në të nxënë dhe jo vetem, për mirëqënien e tyre psikologjike dhe edukimin gjithëpërfshirës. (Evidenca I. 9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, Neni 2, Neni. 3) Programi Master Profesional në “Mësues në Arsimin special” ofrohet si një reflektim dhe mbështetje profesionale ndaj ndryshimeve kurrikulare në Arsimin Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë dhe kërkesave të reja të tregut të punës. Studentët pajisen me kompetenca të përgjithshme për jetën dhe punën si dhe të zhvillojnë kompetencat e duhura për qasjen ndaj informacionit dhe përpunimin e tij në mënyrë të pavarur. Gjithashtu, programi ka si qëllim të aftësojë studentët për të zgjidhur problemet dhe situatat praktike, si dhe të zotërojnë kompetenca dixhitale. Kurrikula e këtij programi studimi mundëson zhvillimin e njohurive, aftësive dhe kompetencave, duke bërë të mundur që studentët të përshtaten me kontekstet e reja në fushën e tyre akademike dhe profesionale.</p> <p>E veçanta e këtij programi studimi qëndron tek aftësitë, shprehjet dhe kompetencat e reja që studentët përfitojnë në qëndrimin e tyre dhe bashkëpunimin me fëmijët me vështirësi në të nxënë dhe fëmijët me problem të ndryshme në formimin e tyre.</p> <p>Nëpërmjet këtij programi studentët do të kenë mundësinë për të punuar mësues ndihmës në institucionet e arsimit parauniversitar apo në qendra të specializuara për fëmijë me vështirësi në të nxënë/aftësi ndryshe/nevoja të veçanta në pozicione të ndryshme mësimdhënëse por edhe drejtuese: mësues, specialist në administratën arsimore në fushën e arsimit, në institucione kërkimore që merren me çështje të edukimit, në qendra ditore dhe qendra rezidenciale si terapist zhvillimi. Mund të punojë gjithashtu në qendra zhvillimi duke qenë pjesëtar i ekipeve multidisiplinare për vlerësimin dhe ofrimin e terapive mbështetëse për fëmijët me nevoja të veçanta, si edhe në institute/qendra kërkimore profesionale të fokusuar në fushën e edukimit gjithëpërfshirës.</p> <p>(Evidenca I. 9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, Neni 2, Neni. 3; Evidenca II.10.1 Programet lëndore (syllabuset) në programin Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special” 2022-2023, 2023-2024)</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Praktika profesionale është pjesë përbërëse dhe shumë e rëndësishme e programeve të studimit në Njësinë Bazë të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies (NJBEMM). Praktika profesionale, bazohet në lidhjen e ngushtë midis universitetit, pushtetit vendor dhe shkollave të Sistemit Parauniversitar, në Republikën e Shqipërisë, si partnerë bazë. Praktika profesionale në Programin Master Profesional “Mësues në Arsimin Special” ka një rëndësi shumë të madhe në këtë program studimi, për t’i rritur vlerën cilësore dhe kompetencat praktike çdo studenti. Ajo është e shtrirë në tetë javë mësimore. Kjo periudhë e studimeve është një moment i rëndësishëm në përfundimin e përvojave të para arsimore të studentët në punën e klasave gjithëpërfshirëse me fëmijët dhe specifikisht</p>



me fëmijët me aftësi ndryshe. Praktika profesionale është pjesë e programit lëndor dhe zhvillohet si lëndë me 8 (tetë) ECTS, në vitin e dytë si më poshtë:

- 4 javë mësimore praktikë profesionale pasive në semestrin e parë, të vitit të dytë
- 4 jave praktikë profesionale aktive në semestrin e dytë, të vitit të dytë

Qëllimi i praktikës është aftësimi profesional i studentëve nëpërmjet praktikës në institucionet shkollore. Rol të rëndësishëm në këtë periudhë, luan ndihma e mësuesve mentore dhe mësuesve ndihmës të kualifikuara në arsimin gjithëpërfshirës, të cilët i ndihmojnë studentët me karakteristikat individuale, historikun, evidentimin e nevojave që kanë ata, mënyrën si organizojnë ditën mësimore. Studentët do të njohin aspektet dhe problematikat e punës me fëmijët me aftësi ndryshe, familjet dhe psikologjen shkollore. Një praktikë e mirë i pajisë studentët me njohuri për karrierë dhe krijon përvojë reale për kërkesat e përditshme të profesionit që kanë zgjedhur. Kjo do të thotë se studentët do të jenë më të përgatitur për t'u hedhur në tregun e punës. Studentët do të zhvillojnë një sërë aftësish komunikuese dhe praktike me fëmijët dhe grupin e punës (mësuesja e klasës dhe mësuesja ndihmëse). Ato kanë lidhje të drejtpërdrejta me formimin e tyre, me zhvillimin profesional dhe me ushtrimin e profesionit. Në përfundim të praktikës institucionet ku studentët e kryejnë atë vlerësojnë studentët për aftësitë e tyre në periudhën e zhvillimit të praktikës profesionale.


(Evidenca I.30 Rregullore e praktikës mësimore/profesionale FESHSH; Evidenca I. 9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special", Neni. 3; Evidenca II.9 .2.Plani mësimor Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special, 2022-2023 ; Programeve lëndore (syllabuset) të Programit të studimit Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special" viti akademik 2022-2023, 2023-2024)

Programi i studimit Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special", është program i nivelit të dytë të studimeve dhe mbyllet me detyrimin përmbyllës (provim i përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome), me 12 kredite në masën 10% të tij.

Programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar është gjithëpërfshirës, me tematika nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit. Programi hartohet nga stafi i njësisë bazë, miratohet nga drejtuesi i NJBEMM, si dhe Dekani i Fakultetit.

Në fillim të vitit të fundit të studimeve NJBEMM asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose punimit të diplomës në respektim të Rregullores së studimeve në UGJ. *(Evidenca I.4. Rregullore e studimeve në UGJ, Nenet 61, 62, 63, 64, 65) dhe shtojcave të kësaj Rregulloreje, Rregullores së programit të studimit Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special", (Evidenca I.9. Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special", Neni 15) dhe Manualit të punimit të diplomës. (Evidenca I.4. Rregullore e studimeve në UGJ: Evidenca III.11. Program i provimit të përgjithshëm përfundimtar Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special"; Evidenca III.11.1. Manuali i punimit të diplomës, Shtojca 1, 2, 3, 4, 5, 6; Evidenca III.11.2 Fushat e punimit të diplomës NJBEMM).*

Udhëheqësi i temës së diplomës përgatit programin e punës së studentit, duke vendosur edhe afatet e përafërta të realizimit të tij. Studenti duhet të respektojë afatet e vendosura




	<p>për të bërë të mundur mbrojtjen me sukses të temës në sezonin normal të mbrojtjes së diplomës. Udhëheqësi përcakton grafikun e konsultimeve të programuara me studentin, përgjatë të cilave konsultohet dhe kontrollohet puna e bërë sipas programit të miratuar. Para mbrojtjes së tezës së diplomës, udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer nga studenti dhe lejon mbrojtjen e punimit duke firmosur tezën e diplomës. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre. Për realizimin e punimit të diplomës zbatohet Manuali i punimit të diplomës, kur student i programit të nivelit të dytë të studimeve plotëon kriteret për punim diplome ose mbyllet me provimin e përgjithshëm. Detyrimi përmbylles (provim i përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome).</p> <p>E gjithë kjo procedurë do të ndiqet për vitin e dytë në vitin akademik 2023-2024. Si rrjedhojë e ristrukturimit të Masterit Profesional nga një vjeçar në dy vjeçar. Gjatë diplomimit të studentëve në Masterin Profesional në “Mësues Ndhmës në Edukimin Gjithëpërfshirës” me 60 ECTS është operuar me provim të përgjithshëm përfundimtar. [ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE, Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E) (Tabela 9)]</p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional “Mësues në arsimin special” me 120 (ECTS), është rrjedhojë e riorganizimit të Masterit profesional në “Mësuesi ndihmës në edukimin gjithëpërfshirës” me 60 ECTS Urdhër Nr.452, datë 25.07.2018 “Për hapjen e programit të ciklit të dytë të studimit “Master Profesional në “Mësuesi ndihmës në edukimin gjithëpërfshirës” Universitetin “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. (Evidenca I.20 Akti i hapjes se programit MP në MNEGJ me 60 ECTS; Evidenca I.20.1 Riorganizimi i MP në Mësues në Arsimin Special me 120 ECTS; Evidenca I.20.2 Miratimi i Riorganizimit nga MAS MPMNEGJ me 60 ECTS në MP në MAS me 120 ECTS) Programi ka filluar në vitin akademik 2022-2023, me Urdhër Nr. 526, datë 09.09.2022 “Për riorganizimin e programit të studimit të ciklit të dytë nga Master Profesional në “Mësuesi ndihmës në edukimin gjithëpërfshirës”, në Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special” në Universitetin “Eqrem Çabej Gjirokastër, Ministria e Arsimit dhe Sportit. (Evidenca I.20 Akti i hapjes se programit MP ne MNEGJ me 60 ECTS; Evidenca I.20.1 Riorganizimi i MP në “Mësues në Arsimin Special” me 120 ECTS; Evidenca I.20.2 Miratimi i Riorganizimit nga MAS i MPMNEGJ me 60 ECTS në MP në MAS me 120 ECTS) Ky riorganizim përmbush plotësimin e nevojave arsimore për mësues ndihmës dhe jo vetëm në mënyrë më të kualifikuar.</p>
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së</p>	<p>Mbështetur në Ligjin e Arsimit të lartë Nr. 80, 2015, Neni 75 (programet e ciklit të dytë të studimit) Pika 6, përcaktohet se programet e studimeve Master Profesional i pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara profesionale në një fushë të caktuar. Këto program organizohen me 60 ose 120 kredite me kohëzgjatje normale për një vit ose dy vite akademike. Studimet e ciklit të dytë Maser Profesional përmbyllet me detyrime përmbyllesë në fushën e arsimit special në rastin e këtij programi studimi. Ky program nuk është program studimi, specifikisht në fushën e mësuesisë që të përmbajë 25% të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik, sepse kurrikula e këtij programi dhe programet lëndore kanë një formim shumë herë më të gjerë të këtij formimi psiko-pedagogjik. (Evidenca I. 9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në</p>



<p>njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>“Mësues në Arsimin Special”, Neni. 3; Evidenca II.9.2 Plani mësimor Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special, viti akademik 2022-2023; Evidenca II.27.1 Programeve lëndore (syllabuset) të Programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, viti akademik 2022-2023, 2023-2024)</p>
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimit i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Forma e organizimit të studimeve në Master Profesional “Mësues në arsimin Special”, është me kohë të plotë e mbështetur në Ligjin e Arsimit të lartë dhe specifikisht në Rregulloren e studimeve të Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë dhe Rregulloren e Programit të studimit Master Profesional “Mësues në Arsimin Special”. (Evidenca I.2. Rregullore e studimeve Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni. 8, Neni. 14, Neni. 18; Evidenca I.9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional “Mësues në arsimin special”, Neni. 6, 7, 8)</p> <p>Rregullorja e Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë dhe Rregullorja e Programit të studimit Master Profesional “Mësues në arsimin special” përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. (Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni.50, Neni. 61, Neni 62, Neni.65; Evidenca I.4.Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Kreu VI -Neni.46, Neni. 47, Neni. 48, Neni. 49, Neni.50; Evidenca I.5. Rregullore e Njesisë Kryesore FESHSH; Evidenca I.9. Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional “Mësues në Arsimin Special”, Neni 9, Neni 10,Neni. 27).</p> <p>Modelet e financimit të studentëve janë dy:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Financimi nëpërmjet bursave dhe 2. Financimi nëpërmjet përjashtimit nga tarifat e studimit. <p>Financimi bëhet për dy kategori. Financimi për studentët me rezultate të shkëlqyera dhe financimi i studentëve përfitues sipas kriterëve të tjera të vendosur nga aktet nënligjore. Në fillimin e çdo viti akademik, realizohen procedurat përkatëse, sipas vendimit të Bordit të Administrimit Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë. (Evidenca II.14. Vendimet e Bordit të Administrimit për bursat dhe mbështetje për kategoritë e veçanta; Evidenca II.14.1. Kategoritë e veçanta që përjashtohen nga tarifat 2019-2020; Evidenca II.14.2. Lista e studentëve me aftësi të kufizuar; Evidenca II.14.3. Vendim Rektorati për heqjen e tarifës në programet e mësuesisë; Evidenca II.14.4. Vendim Rektorati për heqjen e tarifës në programet e mësuesisë; Evidenca II.14.5. Vendim Bordi i Administrimit për heqjen e tarifës për programet e mësuesisë)</p>
<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Programi Master Professional në “Mësues në Arsimin Special” me 120 ECTS ka filluar në vitin akademik 2022-2023, me Urdhër Nr. 526, datë 09.09.2022 “Për riorganizimin e programit të studimit të ciklit të dytë nga Master Professional në “Mësuesi ndihmës në edukimin gjithëpërfshirës”, në Master Professional në “Mësues në Arsimin Special” në Universitetin “Eqrem Çabej Gjirokastrë, Ministria e Arsimit dhe Sportit. (Evidenca I.20 Akti i hapjes se programit MP ne MNEGJ me 60 ECTS; Evidenca I.20.1 Riorganizimi i MP në Mësues në Arsimin Special me 120 ECTS; Evidenca I.20.2 Miratimi i Riorganizimit nga MAS i MPMNEGJ me 60 ECTS në MP ne MAS me 120 ECTS) Ky riorganizim përmbush plotësimin e nevojave arsimore për mësues ndihmës dhe jo vetëm në mënyrë më të kualifikuar. Programii studimit MP MAS, i është referuar programeve të studimit të këtyre fushave të specializuara të Universiteteve publike në</p>



	<p>Shqipëri, si dhe në eksperincat e univeriteteve partnere të vendeve perëndimore. Përmësimi i kurrikulës së këtij programi studimi është tregues i përbushjes së kësaj ngjashmërie në mësën 70%.</p> <p>(Evidenca I.23 Lista e Marrëveshjeve të bashkëpunimit; Evidenca I.24 Lista e projekteve; Evidenca II.8. Planet mësimore Master Profesional në “MNEGJ”, viti akademik 2018-2019; Evidenca II.9.1. Planet mësimore Master Profesional në “MNEGJ” viti akademik 2021-2022; Evidenca II.9.2. Planet mësimore Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special” viti akademik 2022-2023; Evidenca I.9. Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional “Mësues në Arsimin Special”)</p>
<p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special” është program i nivelit 7 sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe është hartuar në përputhje me misionin e UGJ-së, (Evidenca I.1. Statuti i UGJ-së, Nenet 5, Nenet 62, 63, 66)</p> <p>Për programin e studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, fusha e përgjithshme, shkenca arsimit, dhe fusha specifike, Mësues në Arsimin Special është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, (Evidenca I.6. Plani Strategjik i Zhvillimi të FESHSH, Misioni.Fq.9, Vizioni. Fq.9; Evidenca I.9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, Neni. 2)</p> <p>NJBEM-së, bazuar në Neni.n 86 të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimin Nr. 310, datë 11.5.2022 “Për Specifikimet dhe Përmbajtjen e Kodifikimit të Programeve të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë të Republikën e Shqipërisë” të Këshillit të Ministrave ka propozuar kodifikimin kombëtar të programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special” dhe është në pritje të aprovimit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS). (Evidenca II.22 Përcjellja në MAS e propozimeve për kodifikimin e programeve; Evidenca I.22.1 Pasqyrimi i propozimeve për kodifikimin e programeve FESHSH)</p> <p>Pas miratimit të kodifikimit të programeve nga MAS- ja do të vazhdohet me kodifikimin e lëndëve të programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”</p>
<p>Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Programi i ciklit të dytë të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, nuk është program i përbashkët midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, por kurrikulat lëndore janë përmirësuar dhe pasuruar ndër vite duke marrë eksperiencën nga vendet perëndimore. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, përgjegjëse për këtë program studimi është Njësia Bazë e Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies në FESHSH, Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër. (Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Neni. 6, Neni. 18, Neni. 26; Evidenca I.5. Rregullore e FESHSH-së, Neni. 11, Neni. 13; Evidenca I.7. Rregullore e Njesisë Bazë të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies, Neni.6, Neni. 7).</p> <p>Partneritetet midis IAL të huaja dhe vendase ndikojnë në përmirësimin cilësor të përmbajtjes së lëndëve në këtë program studimi, në kompetencat për të nxënë gjatë gjithë jetës e të gjithë fëmijëve pavarësisht vëshirësive në të nxënë, si dhe në përdorimit</p>



	e teknologjisë së informacionit duke nxitur aftësi që mund t'i këmë të paeksponuara. (Evidenca I. 24. Lista e Projekteve; Evidenca I. 25 Lista e mobiliteteve të stafit akademik dhe studentëve në Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore dhe Njësia Bazë e Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies janë përgjegjës për programin e studimit Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special". FESHSH dhe NJBEMM përmbushin, detyrimet ligjore, për organizimin, strukturën akademike, personelin akademike, si dhe vlerësimin e akreditimin.</p> <p>Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore është krijuar me VKM Nr.832, datë 05.12.2007, pika 1, nga ish-Fakulteti shkencave të Edukimit dhe ish-Fakulteti i Shkencave Shoqërore. (Evidenca I.19. Vendim për krijimin e Njesisë kryesore të FESHSH-së)</p> <p>Departamenti i Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies është krijuar me VKM Nr.832, datë 05.12.2007, pika 2, nga bashkimi i ish-departamentit të Shkencave të Edukimit dhe ish-departamentit të Arsimit Parashkollor.</p> <p>Programi i Studimit Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special" ka kaluar në këtë proces vendimesh dhe urdhërash si më poshtë:</p> <p>Programi i ciklit të dytë të studimit Master Profesional në "Mësuesi ndihmës në edukimin gjithëpërfshirës", në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër me 60 kredite , në gjuhën shqipe, forma e studimit me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale një vit (2 semestra) filloi në vitin akademik 2018-2019 me Urdhër Nr.452, datë 25.07.2018 Ministria e Arsimit , Sportit dhe Rinisë.</p> <p>Me Urdhër Nr.526, datë 09.09.2022, MAS "Për riorganizimi e programit të ciklit të dytë të studimit nga "Master profesional" në "Mësuesi Ndhmës në Edukimin Gjithëpërfshirës" në "Master Profesional" në "Mësues në Arsimin Special" në universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, filloi Mastri Profesional në "Mësues në Arsimin Special" me 120 kredite , gjuha shqipe, me kohë të plotë, kohëzgjatja normale 2 vite (4 semestra) në vitin akademik 2022-2023. (Evidenca I.20.1 Riorganizimi i MP MNEGJ në Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special me 120 ECTS)</p> <p>Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore përbëhet nga 6 (gjashtë) departamente, të cilat, bazuar në Nenin.25 të Ligjit Nr. 80/2015 të Arsimit të lartë, kanë në përbërjen e tyre të paktën shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik</p>



	<p>nga të cilët të paktën tre me grada shkencore / tituj akademike, si dhe personel ndihmës akademik. (Evidenca I.1 Statuti i UGJ-së, Nenet 11, pika 3; Evidenca I.5. Rregullore e Njesisë Kryesore FESHSH, Neni. 5, pika b)</p> <p>Njësia Bazë e EMM (Evidenca II.18.1. Lista e stafit akademik dhe ndihmës akademik, NJBEMM), si njësi bazë përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike në mbështetje të misionit të saj. NJBEMM-ja ka në përbërje gjithsej 9 (nëntë) personel akademik ku: 7 (shtatë) personeli akademik me kohë të plotë, me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar, 2 (dy) personeli akademik me kohë të plotë, me kontratë me kohëzgjatje të caktuar. Në këtë përbërje të NJBEMM ka: 1 (një) PAE me titullin akademik Prof. Asos; 2 (dy) PAE me gradën shkencore Dr; 2 (dy) PAE me titullin Dosent; 2 (dy) PAE në proces doktrature; 2(dy) PAE me gradën shkencore “Master i shkencave.</p> <p>Për përmbylljen e të gjitha kurrikulave në planin mësimor ka një angazhim të personelit akademik me kohë të plotë nga Njësia e tjera bazë të FESHSH-së, të cilët mbulojnë lëndë me karakter ndërdisiplinor. NJBEMM-ja është njësi bazë e FESHSH-së që zhvillon veprimtari mësimdhënëse dhe kërkimor-shkencore në fusha të karakterit pedagogji –psikologji, të karakterit artistik e human që aftësojnë mësimdhënës për arsimin parauniversitar dhe jo vetëm. Mbarëvajtja e të gjithë veprimtarive në NJBEMM, kryhet nga bashkëpunimi i drejtuesit të Njesisë Bazë me komisionet ad-hoc dhe personelin akademik. (Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Nenet 11, pika 3; Neni 12; Evidenca I.5. Rregullore e Njesisë Kryesore FESHSH, Neni. 5) [ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE-(Tabela 1)]</p> <p>Njësia Bazë e EMM [ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE-(Tabela 2)],</p> <p>Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë ka marrë akreditimin periodik institucional me Vendim Nr.55, datë 16.12.2021 të Bordit të Akreditimit të ASCAL. (Evidenca I.21. Vendim i Akreditimit Institucional periodik). Në këtë kuadër njësia kryesore FESHSH dhe njësia bazë NJBEMM përmbushin detyrimet ligjore NJBEMM është njësi bazë e FESHSH që zhvillon veprimtari mësimdhënëse dhe kërkimore-shkencore në programin e studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special” duke u mbështetur çdo vit akademik në strukturën mësimore të miratuar dhe në përputhje me aktet ligjore duke parashikuar datën e fillimit, përfundimin e procesit mësimor, si dhe pushimet zyrtare.</p> <p>(Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni. 11, Neni. 12; Evidenca I.5. Rregullore e FESHSH-së, Neni. 10, Neni. 11; Evidenca I.7. Rregullore e NJBEMM-së, Neni. 6; Evidenca I.7. Rregullore e NJBEMM-së, Neni. 6; Evidenca II.28 Struktura mësimore MP MNEGJ 2020-2021; Evidenc II.28.1 Struktura Mësimore MPMNEGJ 2021-2022; Evidenca II.28.1 Struktura mësimore MP MAS 2022-2023)</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit</p>	<p>Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore/Njësia Bazë e Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies përgjegjëse për programin e studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, ka përmbushur detyrimet e përcaktuara</p>




<p>përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel me kohët plotë dhe kohë të pjesshme, me karakter mësimor, për realizimin e praktikave mësimore në programin e studimit Master professional me 60 ECTS për vitet akademike 2020-2021, 2021-2022, e cila është realizuar në semestrin e dytë në 3 javë mësimore, e pasqyruar kjo në planin mësimor. (Evidenca II.8 Plani mësimor i programit të studimit MP MNEGJ 2018-2019; Evidenca II.9.1 Plani mësimor i programit të studimit MP MNEGJ 2021-2022; Evidenca II.9.2 Plani mësimor i programit të studimit MP MAS 2022-2023)</p> <p>Me riorganizimin e programit të studimit nga Master Profesional në “Mësues ndihmës në edukimin gjithëpërfshirës” me 60 ECTS në Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, praktika profesionale në programin e studimit Master Profesional “Mësues në Arsimin Special” realizohet në vitin e dytë e shtrirë në dy semestra (praktikë profesionale pasive 4-javë mësimore dhe praktikë profesionale aktive 4-javë mësimore). Për zhvillimin e saj më mënyrë efektive ngarkohen kryesisht personel akademik me kohë të plotë si përgjegjës të saj dhe mësues ndihmës të institucioneve të Arsimit Parauniversitar. Në këtë program studimi nuk angazhohen personel ndihmës akademik sepse nuk ka specifik të tillë.</p> <p>(Evidenca I.16. Organograma e NJBEMM; Evidenca I.27. Rregullore për punësimin dhe përzgjedhjen e stafit akademik dhe atij administrative në Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë Nenet 7, 8, 9; Evidenca I.30. Rregullore e praktikës mësimore/profesionale FESHSH; Evidenca I.31 Marrëveshjet institucionale për realizimin e praktikave mësimore) [ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE-(Tabelat 1 dhe 2)]</p>			
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>NJBEMM-ja është njësi bazë e FESHSH-së që zhvillon veprimtari mësimdhënëse dhe kërkimor-shkencore në fusha të karakterit psiko-pedagogjikë, të karakterit artistik e human që aftësojnë mësimdhënësit për arsimin parauniversitar (Mësues në Arsimin Special të emëruar si Mësues ndihmës) dhe jo vetëm. Mbarëvajtja e të gjithë veprimtarive në NJBEMM, si dhe ecuria dhe zhvillimi i programit, praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij, kryhet nga drejtuesi i Njesisë Bazë, nga komisionet ad-hoc dhe personeli akademik i NJBEMM.</p> <p>Koordinimi i këtyre përgjegjësive kryhet në takimet mujore të NJBEMM si dhe në Raportet vjetore të NJBEMM.</p> <p>FESHSH/NJBEMM ka një bashkëpunim për ecurin e mësipërme me:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Koordinatorin e institucionit të Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë-së • Sektorin e standardeve dhe cilësisë së kurrikulave. <p>(Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni.6, Neni. 9, Neni. 18; Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Kreu 9; Evidenca I.7. Rregullore e NJBEMM-së, Neni. 4, Neni. 5. Neni. 6; Neni 14; Evidenca I.12. Raporti vjetor i FESHSH-së, 2018-2019; Evidenca I.12.1. Raporti vjetor i FESHSH-së, 2019-2020; Evidenca I.12.4. Raporti vjetor i FESHSH-së, 2020-2021; Evidenca I.12.3. Raporti vjetor i FESHSH, 2021-2022)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Mbështetur në Statutin e UGJ-së, në Rregulloren e UGJ-së, në Rregulloren e studimeve të UGJ dhe në udhëzimet dhe VKM-të e MAS, FESHSH/NJBEMM janë përgjegjëse për programin e studimit, duke disponuar informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit Master Professional në “Mësues në Arsimin Special”. Programi i studimit në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015, me vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, Vendimin Nr. 879, datë 18.12.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, me Vendimin Nr. 185, datë 25.3.2021. Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018, “Për Elementet e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, të Ndryshuarsi si dhe me Statutin e Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër. (Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Neni 63, 66) dhe Rregulloren e Universitetit (Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Neni. 46, Neni. 50) disponon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregulloren e Njesisë Bazë të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies. (Evidenca I.7. Rregullore e Njesisë Bazë të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies). • Misioni i Programit të Studimi Master Profesional në "Mësuesi në Arsimin Special; (Evidenca I.9. Rregulloren e programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, Neni. 2). • Rregulloren e programit të studimeve Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special” (Evidenca I.9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”). • Planin mësimor të programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, (Evidenca II.9. Plani mësimor i programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, viti akademik 2022-2023). • Programet lëndore (syllabuset), (Evidenca II.27 Miratimi i Programeve lëndore (syllabuset) 2022-2023; Evidenca II.27.1. Programeve lëndore (syllabuset) Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, 2022-2023). • Modeli i diplomes Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special” (Evidenca II.5. Modeli i diplomës të MP MNEGJ). • Suplementi i diplomes Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, (Evidenca II.6. Vendimi i Senatit për miratimin e Suplementit, Evidenca II.6.1 Suplementi i Diplomës).



	<ul style="list-style-type: none"> • Struktura mësimore e vitit akademik 2022-2023, (Evidenca II.28.2. Struktura mësimore e programit të studimit MP MAS, viti akademik 2022-2023). <p>Personelin akademik që është i angazhuar në realizimin e programit të studimit MP MAS [ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit (Tabelat 6)]</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Programi i Studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015, me vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, Vendimin Nr. 879, datë 18.12.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, me Vendimin Nr. 185, datë 25.3.2021 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018, “Për Elementet e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, të ndryshuar, në përputhje me Statutin e UGJ-së, ka të hartuar planin mësimor ku janë të përfshira të gjitha informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj. Programi i studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, përmban planin mësimor, i cili hartohet nga njësi bazë dhe miratohet nga Senati Akademik. Në planin mësimor të çdo programi studimi përcaktohen:</p> <ol style="list-style-type: none"> Lëndët e programit të studimit, të ndara sipas kategorive të veprimtarive formuese, si dhe në vite e semestra. Kreditet përkatëse. dhe ka të përfshirë informacionin e mëposhtëm: <ul style="list-style-type: none"> • Format e veprimtarive mësimore (mësim, provime), numri i javëve mësimore sipas semestrave, numri total i provimeve sipas semestrave • Ndarjen e lëndëve mësimore sipas viteve dhe semestrave • Ndarjen e lëndëve mësimore sipas aktiviteteve formuese • Ngarkesën në kredite, numrin total të orëve, numrin e orëve në auditor dhe jashtë auditorit dhe orëve në javë • Komponentët mësimorë për secilen lëndë • Formën e vlerësimit <p>(Evidenca I.4. Rregullore e studimeve UGJ, Kreu 4, dhe 5; Evidenca I.9. Rregullore e studimeve Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, Kreu III; Evidenca II.8. Plani mësimor Master Profesional në “Mësuesi ndihmës në edukimin gjithëpërfshirës”, 2018-2019; Evidenca II.8.1 Vendimet e njësisë bazë për riorganizimin e planeve mësimore; Evidenca II.9. Vendim i SA për riorganizimin e planeve 2021-2022; Evidenca II.9.1 Plani mësimor Master</p>

	<p><i>Profesional në "Mësuesi ndihmës në edukimin gjithëpërfshirës"; Evidenca II.9.2 Plani mësimor Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special", 2022-2023; Evidenca II.3. VKM Nr. 41, datë 24.01.2018; Evidenca II.3.1. VKM Nr. 879, datë 18.12.2019; Evidenca II.3.2. VKM Vendimin Nr. 185, datë 25.3.2021)</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Rregullorja Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër (Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 42, Neni 46, Neni.50, Neni.61, Neni 62, Neni. 65, Neni 66), Rregullorja e studimeve në Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër (Evidenca I.4. Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Kreu VI) dhe Rregullorja e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore (Evidenca I.5. Rregullore e Njesisë Kryesore FESHSH, Kreu IV) përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Kriteret specifike dhe kuotat e pranimit të studentëve, kuotat dhe kriteret e transferimit të studentëve në ciklin e parë të studimit Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special", propozohen nga Njësia Bazë e Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies, në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë, Rregullores së UGJ-së, Statutit të UGJ-së, dhe Udhëzimeve të MASR/MAS. (Evidenca II. 10. Vendimi i SA për kuotat e pranimit 2020-2021; Evidenca II.10.1. Kuotat e propozuara 2020-2021; Evidenca II.11. Vendimi i SA për kuotat e pranimit 2021-2022; Evidenca II.11.1 Kuotat e propozuara 2021-2022; Evidenca II.12. Vendim i SA për kriteret e pranimit 2021-2022; Evidenca II.12.1. Kriteret e pranimit 2021-2022, Evidenca II.13. Vendim i SA për kriteret e pranimit 2022-2023; Evidenca II.13.1. Kriteret e pranimit 2022-2023; Evidenca II.20. Procedura e transferimit të studentëve) Çdo vit akademik, Njësiti Bazë përcjellin për miratim propozimet mbi kriteret dhe kuotat e transferimit të studentëve në UGJ, në funksion të kapaciteteve pritëse dhe akademike, në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë. (Evidenca I.2. Rregullore e studimeve UGJ-së, Neni 21, Kreu VI, Neni. 50, Neni.51, Neni. 52; Evidenca I.9. Rregullore e studimeve Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special", Neni.5)</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programet lëndore (syllabuset) të Programit të studimit Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special" përmbajnë të gjithë elementët e nevojshëm të përcaktuar në VKM Nr.41, date 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë", VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë" dhe Vendimin Nr. 185, datë 25.3.2021 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, Datë 24.1.2018, "Për Elementet e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", të Ndryshuar.</p> <p>Programet lëndore (syllabuset) përgatiten nga titullari i lëndës/lëndëve në përputhje me formatet e miratuara që përmbajnë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Titullari/pedagogu i lëndës (emri, titulli akademik, grada shkencore dhe nënshkrimi); 2. Ngarkesa (numri i krediteve, numri i orëve mësimore në klasë, leksion dhe seminar, praktika etj.);




	<p>3. Viti akademik/semestri kur zhvillohet;</p> <p>4. Lloji i lëndës (e detyrueshme ose me zgjedhje);</p> <p>5. Programi i studimit (programi për të cilin ofrohet kjo lëndë);</p> <p>6. Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës;</p> <p>6. Kodi i Etikës;</p> <p>PËRMBLEDHJA DHE REZULTATET E TË NXËNIT; KONCEPTET THEMELORE (janë konceptet e tema bazë mbi të cilat ndërtohet lënda) TEMAT E LËNDËS (shpjegimi) FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE (Frekuentimi, Kontrolli I vazhdueshëm) LITERATURA (literature bazë e detyrueshme dhe literature e rekomanduar VREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS Çdo pedagog depoziton në njësinë përkatëse para fillimit të vitit akademik programin lëndor (syllabusin) të miratuar. <i>(Evidenca I. 4. Rregullore e studimeve të UGJ-së, Neni.26; Evidenca II.27. Miratimi I Programeve lëndore (syllabuset) të Programit të studimit Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special", viti akademik 2022-2023; Evidenca II.27.1. Programet lëndore (syllabuset) të Programit të studimit Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special", viti akademik 2022-2023).</i></p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Përmbajtja e programeve të studimit Master Profesional fillimisht "Mësuesi ndihmës në edukimin gjithëpërfshirës" me 60 kredite dhe tashmë në "Mësues në Arsimin Special", është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale. Ndryshimet më të mëdha në përmbajtjen e programit të studimit Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special" me 120 kredite kanë ndodhur në periudhën e riorganizimit të masterit Profesional në "Mësuesi ndihmës në edukimin gjithëpërfshirës" me 60 kredite. Mbështetur në udhëzimet e MAS dhe në të Ligjit Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, bazuar në Nenin 71 dhe 75 për organizimin e programeve të studimit. <i>(Evidenca II.7. Vendimi i SA për riorganizimin e planeve Mësimore 2018-2019; Evidenca II.7.1 Dërgimi në MAS vendimit për riorganizimin e planeve 2018-2019; Evidenca II.7.2. Kthim përgjigje nga MAS për riorganizimin e planeve mësimore; Evidenca II.7.3. Konfirmim nga MAS për vënien në dijeni të riorganizimit)</i> Mbështetur në Ligjin e Arsimit të lartë Nr 80, 2015, Neni 75 (programet e ciklit të dytë të studimit) Pika 6, përcaktohet se programet e studimeve Master Profesional i pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara profesionale në një fushë të caktuar.</p> <p>Programi i Studimit Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special" me Urdhër Nr.526, datë 09.09.2022, MAS "Për riorganizimi e programit të ciklit të dytë të studimit nga "Master profesional" në "Mësuesi Ndhmës në Edukimin Gjithëpërfshirës" në "Master Profesional" në "Mësues në Arsimin Special" në universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër ka filluar në vitin akademik 2022-2023. <i>(Evidenca I.20 Akti i hapjes së programit MP në MNEGJ me 60 ECTS; Evidenca I.20.1 Riorganizimi i MP në Mësues në Arsimin Special me 120 ECTS; Evidenca I.20.2 Miratimi i Riorganizimit nga MAS i MPMNEGJ me 60 ECTS në MP në MAS</i></p>



	<p>me 120 ECTS). Programi i studimit në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015, me vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, Vendimin Nr. 879, datë 18.12.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, me Vendimin Nr. 185, datë 25.3.2021, Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018, “Për Elementet e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, të Ndryshuarsi si dhe me Statutin e UGJ-së, ka të hartuar një plan mësimor ku janë të përfshira të gjitha informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p> <p><i>(Evidenca I. 9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, Neni. 3; Evidenca II.9.2 Plani mësimor Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special, 2022-2023 ; Evidenca II.27.1 Programeve lëndore (syllabuset) të Programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, viti akademik 2022-2023, 2023-2024)</i></p> <p>Mbështetur në Vendimin Nr. 185, datë 25.3.2021, Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, Datë 24.1.2018, “Për Elementet e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë” e MAS si dhe në Vendimi Nr. 17, datë 08.07.2021 e Senatit akademik të UGJ-së, “Miratimi i riorganizimit të programeve të studimit për vitin akademik” 2021-2022, janë bërë ndryshime në programin e studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, në masën 20%. <i>(Evidenca II.7. Vendim SA për riorganizimin e programeve të studimit për vitin akademik” 2021-2022; Evidenca II.8 Plani mësimor programit të studimit Master Profesional në “Mësues ndihmës në edukimin gjithëpërfshirës”, 2018-2020; Evidenca II.9.1 Plani mësimor programit të studimit Master Profesional në “Mësues ndihmës në edukimin gjithëpërfshirës”, 2021-2022 Evidenca II.9.2 Plani mësimor programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, viti akademik 2022-2023)</i> Në fillim të vitit akademik në NJBEMM diskutohen përmirësimet e programeve lëndore dhe miratohen ato.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4 Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri I. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive,	Programi i Studimit të Ciklit të dytë Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, ka të përcaktuar emërtimin, përmbajtjen e veprimtarive, duke grupuar



shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.

lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite sipas pikës 2.5 të VKM nr. 41, si dhe VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë” dhe Vendimin Nr. 185, datë 25.3.2021 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018, “Për Elementet e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, të Ndryshuar, në:


- A. Lëndët bazë të ofruara në kategorinë e parë përcaktojnë formimin e përgjithshëm psikologjik, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme si Motivimi dhe produktiviteti, Psikologji zhvillimi e avancuar.
- B. Lëndëtkarakterizuese e ofruara në kategorinë e dytë lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim shkencor mbi Logopedi, Çrregullime dhe terapi e të folurit, Strategji didaktike në edukimin special, Mësimdhënia e diferencuar në edukimin special, Vështirësi në të nxënë-Disleksia, Komunikimi në edukimin special, Metodot psikodiagnostikuese në edukimin special, Terapi profesionale për fëmijë dhe adoleshentë
- C. Lëndët ndërdisiplinore/integruese e ofruara në kategorinë e tretë janë lëndë të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit si: Gjithëpërfshirja në edukimin, Sociologji në edukim, Zhvillim kurrikule, Edukimi qytetar dhe grup-lëndë me zgjedhje. Prej këtyre të fundit, studenti duhet të zgjedhë 1 (nga) nga lëndët e ofruara si lëndë me zgjedhje.
- D. Lëndët plotësuese e ofruara në kategorinë e katërt përfaqësojnë veprimtari plotësuese të fokusuar për njohje të Teknologjisë së informacionit dhe Praktikës profesionale.
- E. Detyrimet përmbyllëse, Detyrime përmbyllëse lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës ose me provimin përfundimtar.

Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave në programin Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, mundësojnë përfitimin dhe pasurimin me njohuri, aftësi dhe për rrjedhojë mundësi punësimi për studentët e Arsim. Special. (Evidenca II.18 Databazë Alumni; Evidenca II.19 Të dhëna statistikore nga Zyra e Alumni; Evidenca II.23 Informacion mbi analizën e përshtatshmërisë së kurrikulave në Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër, faqe 9)

Ky program synon të pajisë me njohuritë bazë, mbi metodat e parimeve shkencore të përgjithshme, dhe formimin e shprehive të veçanta brenda kuadrit të profesionit të edukatorit dhe mësuesit të specializuar, si edhe të disiplinave të ngjashme pedagogjike dhe psikologjike. Kjo ka bërë që studentët në përfundim të programit të studimit në Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special” të jenë në gjendje të zhvillojnë kompetenca të nivelit të lartë në arsimin gjithëpërfshirës, e cili përshtatet me nevojave dhe interesave të tyre, me marrëdhëniet e reja me tregun e




	<p>punës. Në këtë program studimi studenti kupton dhe përvetëson risitë teknologjike, aspiratat e reja njerëzore, si dhe strategjitë për zhvillime arsimi cilësor.</p> <p>Shpërndarja e lëndëve përgjatë dy viteve me veprimtari teorike dhe praktike si dhe praktikës profesionale në vitin e dytë mundëson thellim të njohurive dhe aftësive për studime të më tejshme të studentëve. Studentët që diplomohen në programin e studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, kanë mundësi të vazhdojnë nivele të tjera studimi plotësuese, osë një nivel më lartë. Numri i studentëve në rritje nga viti në vit tregon një interes dhe nevojë të tregut të punës. (Evidenca II. 24. Lista e studentëve në programet e ciklit të dytë të studimit 2022-2023; Evidenca II.24.3. Lista e studentëve në programet e ciklit të dytë të studimit 2020-2021; Evidenca II.24.2. Lista e studentëve në programet e ciklit të dytë të studimit 2021-2022; Evidenca II.24.4. Lista e studentëve në programet e ciklit të dytë të studimit 2019-2020; Evidenca II.24.1 Procedure për ngritjen e komisioneve ad hoc për shqyrtimin e dosjeve në ciklin e dytë; Evidenca II.18 Data bazë Alumni për punësimet e studentëve; Evidenca I.9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, Neni.2, Neni.3)</p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimi profesional duke synuar përgatitjen e mësuesve për arsimin gjithëpërfshirës të aftë për të zhvilluar veprimtarinë mësimore kreative dhe veprimtari gjithëpërfshirëse në institucionet e Arsimi Parauniversitar dhe jo vetëm; përgatitjen e profesionistëve të zotë në mësimdhënie me interes për dijen dhe kërkimin shkencor; orientimin e studentëve drejt një mësimdhënieje sa më të suksesshme, kërkimit didaktik dhe pedagogjik në të gjitha disiplinat shkollore; demonstrimin e gatishmërisë dhe të shkathtësive për zhvillimin e projekteve në institucionet arsimore dhe zhvillimin e shkathtësive për hulumtime në mjedis shkollor dhe më gjerë.</p> <p>Ndarja e orëve mësimore në auditor për leksione, seminare, për çdo lëndë, përcaktohet në planin mësimor të programit të studimit, në bazë të krediteve, që ka secila lëndë. Lëndë të caktuara, në varësi të specifikave, mund të aplikojnë seminare ku trajtohen detyra, ushtrime, projekte kursi për t’i nxitur studentët të bëjnë kërkim në një lëndë të caktuar dhe të jenë të aftë ta prezantojnë atë.</p> <p>Arritja e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultatet e pritshme të të nxënit pasqyrohen në programin e studimit dhe në programin lëndor (syllabuset). Në programin e studimit përcaktohen formimi, përvetësimi i njohurive, aftësive dhe kompetencat të cilat maten me anë të kontrollit të dijes dhe instrumenteve të vlerësimit. Në çdo program lëndor (syllabuse) në rubrikën përmbledhje dhe rezultatet e të nxënit janë të përcaktuara objektivat e lëndës që lënda tenton të arrijë në përfundim të saj, njohuri, aftësi dhe kompetenca që studenti pritet të përvetësojë në përfundim të lëndës.</p> <p>Në rubrikën Forma e kontrollit të dijes, në programin lëndor renditen format e vlerësimit të studentëve të shprehura si përqindje e notës përfundimtare, niveli i</p>




	<p>diskutimit në seminare, koolokium, provimi ndërmjetëm, detyra kursi dhe provimi përfundimtar etj.</p> <p><i>(Evidenca I.9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, Neni.2, Neni.3; Kreu II, Kreu III; Evidenca II.9.1. Plani mësimor i programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, viti akademik 2022-2023; Evidenca II.27.1 Programeve lëndore (syllabuset) të Programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special” viti akademik 2022-2023, 2023-2024)</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Në programin e studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, veprimtaritë formuese, që karakterizojnë këtë program studimi, përbëhen nga komponentët mësimorë, të cilët ndahen në: i) mësim në auditor, si leksione, seminare, lëndë individuale artistike, ushtrime, laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor; ii) studim individual, si studim e punimrelacionesh, detyrash apo projektesh; iii) përgatitje për provime; iv) përgatitje e tezës së diplomës; v) veprimtari të tjera, si praktika profesionale, praktika në terren apo stazh pranë subjekteve publike ose private. Raporti teori praktikë synon të jetë i përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Organizimi i programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special” është hartuar dhe rishikuar në referencë të programeve të ngjashme ndërkombëtare dhe në bazë të sistemit Europian të Transferimit dhe Mbledhjes së Krediteve (ECTS). Kurrikula e programit të studimeve Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special” është organizuar në formë të tillë që studenti të ketë një ngarkesë të njëjtë përgjatë semestrave. Numri i orëve të leksioneve dhe seminareve në pjesën më madhe të programeve lëndore tregojnë që raporti teori/praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme. Ai është organizuar në formë të tillë që studenti të ketë një ngarkesë të njëjtë përgjatë semestrave, mesatarisht 30 kredite për semestër. Raporti i orëve është në pjesën më të madhe 2/2 (2 orë leksion dhe 2 orë seminare), raporti 2/3 (2 orë leksion dhe 3 orë seminare, apo 1/3 (1 orë leksion 3 orë seminar) duke i dhënë rëndësi rritjes së aftësive të studentëve në ushtrimin dhe aplikimin e njohurive teorike të marra në përputhje me profilin e programit. Ngarkesa në kredite për çdo vit akademik është 60 ECTS, një praktikë kjo e njëjtë me programet të ngjashme ndërkombëtare. <i>(Evidenca 1.9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, Kreu III; Evidenca II.9.1. Plani mësimor i programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, viti akademik 2022-2023; Evidenca II.27.1 Programeve lëndore (syllabuset) të Programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, viti akademik 2022-2023, 2023-2024; Evidenca II.6.1 Suplementi i diplomës së programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”; Evidenca II.3.Vendimi Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, pika 2.4, shkronja “a dhe b”).</i> Organizimi i programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar</p>

	<p>professional, sepse kurrikula e përzgjedhur me fusha si: Logopeti, Terapitë e të folurit, Disleksi, Çrregullime në të folur dhe të dëgjuar, Parimet themelore të arsimit gjithpërfshirës, Strategji didaktike, Mësimdhënia e diferencuar, Terapi psiko-diagnostikuese etj, ju japin mundësi studentëve për një formim të thelluar. (Evidenca I.9. Programi i studimit Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special", Neni. 2, Neni. 3; Evidenca II.9.1. Plani mësimor Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special", viti akademik 2022-2023; Evidenca II.27.1 Programeve lëndore (syllabuset) të Programit të studimit Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special" viti akademik 2022-2023, 2023-2024)</p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Natyra e programeve lëndore të ofruara dhe ngarkesa e tyre në ECTS siguron një integrim të aspekteve teorike dhe praktike që jep një lëndë në përmbushje të objektivave formuese të programit. Në mënyrë të vazhdueshme në këtë program studimi atashohen studentë nga IAL të tjera publike dhe jopublike ose, që e zgjedhin këtë program si program të dytë studimi. (Evidenca II.9.1. Plani mësimor Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special", viti akademik 2022-2023; Evidenca II.20. Procedurë e transferimit të studentëve).</p> <p>Ndër vite ka studentë që e zgjedhin këtë program si degë të dytë studimi. Gjithashtu studentët e këtij programi studimi lehtësisht realizojnë transferimin e studimeve në IAL të tjera. Ky raport është i pasqyruar dhe në veprimtaritë formuese të grupuara në kategoritë: lëndë bazë, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese, lëndë plotësuese, detyrime përmblylëse. Raporti midis formimit teorik dhe praktik mundëson punësim në përfundim të studimeve Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special".</p> <p>Nëpërmjet këtij programi studentët do të kenë mundësinë për të punuar mësues ndihmës në institucione të arsimit parauniversitar apo në qendra të specializuara për fëmijë me vështirësi në të nxënë/afësi ndryshe/nevoja të veçanta në pozicione të ndryshme mësimdhënëse por edhe drejtuese: mësues, specialist në administratën arsimore në fushën e arsimit, në institucione kërkimore që merren me çështje të edukimit, në qendra ditore dhe qendra rezidenciale si terapist zhvillimi. Mund të punojë gjithashtu në qendra zhvillimi duke qenë pjesëtar i ekipeve multidisiplinare për vlerësimin dhe ofrimin e terapive mbështetëse për fëmijët me nevoja të veçanta, si edhe në institute/qendra kërkimore profesionale të fokusuar në fushën e edukimit gjithpërfshirës.</p> <p>(Evidenca II. 21.Procedura e transferimeve të studentëve; Evidenca II.9.1 Plani mësimor Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special", viti akademik 2022-2023; Evidenca I.25. Lista e mobiliteteve stafit akademik dhe studentëve në Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë; Evidenca II. 18. Data bazë Alumni për punësimet e studentëve; Evidenca II.23 Informacion mbi analizën e përshtatshmërisë së kurrikulave në Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë)</p> <p>[ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE, Cilësia në hyrje dhe në dalje e</p>



	studentëve (Tabela 21), Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve (Tabela 23)]
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Programi i studimit karakterizohet nga një grup lëndësh të cilat janë përshtatur me qëllimin bazë të tij, duke marr eksperiencën dhe nga universitetet partnere. Syllabuset e programit të studimit përmbajnë të gjitha elementet sipas shtojcës përkatëse të VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, si dhe VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë" dhe Vendimin Nr. 185, datë 25.3.2021 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, Datë 24.1.2018, "Për Elementet e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", të Ndryshuar, duke filluar me pasqyrën informative të lëndës, rezultatet e të nxënies, konceptet themelore, temat e detajuara të lëndës, format e kontrollit të dijeve, frekuentimi, kontrolli i vazhdueshëm, literatura. Çdo pedagog depoziton në njësinë përkatëse para fillimit të semestrit programin lëndor (syllabusin) të miratuar. Para fillimit të lëndës/modulit çdo pedagog ju paraqet studentëve syllabusin e lëndës së bashku me modalitetet e përfshira në të për zhvillimin e mësimin.</p> <p>Pjesa e literaturës në çdo syllabus përbëhet nga literaturë bazë e detyrueshme dhe literatura e rekomanduar. Përditësimi i përmbajtjes së syllabuseve koordinohet nga drejtuesi i departamenteve, i cili njëkohësisht monitoron realizimin e lëndës/modulit në përputhje me syllabusin e miratuar. Botimet e reja të fushave përkatëse të studimit, rezultatet e punës shkencore, integrohen me koncepte të lëndëve përkatëse, ku njohuritë e përvetësuara u paraqiten studentëve për diskutim. Literatura e detyrueshme dhe ajo e rekomanduar në programet lëndore të programit të Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special", është në përshtatje me të rejat bashkohore të kurrikulave të Arsimit Special brenda dhe jashtë vendit, të cilat janë të përqendruar në nxëniet dhe zhvillimin në arsimin gjithëpërfshirës, kryesisht të fëmijëve me aftësi ndryshe, duke siguruar zhvillimin e njohurive të reja dhe të kompetencave, nxënie që janë thelbësore për karrierat akademike të gjeneratave të reja dhe për jetët e tyre në shoqëri. (Evidenca 27.1. Programet lëndore (Syllabuset) e programit të studimit Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special", viti akademik 2022-2023, 2023-2024; Evidenca II.22. Vendimi i Njësisë bazë për miratimin e literaturës bazë të detyrueshme dhe literaturës së rekomanduar, për vitin akademik 2021-2022)</p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special", e organizuar me lëndë bazë, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore, lëndë plotësuese dhe detyrimet përmblyëse, garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për Mësuesit e Arsimit Special. Nëpërmjet këtij programi studentët do të pajisen me metodologji të reja sidomos në fushën e psikologjisë së zbatuar në mësimdhënie, në fushën e motivimit, psikologjisë së avancuar specialitetëve të zhvillimit të fëmijëve me vështirësi në të nxënësi dhe do të thellojnë njohuritë e tyre në disiplina të ndryshme që lidhen me komunikimin, problemeve sociale, Terapive nëpërmjet muzikës dhe artit, duke synuar një mësimdhënie efektive që siguron kompetencat për të nxënësit gjatë gjithë jetës.</p>




	<p>Studentët pajisen me aftësi dhe kompetenca në mënyrë që të përshtatin përvojat mësimore me nevojat dhe interesat e fëmijëve me forma bashkëkohore si të mësuarit nëpërmjet lojës, punës individuale, punës në grupe, mësimit, integritet lëndor, veprimtarive krijuese etj. Gjithashtu, programi i aftëson studentët që në Arsimin gjithëpërfshirës ata t'i kushtojnë rëndësi të veçantë zhvillimit të personalitetit të fëmijëve dhe qëndrimit pozitiv ndaj të nxënit, si bazë për zhvillimin e kompetencës kyçe “Të mësuarit për të nxënë”.</p> <p>Programi synon gjithashtu përgatitjen e specialistëve në fushën e edukimit, mësimdhënies, menaxhimit, organizimit dhe drejtimit të aplikueshme sidomos në arsimin gjithëpërfshirës. Programi do të përgatitë studentë të cilët në përfundim të diplomimit për Mësues në Arsimin Special, do të zbatojnë konceptet bashkëkohore për procesin e të nxënit duke i dhënë përparësi rolin aktiv të fëmijëve në zhvillimin e njohurive të reja dhe të kompetencave si dhe ndryshimin e rolit të mësuesve, të cilët duhet të jenë gjithnjë e më shumë, drejtues dhe krijues të situatave të të nxënit. Rezultatet e të nxënit pasqyrohen në çdo program lëndor (syllabuset) në rubrikën Përmbledhje dhe rezultatet e të nxënit. Rezultatet e të nxënit maten me anë të realizimit të objektivave të lëndës të cilat janë synimet që lënda tenton të arrijë në përfundim të saj, të ndara në njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që student pritet të përvetësojë në përfundim të lëndës.</p> <p><i>(Evidenca I.9. Programi i studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, Neni. 2, Neni. 3; Evidenca II.9.1. Plani mësimor Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, viti akademik 2022-2023; Evidenca 27.1. Programet lëndore (Syllabuset) e programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, viti akademik 2022-2023; 2023-2024)</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, mundëson vijimin e mëtejshëm në programet e ciklit të dytë të studimeve Master Shkencor e më pas programe studimi të nivelit të tretë . Në Njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që studenti përvetëson në përfundim të programit të studimit i japin atij të drejtën për të vazhduar studime të mëtejshme në IAL të tjera brenda dhe jashtë vendit. Në përmbajtjen e programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, janë të pasqyruara ndryshimet e kornizës kurrikulare të Arsimin Paruniversitar në Republikën e Shqipërisë dhe alternativat më në zë të zhvillimit dhe edukimit të fëmijëve me vështirësi në të nxënë, fëmijë ndryshe, fëmijë me talente eyj.</p> <p>Ndryshimet kurrikulare në Arsimin Parauniversitar janë të pasqyruara në këtë program studimi dhe kjo bënë të mundur që studentët të përshtaten lehtësisht me pritshmëritë dhe kërkesat e tregut të punës kryesisht si mësues ndihmës dhe punonjës në institucione të tjera që punojnë me fëmijë me vështirësi në të nxënë. Në përfundim të diplomimit studentët janë të aftë që në procesin e mësimdhënies dhe të nxënit tek fëmijët e Arsimin Parauniversitar: të ndërtojnë dhe të zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkon shoqëria demokratike; të zhvillojnë aftësi të pavarur e të gjithanshme; të kontribuojnë në ndërtimin dhe mirëqenien vetjake dhe të shoqërisë shqiptare dhe të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës.</p>

	<p>Studentët kultivojnë identitetin vetjak, kombëtar dhe përkatësinë kulturore; përvetësojnë vlera të përgjithshme kulturore dhe qytetare; zhvillohen në aspektet intelektuale, etike, fizike, sociale dhe estetike; zhvillojnë përgjegjësi ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit; aftësohen për jetë dhe për punë, në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore; aftësohen për të nxënë gjatë gjithë jetës; zhvillojnë shpirtin e sipërmarrjes; përdorin teknologjitë e reja.</p> <p>(Evidenca I.9. Rregullore e Programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”; Evidenca II.9.1. Plani mësimor Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, viti akademik 2022-2023; Evidenca 27.1. Programet lëndore (Syllabuset) e programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, viti akademik 2022-2023; 2023-2024; Evidenca II. 20. Data bazë Alumni për punësime e studentëve)</p> <p>Evidenca II.24. Lista e studentëve që ndjekin programet e ciklit të dytë të studimeve 2022-2023; II.19 Të dhëna statistikore nga Zyra e Alumni Evidenca II.23 Informacion mbi analizën e përshtatshmërisë së kurrikulave në Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër, faqe 11; [ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE, Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve (Tabela 23)]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, stafi akademik i përfshirë në programin e studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, konsultohet dhe merr parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës. Njësia Bazë e Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies ndjek nga afër ndryshimet cilësore në Kornizën Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, si dhe Kurrikulën Bërthamë për klasën përgatitore dhe Arsimin fillor, duke paraqitur rezultatet e të nxënit për kompetencat kyçe dhe fushat e të nxënit, të cilat janë të detyrueshme për të gjitha shkollat e Republikës së Shqipërisë (publike dhe private). Kompetencat kyçe dhe fushat e të nxënit në Arsimin Special janë pasqyruar në Programin e Studimit të Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, në Planin mësimor, si dhe në programet lëndore (syllabuset), duke bërë të mundur përmirësimin e përmbajtjes në përputhje me kërkesat e shoqërisë së dijes dhe tregut të punës (Evidenca I.9. rregullore e Programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”; Evidenca II.9.2. Plani mësimor Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, viti 2022-2023; Evidenca II.27.1. Programet lëndore</p>



(syllabus) e programit të studimit Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special", 2022-2023, 2023-2024).

Bashkëpunimet me partnerët e brendshëm dhe të jashtëm si dhe angazhimi në disa projekte kombëtare dhe ndërkombëtare nga personeli akademik ka patur një ndikim në përmirësimin cilësor të përmbajtjeve lëndore dhe të teknologjive të reja të mësimdhënies. Në këtë program studimi në hartimin dhe ecurisë së programit të studimit janë marr parasysh që përmbajtja e tij të respektoj frymën globale të edukimit. Përmbajtja e tij ndër vite është përmirësuar duke patur parasysh propozime dhe sygjerime nga institucionet partnere. (Evidenca I.28 Raport projekti TeComp; Evidenca I.28.1 Projekti ICT në mësimdhënie; Evidenca I.28.2 Forcimi i kompetencave të mësimdhënies (TeComp); Evidenca I.32 Projekti ENTRAL; Evidenca II.31 Projekti TEAVET; Evidenca II.32 TEAVET-modulet; Evidenca II.33 Projekti 1. Klasa dixhitale NJBEMM-Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë; Evidenca II.34 Projekti 2. Ndikimi i personalitetit... NJBEMM; Evidenca II.35 Modulet ASCAP-MAS NJBEMM; Evidenca II.35.1 Zhvillimi i trajnimeve me mësuesit e Arsimit Paruniversitar në UGJ)

Programi mundëson monitorimin e punësimit të diplomuarve të vet, nëpërmjet ruajtjes së kontakteve me studentët e diplomuar dhe nëpërmjet krijimit të një data baze për të parë se sa në përshtatje është formimi i të diplomuarve dhe rezultatet e tyre të të nxënit, me kërkesat e tregut të punës. Një element shumë i rëndësishëm që shërben për të parë dhe analizuar nevojat e studentëve që diplomohen është dhe angazhimi i tyre në modulet e trajnimit që kryen NJBEMM për mësuesit e Arsimit Parauniversitar të shprehura këto në kredite dhe të akredituara nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar. Për koordinimin e trajnimeve në UGJ është ngritur dhe funksionon Qendra e të mësuarit Gjatë Gjithë Jetës (LLL centre) e krijuar si produkt i projektit për ngritjen e kapaciteteve TEAVET (Evidenca II.30 Memorandum Marrëveshja për krijimin e qendrës; Evidenca I.32 Projekti ENTRAL; Evidenca II.31 Projekti TEAVET; Evidenca II.32 TEAVET-modulet; Evidenca II.33 Projekti 1. Klasa dixhitale NJBEMM-Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë; Evidenca II.34 Projekti 2. Ndikimi i personalitetit... NJBEMM; Evidenca II.35 Modulet ASCAP-MAS NJBEMM; Evidenca II.35.1 Zhvillimi i trajnimeve me mësuesit e Arsimit Paruniversitar në UGJ)

Qendra filloi veprimtarinë në 15.11.2019, në të cilën janë instaluar të gjitha pajisjet dixhitale (të përfituara nga projekti), të nevojshme për procesin e trajnimit Kjo qendër vazhdon të koordinoj dhe trajnimet e fituara nga Agjencia akredituese UGJ, sipas vendimeve të komisionit të akreditimit të programeve/moduleve të trajnimit.


Gjatë periudhës 2019-2023 Universiteti "E. Çabej" Gjirokastrë dhe NJBEMM, ka qenë *project partner* në projektin ndërkombëtar TECOMP (Strengthening Teaching Competences in Higher Education in Natural and Mathematical Sciences) të programit erasmus+.

Në kuadër të këtij projekti anëtarë të departamentit morën pjesë në trajnime të vazhdueshme për aplikimin e metodave të reja të mësimdhënies duke përdorur teknologjitë e informacionit dhe komunikimit. Këto trajnime janë kryer si në distancë




	<p>(online) ashtu dhe me pjesëmarrje fizike në universitetet partnere të cilat pasqyrohen edhe në faqen zyrtare të projektit. Njëkohësisht për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës Njësia Bazë e Edukimit dhe Metodologjisë së mësimdhënies në bashkëpunim me zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit pranë UGJ është pjesmarrës dhe promovues të programeve të studimit nëpër eventet e ndryshme të zhvilluar në bashkëpunim me maturantët, studentët dhe aktorët tjerë nga tregu i punës, duke ndarë eksperiencat, konsultuar dhe marrë parasysh propozimet e tyre. (Evidenca II.15. Pjesëmarrje në Panair Work and Study 2022; Evidenca II.11.1 Pjesëmarrje në Panair Work and Study 2023; Evidenca II.18. Data bazë Alumni për punësimet e studentëve; Evidenca I. 24. Lista e projekteve; Evidenca I.23 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>UGJ-ja nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre. Studentët janë të angazhuar në Senatit Akademik tëUGJ-së (Evidenca II.1.1 Lista e anëtarëve të Senatit akademik tëUGJ-së). Studentët janë organizuar në Këshillin Studentor, (Evidenca II.25.1. Lista e anëtareve të Këshillit Studentor) dhe kanë statutin e funksionimit të tyre. (Evidenca II.25. Statuti i Këshillit Studentor)</p> <p>NJBEMM me anë të projekteve me fondet e universitetit, ka kryer trajnime edhe për studentet e angazhuar në nivelin e dytë të ciklit të studimeve. Gjatë diskutimeve, por edhe gjatë pyetësorëve në fund të trajnimit është bërë e mundur që personeli akademik të nxitet për përmirësimin e kurrikulave të Arsimit Special.</p> <p>Një rol shumë të rëndësishëm në reflektimin ndaj diskutimeve me studentët apo studentët e diplomuar luan dhe praktika profesionale e cila është pjesë përbërse e programit të studimit e shprehur në kredite dhe e shtrirë në vitin e dytë të Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, Gjatë zhvillimit të praktikës mësimore dhe në përfundim të saj zhvillohen analiza të mirëfillta jo vetëm për aftësimin e studentëve, por dhe për informimin apo reflektime për ndryshimet që ndodhin në konceptin gjithëpërfshirës të Arsimit Special. (Evidenca I.30. Rregullore e praktikave FESHSH; Evidenca I.23. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit, Evidenca I. 24. Lista e projekteve; Evidenca II.9.1. Plani mësimor i Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, viti akademik 2022-2023; Evidenca II.23 Informacion mbi analizën e përshtatshmërisë së kurrikulave në Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër, faqe 9)</p> <p>Njëkohësisht për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës Njësia Bazë e Edukimit dhe Metodologjisë së mësimdhënies në bashkëpunim me zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit pranë UGJ është pjesmarrës dhe promovues të programeve të studimit nëpër eventet e ndryshme të zhvilluar në bashkëpunim me maturantët, studentët dhe aktorët tjerë nga tregu i punës, duke ndarë eksperiencat, konsultuar dhe marrë parasysh propozimet e tyre. Bashkëpunimet me studentët e diplomuar janë edhe fal të drejtës që ka marrë UGJ qysh prej vitit 2020 si agjencie akredituar në një numër të konsiderueshëm modulesh trajnimi. Personeli akademik i angazhuar në NJBEMM ka</p>

	<p>mbajtur dhe mban peshën më të madhe të këtyre trajnimeve. Për koordinimin e trajnimeve në UGJ është ngritur dhe funksionon Qendra e të mësuarit Gjatë Gjithë Jetës (LLL centre) e krijuar si produkt i projektetit për ngritjen e kapaciteteve TEAVET (Evidenca II.30. Memorandum Marrëveshja për krijimin e qendrës; Evidenca II.32. Modulet TEAVET, Evidenca II.35 Modulet ASCAP). Qendra filloi veprimat në 15.11.2019, në të cilën janë instaluar të gjitha pajisjet dixhitale (të përfituara nga projekti), të nevojshme për procesin e trajnimit Kjo qendër vazhdon të koordinoj dhe trajnimet e fituara nga Agjencia akredituese UGJ, sipas vendimeve të komisionit të akreditimit të programeve/moduleve të trajnimit.</p> <p><i>(Evidenca II.15. Pjesëmarrje në Panair Work and Study 2022; Evidenca II.15.1 Pjesëmarrje në Panair Work and Study 2023; Evidenca II.18 Data bazë Alumni për punësimet e studentëve)</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Përmbajtja e programeve të studimit Master Profesional fillimisht “Mësuesi ndihmës në edukimin gjithëpërfshirës” me 60 kredite dhe tashmë në “Mësues në Arsimin Special”, është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale</p> <p>Programi i studimit Master Profesional “Mësues në arsimin special” me 120 (ECTS), është rrjedhojë e riorganizimit të Masterit profesional në “Mësuesi ndihmës në edukimin gjithëpërfshirës” me 60 ECTS, Urdhër Nr.452, datë 25.07.2018 “Për hapjen e programit të ciklit të dytë të studimit “Master Profesional në “Mësuesi ndihmës në edukimin gjithëpërfshirës” Universitetin “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, Ministria e Arsimit , Sportit dhe Rinisë. <i>(Evidenca I.20 Akti i hapjes se programit MP ne MNEGJ me 60 ECTS; Evidenca I.20.1 Riorganizimi i MP në Mësues në Arsimin Special me 120 ECTS; idenca I.20.2 Miratimi i Riorganizimit nga MAS MPMNEGJ me 60 ECTS ne MP ne MAS me 120 ECTS)</i> Programi ka filluar në vitin akademik 2022-2023, me Urdhër Nr. 526, datë 09.09.2022 “Për riorganizimin e programit të studimit të ciklit të dytë nga Master Professional në “Mësuesi ndihmës në edukimin gjithëpërfshirës”, në Master Professional në “Mësues në Arsimin Special” në Universitetin “Eqrem Çabej Gjirokastër, Ministria e Arsimit dhe Sportit. Ky riorganizim përmbush plotësimin e nevojave arsimore për mësues ndihmës dhe jo vetëm në mënyrë më të kualifikuar.</p> <p>Programi i studimit në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015, me vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, Vendimin Nr. 879, datë 18.12.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, me Vendimin Nr. 185, datë 25.3.2021 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018, “Për Elementet e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, të Ndryshuarsi si dhe me Statutin e UGJ-së, ka një plan mësimor ku janë të përfshira të gjitha informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/hajekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>



	<p>(Evidenca II.8 Plani mësitor programit të studimit Master Profesional në “Mësues ndihmës në edukimin gjithëpërfshirës”, 2018-2019; Evidenca II.9. “Miratimi i riorganizimit të programeve të studimit për vitin akademik” 2021-2022; Evidenca II.9.1 Plani mësitor programit të studimit Master Profesional në “Mësues ndihmës në edukimin gjithëpërfshirës”, 2021-2022; Evidenca II.9.2 Plani mësitor programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, viti akademik 2022-2023; Evidenca II.27.1. Syllabuset e programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, Viti akademik 2022-2023, 2023-2024)</p> <p>NJBEMM si Njësia përgjegjëse ka përmirësuar, përditësuar, përshtatur programin e studimit MP MAS, në përputhje me propozimet që personeli akademik ka marr në konsiderat në angazhimet në projekte, konferenca e simpoziume. Këto angazhime dhe bashkëpunime kanë bërë të mundur që personeli akademik me anë të kualifikimeve institucionale dhe individuale të pasqyrojë zhvillimet e fundit në pogramin e studimit MP MAS. Me shumë vlerë kanë qenë dhe bashkëpunimet me rrjete profesionistësh, shoqata dhe brenda vendit, product ky i finalizuar dhe në konferenca të organizuara nga NJBEMM me “Shoqatën e Psikologëve Shqiptarë» dhe Universitetet që kanë Fakultete Mësuesi në Shqipëri. (Evidenca I.25. Lista e mobiliteteve e personelit akademik dhe studentëve në Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë; Evidenca; I.24. Lista e projekteve; Evidenca II.29 Vendim për lëndën Manaxhim projektsh; Evidenca I.23 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë; Evidenca I.28.2 Forcimi i kompetencave te mësimeve (TeComp); Evidenca I.32 Projekti ENTRAL; Evidenca II.31 Projekti TEAVET; Evidenca II.32 TEAVET-modulet; Evidenca II.33 Projekti 1. Klasa dixhitale NJBEMM-Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë; Evidenca II.34 Projekti 2. Ndikimi i personalitetit... NJBEMM; Evidenca II.35 Modulet ASCAP-MAS NJBEMM; Evidenca II.35.1 Zhvillimi i trajnimeve me mësuesit e Arsimit Paruniversitar në UGJ; Evidenca II.36 Konferenca nga NJBEMM)</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6 Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special” ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve duke përfshirë dije, aftësi dhe kompetenca profesionale. Në mënyrë më specifike në përfundim të programit të studimit studentët do të jenë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> Të identifikojnë dhe të kuptojnë karakteristikat specifike dhe veçoritë e secilës formë të nevojave arsimore të veçanta.



- Të hartojnë programe të përshtatshme të ndërhyrjes duke iu përgjigjur në mënyrë efektive gamës së diversitetit dhe nevojave të individëve me nevoja të veçanta.
- Të vlerësojnë ndërhyrjet edukative, të propozojnë dhe të integrojnë të dhëna bashkëkohore në fushën e Edukimit gjithëpërfshirës dhe Trajnimit Special.
- Të përgjigjen ndaj nevojave të ndryshme të të gjithë fëmijëve, të rinjve dhe të rriturve nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes në mësim, në kultura dhe komunitete, si dhe reduktimit e eliminimit të përjashtimit nga arsimi.
- Të mbështesin një sistem të suksesshëm shkollor duke trajtuar diversitetin si burim të zhvillimit potencial dhe pa penguar performancën e natyrshme të nxënësve.
- Të analizojnë dhe të gjykojnë për njohuritë dhe aftësitë e veçanta, duke marrë parasysh të gjithë fëmijët pavarësisht nga gjendja fizike, intelektuale, shoqërore, emocionale, gjuhësore etj.
- Të promovojnë një ambient të përshtatshëm për të gjithë nxënësit dhe të mundësojnë marrëdhënie të përkujdesjes edukative, individuale dhe në grup.
- Të mbështesin çështjet specifike të arsimit gjithëpërfshirës, si p.sh: nevojat për fëmijë me aftësi të kufizuara, me vështirësi në të nxënë, fëmijët e talentuar, dallimet gjinore, dallimet kulturore, etj
- Të shfaqin të kuptuar të avancuar dhe shkathtësi për të ndërvepruar me dinamikat familjare dhe të zbulojnë modalitetet e përfshirjes dhe bashkëpunimit me familjet, komunitetet dhe rrjetet e shërbimeve edukative, sociale dhe shëndetësore.
- Të demonstrojnë shkathtësi pedagogjike në zhvillimin e projekteve në veçanti për Planin Individual të Edukimit.

(Evidenca I. 9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special", Neni. 3)

Në programet lëndore (syllabuset) e këtij programi studimi janë të pasqyruar objektiva të shprehura qartësisht, të cilat synojnë të përgatisin student me njohuri të thelluara teorike dhe kompetenca profesionale për të ushtruar profesionin e tyre si mësues ndihmës në Arsimin Parauniversitar dhe jo vetëm. *(Evidenca II.27.1. Programet lëndore (Syllabuset) e programit të studimit Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special", viti akademik 2022-2023, 2023-2024)* Programi Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special", ofrohet si një reflektim dhe mbështetje profesionale ndaj ndryshimeve kurrikulare në Arsimin Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë. Programi është ndërtuar në mënyrë të tillë që të mundësojë zhvillimin e aftësive, shprehive dhe kompetencave për çështje të ndryshme dhe të pashkelura në institucionet e arsimit parauniversitar si dhe në qendra e edukimit të trajtimit special. *(Evidenca I. 9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special", Neni. 3)* Programi është hartuar në përputhje me misionin e UGJ-së që është të kontribuojë në krijimin, zhvillimin dhe të përcjellë e të mbrojë dijet përmes mësimdhënies/mësimnxënies, kërkimit shkencor, si dhe të nxisë e të zhvillojë artet, edukimin fizik dhe sportet; të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e



	<p>standardeve të demokracisë në vend; të ofrojë mundësi të barabarta për të përfituar nga arsimi i lartë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës. Të kontribuojë në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimin të shoqërisë dhe në përgatitjen e studentëve për një shoqëri të tillë. (Evidenca I.1. Statuti i UGJ-së, Neni.5)</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>FESHSH/NJBEMM nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit. Në fillim të çdo viti akademik personeli akademik pasqyron në mënyrë të detajuar në Planifikimin e kohës vjetore të punës të personelit akademik në NJBEMM, duke shprehur qartë të gjithë veprimtarinë mësimdhënëse, veprimtarinë kërkimore-shkencore si dhe veprimtaritë artistike. NJBEMM për nga vet përbërja e personelit akademik ka aksesin që të organizojë veprimtari sportive, artistike, ekspozita etj. Pjesë e rëndësishme e gjithë këtyre veprimtarive janë dhe studentët. (Evidenca III.15 Plani i veprimtarive akademike kërkimore-shkencore të UGJ 2-22-2023; Evidenca III.15.3 Plani i veprimtarive akademike kërkimore-shkencore të NJBEMM 2022-2023; Evidenca IV.7 Model i planifikimit të kohës vjetore të punës të personelit akademik NJBEMM)</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>NJBEMM në praktikën e saj mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në projekte dhe aktivitete të tjera specifike për programin e studimit. NJBEMM në të gjitha projektet që ka aplikuar dhe fituar ka angazhuar sistematikisht studentët që janë pjesë e programeve në Njësinë Bazë të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies. NJBEMM në kuadrin e bashkëpunimeve afat shkurtër me shoqata të cilat nxitin dhe promovojnë studentët ka bërë përpjekje të vazhdueshme që ata të jenë pjesë e rëndësishme e këtyre aktiviteteve.</p> <p>Në politikat e NJBEMM njohja e studentëve me jetën artistike të qytetit të Gjirokastrës është parë gjithmonë me përparësi, duke i bërë ata shpesh të ndërjegjishëm për të ndjekur aktivitete sportive, artistike, ekspozita etj. (Evidenca III.15.3 Plani i veprimtarive akademike kërkimore-shkencore të NJBEMM 2-22-2023; Evidenca IV.7 Model i planifikimit të kohës vjetore të punës të personelit akademik NJBEMM; (Evidenca II.15 Pjesëmarrje në Panair Work and Study 2022, Evidenca II.15.1 Pjesëmarrje në Panair Work and Study 2023; Evidenca I.25. Lista e Mobiliteteve në Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë)</p> <p>II.33 Projekti 1. Klasa dixhitale NJBEMM-Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë; Evidenca II.34 Projekti 2. Ndikimi i personalitetit... NJBEMM; V.16 Projekti i studentëve në NJBEMM; V.17 Memorandum bashkëpunimi UGJ me SHMKEZH, realizim aktiviteti studentor; Evidenca V.9 Statuti I shoqatës sportive në UGJ)</p>
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat</p>	<p>Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë ka patur mbështetje financiare nga institucioni. Personeli akademik nga viti 2018 e në vazhdim ka fituar dhe zbatuar dy projekte si ekzekutues Njësinë Bazë të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies. NJBEMM motivon studentët për përfshirje në projekte me financime nga organizata që kanë lidhje me edukimin. (Evidenca II.33 Projekti 1. Klasa dixhitale NJBEMM-Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë; Evidenca II.34 Projekti 2. Ndikimi i personalitetit... NJBEMM; V.16 Projekti i</p>

nga aktivitete të ndryshme.	<i>studentëve në NJBEMM) Gjatë vitit 2023 ka fituar një project me fondet e UGJ, i cili është në proces zbatimi. "Strategji për të zhvilluar tek mësuesit aftësi për edukimin e fëmijëve me aftësi ndryshe në Qarkun e Gjirokastrës"</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	<p>Njësia Bazë e Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies si përgjegjëse e programit të studimit Master Professional në "Mësues në Arsimin Special" mbështet personelin akademik të angazhuar në këtë program studimi, për kualifikimin e tyre të mëtejshëm kërkimor-shkencor. Gjatë periudhës 2017-2020 Universiteti "E. Çabej" Gjirokastrë, ka qenë <i>partner</i> në projektin ndërkombëtar TEAVET. Bazuar në projektin "Zhvillimi i kompetencave të mësuesve për një sistem gjithëpërfshirës të zhvillimit profesional të mësuesve në Shqipëri (TEAVET- ERASMUS+), universitetet pjesëmarrëse në project patën si qëllim koordinimin ndërinstitucional për zhvillimin profesional të mësuesve në sistemin e arsimit parauniversitar, nëpërmjet trajnimeve të mësuesve. Pjesë e këtij projekti kanë qenë dhe personel akademik nga NJBEMM. Gjatë këtij angazhimi të zbatimit të projektit me partner brenda dhe jashtë vendit personeli akademik i angazhuar u aftësua për përmirësimin e kompetencave didaktike në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, duke përgatitur dhe module trajnimi për zhvillimin e kompetencave të mësuesve për një sistem gjithëpërfshirës të zhvillimit profesional. Këto module të përgatitur edhe nga personeli akademik i NJBEMM u akredituaran nga Komisioni i akreditimit të programeve/moduleve të trajnimit (KAPT), në bashkëpunim me Institutin e Zhvillimit të Trajnimeve (sot ASCAP) në varësi të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Universiteti "Eqrem Çabej" është agjenci akredituese me të drejtën e trajnimit të mësuesve të arsimit parauniversitar me këto 16 module të akredituara. Personeli akademik pranë NJBEMM ka organizuar trajnimet gjatë vitit akademik 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022 me mësuesët e Arsimit Parauniversitar, të cilët janë pajisur me certifikatat (me e kredite), zyrtarisht nga Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastrë. Për koordinimin e trajnimeve në UGJ është ngritur dhe funksionon Qendra e të mësuarit Gjatë Gjithë Jetës (LLL centre) e krijuar si produkt i projektit për ngritjen e kapaciteteve TEAVE. (Evidenca II.30 Memorandum Marrëveshja për krijimin e qendrës; Evidenca II.32. Modulet TEAVET, Evidenca II. 35 Modulet ASCAP; Evidenca II.35.1 Zhvillimi i trajnimeve me mësuesit e Arsimit Paruniversitar në UGJ) Qendra filloi veprimat në 15.11.2019, në të cilën janë instaluar të gjitha pajisjet dixhitale (të përfituara nga projekti), të nevojshme për procesin e trajnimit. Kjo qendër vazhdon të koordinoj dhe trajnimet e fituara nga Agjencia akredituese UGJ, sipas vendimeve të komisionit të akreditimit të programeve/moduleve të trajnimit. Gjatë periudhës 2019-2023 Universiteti "E. Çabej" Gjirokastrë dhe NJBEMM, ka qenë <i>project partner</i> në projektin ndërkombëtar TECOMP (Strengthening Teaching</p>

Competences in Higher Education in Natural and Mathematical Sciences) të programit erasmus+.

Në kuadër të këtij projekti anëtarë të departamentit morën pjesë në trajnime të vazhdueshme për aplikimin e metodave të reja të mësimdhënies duke përdorur teknologjitë e informacionit dhe komunikimit. Këto trajnime janë kryer si në distancë (online) ashtu dhe me pjesëmarrje fizike në universitetet partnere të cilat pasqyrohen edhe në faqen zyrtare të projektit

Projekt-TeComp, <http://www.tecomp.ni.ac.rs/training-events>)

Me vendim Nr.102, datë 20.05.2022 "Për akreditimin e moduleve të trajnimit për agjencinë trajnuese Universiteti i Gjirokastrës", komisioni i akreditimit të programeve/moduleve të trajnimit vendosi;

1. Akreditimin e 2 (dy) moduleve të aplikuar nga personeli akademik pranë NJBEMM dhe vlefshmërinë e tyre nga data 20.05.20-20.05.2026;

2. Modulet e trajnimit të akredituara, identifikohen sipas kodeve dhe numrit të krediteve, bashkëlidhur këtij vendimi. [Evidenca II.35 Modulet ASCAP (Vendimi Nr.102, datë 20.05.2022 "Për akreditimin e moduleve të trajnimit për agjencinë trajnuese Universiteti i Gjirokastrës")]

Me vendim Nr.2, datë 13.02.2023 "Për akreditimin e moduleve të trajnimit për agjencinë trajnuese Universiteti i Gjirokastrës", komisioni i akreditimit të programeve/moduleve të trajnimit vendosi;

1. Akreditimin e 5 (pesë) moduleve të aplikuar nga personeli akademik pranë NJBEMM dhe vlefshmërinë e tyre nga data 13.02.23-13.02.2027;

2. Modulet e trajnimit të akredituara, identifikohen sipas kodeve dhe numrit të krediteve, bashkëlidhur këtij vendimi. [Evidenca II.35 Modulet ASCAP (Vendimi Nr.2, datë 13.02.2023 "Për akreditimin e moduleve të trajnimit për agjencinë trajnuese Universiteti i Gjirokastrës")]

Mbështetja e personelit akademik është e fokusuar në angazhimin e tyre në projektet kombëtare dhe ndërkombëtare që kanë lidhje me mësimdhënien edhe në këtë fushë. Njësia bazë është në mbështetje të vazhdueshme edhe në angazhimet individuale të personelit akademik, duke ju lënë hapsira kualifikimi dhe bashkëpunimi me universitete partnere brenda dhe jashtë vendit. Dy personel akademik janë në process doktorature në fushën e pedagogjisë dhe psikologjisë në Fakultetin e Shkencave sociale, Universiteti i Tiranës. Temat e zgjedhura prej dy doktoranteve kanë lidhje me fushën e këtij programi studimi. Në mënyrë periodike gjatë kësaj periudhe janë kryer bashkëbisedime mbi këto tematika. Dy doktorantet janë angazhuar në një project studimor të financuar nga UGJ për vitin 2023, i cili është në process zbatimi. ("Strategji për të zhvilluar tek mësuesit aftësi për edukimin e fëmijëve me aftësi ndryshe në Qarkun e Gjirokastrës") Mbështetja për kërkimin shkencor dhe realizimin e objektivave të programit të studimit evidentohet dhe me organizimin e konferencave kombëtare nga NJBEMM me Shoqatën Psikologët e Shqipërisë. [Evidenca III.5 Udhëzues institucional mbi metodat inovative në mësimdhënie; Evidenca I.25. Lista e mobiliteteve e personelit akademik dhe studentëve në Universiteti "Egrem Çabej"]

Gjatë periudhës 2017-2020 Universiteti "E. Çabej" Gjirokastër, ka qenë *partner* në projektin ndërkombëtar TEAVET. Bazuar në projektin "Zhvillimi i kompetencave të mësuesve për një sistem gjithëpërfshirës të zhvillimit profesional të mësuesve në Shqipëri (TEAVET- ERASMUS+), universitetet pjesëmarrëse në project patën si qëllim koordinimin ndër-institucional për zhvillimin profesional të mësuesve në sistemin e arsimit parauniversitar, nëpërmjet trajnimeve të mësuesve. Pjesë e këtij projekti kanë qenë dhe personel akademik nga NJBEMM. Gjatë këtij angazhimi të zbatimit të projektit me partner brenda dhe jashtë vendit personeli akademik I angazhuar u aftësua për përmirësimin e kompetencave didaktike në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxëniet, duke përgatitur dhe module trajnimi për zhvillimin e kompetencave të mësuesve për një sistem gjithëpërfshirës të zhvillimit profesional. Këto module të përgatitur edhe nga personeli akademik i NJBEMM u akredituaran nga Komisioni i akreditimit të programeve/moduleve të trajnimit (KAPT), në bashkëpunim me Institutin e Zhvillimit të Trajnimeve (sot ASCAP) në varësi të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Universiteti "Eqrem Çabej" është agjenci akredituese me të drejtën e trajnimit të mësuesve të arsimit parauniversitar me këto 16 module të akredituara. Personeli akademik pranë NJBEMM ka organizuar trajnimet gjatë vitit akademik 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022 me mësuesët e Arsimit Parauniversitar, të cilët janë pajisur me certifikatat (me e kredite), zyrtarisht nga Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastër. Për koordinimin e trajnimeve në Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër është ngritur dhe funksionon Qendra e të mësuarit Gjatë Gjithë Jetës (LLL centre) e krijuar si produkt i projektetit për ngritjen e kapaciteteve TEAVET (Evidenca II.30 Memorandum Marrëveshja për krijimin e qendrës; Evidenca II.32. Modulet TEAVET, Evidenca II. 35 Modulet ASCAP; Evidenca II.35.1 Zhvillimi i trajnimeve me mësuesit e Arsimit Paruniversitar në UGJ). Qendra filloi veprimatrinë në 15.11.2019, në të cilën janë instaluar të gjitha pajisjet dixhitale (të përfituara nga projekti), të nevojshme për procesin e trajnimit Kjo qendër vazhdon të koordinoj dhe trajnimet e fituara nga Agjencia akredituese Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër, sipas vendimeve të komisionit të akreditimit të programeve/moduleve të trajnimit.

Gjatë periudhës 2019-2023 Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër dhe NJBEMM, ka qenë *project partner* në projektin ndërkombëtar TECOMP (Strengthening Teaching Competences in Higher Education in Natural and Mathematical Sciences) të programit erasmus+.

Në kuadër të këtij projekti anëtarë të departamentit morën pjesë në trajnime të vazhdueshme për aplikimin e metodave të reja të mësimdhënies duke përdorur

	<p>teknologjitë e informacionit dhe komunikimit. Këto trajnime janë kryer si në distancë (online) ashtu dhe me pjesëmarrje fizike në universitetet partnere të cilat pasqyrohen edhe në faqen zyrtare të projektit</p> <p>Projekt-TeComp, http://www.tecomp.ni.ac.rs/training-events</p> <p>Me vendim Nr.102, datë 20.05.2022 “Për akreditimin e moduleve të trajnimit për agjencinë trajnuese Universiteti i Gjirokastrës”, komisioni i akreditimit të programeve/moduleve të trajnimit vendosi;</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Akreditimin e 2 (dy) moduleve të aplikuar nga personeli akademik pranë NJBEMM dhe vlefshmërinë e tyre nga data 20.05.20-20.05.2026; 2. Modulet e trajnimit të akredituara, identifikohen sipas kodeve dhe numrit të krediteve, bashkëlidhur këtij vendimi. [Evidenca II.35 Modulet ASCAP (Vendimi Nr.102, datë 20.05.2022 “Për akreditimin e moduleve të trajnimit për agjencinë trajnuese Universiteti i Gjirokastrës”)] <p>Me vendim Nr.2, datë 13.02.2023 “Për akreditimin e moduleve të trajnimit për agjencinë trajnuese Universiteti i Gjirokastrës”, komisioni i akreditimit të programeve/moduleve të trajnimit vendosi;</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Akreditimin e 5 (pesë) moduleve të aplikuar nga personeli akademik pranë NJBEMM dhe vlefshmërinë e tyre nga data 13.02.23-13.02.2027; 2. Modulet e trajnimit të akredituara, identifikohen sipas kodeve dhe numrit të krediteve, bashkëlidhur këtij vendimi. [Evidenca II.35 Modulet ASCAP (Vendimi Nr.2, datë 13.02.2023 “Për akreditimin e moduleve të trajnimit për agjencinë trajnuese Universiteti i Gjirokastrës”)] 			
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Studentët e përfshirë në programin e studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special” nxiten gjatë veprimtarisë mësimore për të dhënë idetë e tyre në lidhje me situatat e rasti të cilat kërkojnë një mendim kreativ të zbatuar në kontekste të reja. Personeli akademik në mënyrë profesionale përdorin gjatë procesit mësimor element të ndryshëm bashkëkohor, ku studentët kanë mundësi të jenë sa më aktiv dhe të shprehin idetë e tyre. NJBEMM në projektet që ka fituar me fondet e UGJ ka bërë të mundur dhe angazhimin e studentëve në këto studime kërkimore. (Evidenca II. 33 Projekti 1. Modelimi i klasave të arsimit parauniversitar; Evidenca II.34 Projekti 2. Ndikimi i personalitetit dhe disiplinës positive)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>




Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p>	<p>Provimi i përgjithshëm përfundimtar ose punimi i diplomës për studentët e programit e ciklit të parë Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, mbështetet në Kreun VIII Diplomimi, të Rregullores së Studimeve në Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë-së, Neni.59, Neni.60, Neni.61, Neni. 62, Neni 63 dhe Neni. 64 (Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë) në Nenin 93 të Rregullores së Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë (Evidenca I.2.Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë) dhe Kreun VII Diplomimi, Neni. 39, Neni. 40 të Rregullores së FESHSH (Evidenca I.5. Rregullore e Njesise Kryesore FESHSH) dhe Nenit 23 të Rregullores së programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, (Evidenca I.9. Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, Neni. 15)</p> <p>Në rregulloren e studimeve në UGJ, Rregulloren e FESHSH dhe Rregulloren e programit të studimit në Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, përcaktohet qartë pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për të përgatitur dhe mbrojtur një punim diplome. (Evidenca I.4. Rregullore e studimeve të UGJ-së, Neni.59, pika 3; Evidenca I.5. Rregullore e Njesise Kryesore FESHSH, Neni.39, pika 2; Evidenca I.9. Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, Neni. 15, pika 2)</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, është program i nivelit të parë të studimeve dhe mbyllet me detyrimin përmbyllës (provim i përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome).</p> <p>Programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar është gjithëpërfshirës, me tematika nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit. Programi hartohet nga stafi i njësisë bazë, miratohet nga drejtuesi i NJBEMM, si dhe Dekani i Fakultetit.</p> <p>Në fillim të vitit të fundit të studimeve NJBEMM asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose punimit të diplomës në respektim të Rregullores se studimeve në UGJ. Evidenca I.4.Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni. 61) dhe shtojcave të kësaj Rregulloreje, Rregullores së programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, (Evidenca I.9. Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, Neni. 15;Evidenca I.4. Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë; Evidenca III.11. Program i provimit të përgjithshëm përfundimtar Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”; Evidenca III.11.1. Manuali i punimit të diplomës, Shtojca 1, 2, 3, 4, 5, 6; Evidenca III11.2 Fushat e punimit të diplomës NJBEMM).</p>

	<p>Udhëheqësi i temës së diplomës përgatit programin e punës së studentit, duke vendosur afatet e përafërta të realizimit të tij. Studenti duhet të respektojë afatet e vendosura për të bërë të mundur mbrojtjen me sukses të temës në sezonin normal të mbrojtjes së diplomës. Udhëheqësi përcakton grafikun e konsultimeve të programuara me studentin, përgjatë të cilave konsultohet dhe kontrollohet puna e bërë sipas programit të miratuar. Para mbrojtjes së tezës së diplomës, udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer nga studentit dhe lejon mbrojtjen e punimit duke firmosur tezën e diplomës. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre. Për realizimin e punimit të diplomës ndiqet Manuali i punimit të diplomës.</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Provimi i përgjithshëm përfundimtar /punimi i diplomës realizohet përpara një komisioni të posaçëm, të përbërë nga personel akademik të departamentit, të fushave që mbulon programi i provimit. Anëtarët e komisionit propozohen nga departamenti dhe miratohen nga dekani. Komisioni i provimit përfundimtar përbëhet nga titullarët e lëndëve të përzgjedhura, të cilët hartojnë tezën e provimit final duke u mbështetur në literaturën dhe njohuritë që studentët kanë marrë gjatë viteve të shkollimit. <i>(Evidenca I.4. Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Neni.62, pika 3, Neni. 64)</i></p> <p>Programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar është gjithëpërfshirës, me tematika nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit. Programi hartohet nga stafi i njësisë bazë, miratohet nga drejtuesi i departamentit, si dhe Dekani i Fakultetit. <i>(Evidenca I.4. Rregullore e studimeve në UGJ, Neni. 62, pika 2; Evidenca III.11. Programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar Master Profesional në "MNEGJ")</i></p> <p>Komisioni i posaçëm i miratuar për administrimin e provimit të përgjithshëm përfundimtar harton tezën në përputhje me programin e provimit të përgjithshëm përfundimtar. Tezat e provimit përmbajnë pyetje nga fushat që përfshihen në këtë program. Tezat e provimit të përgjithshëm përfundimtar kompozohen nga anëtarët e komisionit, firmosen nga Drejtuesi i Njësisë Bazë dhe miratohen nga Dekani i Fakultetit. <i>(Evidenca I.4. Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Neni. 62, pika 4; Evidenca III. 12.1. Model teze e provimit të përgjithshëm përfundimtar; Evidenca III.11.2 Fushat e punimit të diplomës NJBEMM)</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar.</p>	<p>Njësia Bazë e Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies në fillim të vitit të fundit të studimeve përcaktojnë fushat e studimeve për punimin e diplomës. Udhëheqësi i temës së diplomës përgatit programin e punës së studentit duke vendosur afatet e përafërta të realizimit të tij, përcakton grafikun e konsultimeve të programuara me studentin përgjatë të cilave konsultohet dhe kontrollohet puna e bërë sipas programit të miratuar. Para mbrojtjes së tezës së diplomës udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer nga studentit dhe lejon mbrojtjen e punimit duke firmosur tezën e diplomës.</p> <p>Punimi i diplomës bëhet duke mbajtur në konsideratë udhëzimet në Manualin e e punimit të diplomës (Projekt propozim për tezën), sipas shtojcës 1</p>

<p>Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>bashkëngjitur Rregullores së studimeve në UGJ. (Evidenca I.4. Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni. 61; Evidenca III.11.1. Manuali i punimit të diplomës, Shtojca 1, 2, 3,4,5,6; Evidenca III.11.2 Fushat e punimit të diplomës NJBEMM) Gjatë këtyre viteve studentët nuk kanë bërë zgjedhjen për punim diplome, por në detyrimet përmbyllëse kanë zgjedhur provimin përfundimtar. (Evidenca I.4. Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni. 62, pika 2; Evidenca III.11. Programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar Master Profesional në "MNEGJ"; Evidenca III.11.2 Fushat e punimit të diplomës NJBEMM.)</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Njësia Bazë e edukimit dhe metodologjisë së mësimdhënies u ofron studentëve të gjitha resurset e literaturës dhe të mjeteve teknologjike që didponon, gjatë udhëheqjes dhe procesit të punimit të diplomës. Gjithashtu krijon kontakte dhe me institucionet ku studentit i duhet të kryej intervista, pyetësor studime rasti etj.. Në Manualin për punimin e diplomës në UGJ janë përcaktuar me hollësi përgjegjësitë e institucionit dhe udhëheqësit të diplomës ku parashikohen edhe ndihma në përzgjedhjen dhe zbatimin e metodologjisë së studimit. (Evidenca I.4. Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni. 61; Evidenca III.11.1. Manuali i punimit të diplomës Shtojca 1; Evidenca III.3. Inventari laboratorit pedagogjik në NJBEMM; Evidenca III.11.2 Fushat e punimit të diplomës NJBEMM).</p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Në përfundim të provimit të formimit/mbrojtje e diplomës studenti vlerësohet me notë (5-nota minimale për të kaluar dhe 10-nota maksimale). Komisioni përbëhet nga 3-5 anëtarë, të propozuar nga drejtuesi i njësisë bazë të EMM dhe miratohet nga dekani i fakultetit (FESHSH). Mbrojtja e diplomës me punim diplome bëhet para një komisioni të përbërë me jo më pak se 5 anëtarësh, njëri prej të cilëve është oponent, të propozuar nga drejtuesi i njësisë bazë dhe miratuar nga dekani i fakultetit. Mbrojtja e punimit të diplomës bëhet e hapur dhe pasi të jetë dorëzuar në njësinë bazë dokumentacioni I përcaktuar në Rregulloren e studimeve në UGJ, Neni. 64. Komisioni i pedagogëve, bën vlerësimin e temës së diplomës mbi bazën e materialit të shkruar dhe prezantimit me gojë. Vlerësimi me notë i studentit është mesatare e pikëve të të gjithë anëtarëve të komisionit të vlerësimit të diplomës. Vlerësimi i punimit të diplomës pasqyrohet në procesverbalin përkatës. (Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni. 62, pika 5 dhe 6, Neni. 64 pika 3 dhe 4; Evidenca III.11.1. Manuali i punimit të diplomës Shtojca e Rregullores së Studimeve; Evidenca III.11.2 Fushat e punimit të diplomës NJBEMM).</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në</p>	<p>Studentët e Programit të Studimit Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special" në përfundim të studimeve pajisen me diplomën dhe suplementin e diplomës (Evidenca I.4. Rregullore e studimeve në UGJ Neni.65; Evidenca I.2, Rregullore e UGJ-së, Neni.76; Evidenca II.5. Model diplome Master Profesional në "MNEGJ; Evidenca II.6.1 Suplementi i diplomës) Suplementi i Diplomës për programin e studimit Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special", është në përputhje me Udhëzimit Nr. 11, datë 02.04.2020</p>



<p>dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>“Për përcaktimin e përmbajtjes dhe formës së Suplementit të Diplomës” të MASR-së (Evidenca II.6.2. Udhëzimi nr. 11, dt. 02.04.2020 “Për përcaktimin e përmbajtjes dhe formës së Suplementit të Diplomës” të MASR-së). Ai përshkruan në veçanti, natyrën, nivelin, përmbajtjen, rezultatet e studimeve që janë kryer dhe përfunduar me sukses nga mbajtësi i diplomës.</p> <p>Pas diplomimit, me kërkesën e tij, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar, me syllabuset përkatëse. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar sipas kërkesës individuale dhe procedurave institucionale,</p> <p>(Evidenca III.11. Programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar Master Profesional në “MNEGJ”; Evidenca III.11.2 Fushat e punimit të diplomës NJBEMM)</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Institucioni ruan përgjatë viteve të studimit kopje te dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen. Më pas studentët, në mbyllje të studimit, kanë të drejtë të tërheqin dokumentacionin personal. Të gjitha proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale të studentëve nga institucioni kryhen bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p>UGJ në përputhje me Neni. 101 të Ligjit të arsimit të lartë si dhe Rregullore e Sekretarisë Mësimore (Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”. Gjirokastër, Neni 44; Evidencë III. 13. Rregullore e Sekretarisë Mësimore, Neni. 4) ruan kopje të dokumentacionit të studentit si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • regjistrin themeltar të studentëve; • regjistrin e arritjeve akademike; • regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave 			
<p>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.6 Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizmin e praktikës</p>	<p>FESHSH/NJBEMM për funksionimin në mënyrë cilësore të praktikës profesionale kanë përcaktuar rregulloren e zhvillimit të praktikës profesionale. Në këtë rregullore cilësohen në mënyrë korrekte të drejtat dhe detyrimet e studentit, si dhe përgjegjësitë e personelit akademik i cili vëzhgon dhe vlerëson studentit sipas objektivave të vendosura në programin lëndor (syllabusin) e praktikës profesionale në Programin e studimit në Master Profesional “Mësues në Arsimin Special”, viti akademik 2023-2024 dhe në syllabuset e programit të studimit MP</p>

laboratorike, praktikës profesionale.	në MNEGJ gjatë viteve 2021-2022; 2020-2021. Në rregullore e praktikës janë të përcaktuara dhe detyrat e institucionit pritës dhe roli i mësuesit mentor, detyrime dhe përgjegjësi që rrjedhin dhe nga marrëdhëniet institucionale të UGJ për praktikatat profesionale. Gjatë zhvillimit të praktikave personeli akademik i ngarkuar vëzhgon sistematikisht studentët dhe mban lidhje me institucionet përkatëse. Në fillim të çdo praktike NJBEMM me miratim të Dekanit kryhet shpërndarja e studentëve për praktikë profesionale me anë të shkresave përcjellëse në Zyrat Vendore ku student do të kryej praktikën. (Evidenca I. 30 Rregullore e praktikës profesionale në FESHSH; Evidenca I.31 Marrëveshje institucionale për praktikatat mësimore në FESHSH; Evidenca II.9.2 Plani mësimor i programit të studimit Master Professional në "Mësues në Arsimin Special", viti akademik 2022-2023; Evidenca II.27.1 Programeve lëndore (syllabuset) të Programit të studimit Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special" viti akademik 2022-2023, 2023-2024) (ANEKS-Tabelat Përmbledhëse. Tabelat 12.1, 12.2, 12.3 Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës)
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Në fillim të çdo viti mësimor Njësia kryesore me propozimin e njësisë bazë rifreskon kriteret dhe mentorët e realizimit të praktikave mësimore në marrëveshjet me Drejtorin Rajonale të Arsimit Paruniversitar në Fier dhe Zyrat Vendore të Arsimit në qarkun e Gjirokastrës. Praktika profesionale që zhvillohet në shkollat e arsimit profesional ka një kujdes të shtuar nga NJBEMM dhe partnerët pritës. Nëpërmjet realizimit të saj me përgjegjësi dhe cilësi studenti aftësohet me veprimtari praktike në mënyrë që të krijoj shprehitë dhe kompetencat bazike në formimin e tij. (Evidencat I.30 Rregullore e praktikave mësimore profesionale në FESHSH; Evidenca I.30.1 Marrëveshjet institucionale për praktikatat mësimore; Evidenca II.9.2 Plani mësimor i programit të studimit Master Professional në "Mësues në Arsimin Special", viti akademik 2022-2023)
Kriteri 3. Praktikatat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Praktika profesionale është pjesë përbërëse dhe shumë e rëndësishme e programeve të studimit në Njësinë Bazë të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies (NJBEMM). Praktika profesionale, bazohet në lidhjen e ngushtë midis univrsitetit, pushtetit vendor dhe shkollave të Sistemit Parauniversitar, në Republikën e Shqipërisë, si partnerë bazë. Praktika profesionale në programiin e studimit Master Profesional "Mësues në Arsimin Special" ka një rëndësi shumë të madhe në këtë program studimi, për t'i rritur vlerën cilësore dhe kompetencat praktike çdo studenti. Ajo është e shtrirë në tetë javë mësimore. Kjo periudhë e studimeve është një moment i rëndësishëm në përfitimin e përvojave të para arsimore te studentët në punën e klasave gjithëpërfshirëse me fëmijët dhe specifikisht me fëmijët me aftësi ndryshe. Praktika profesionale është pjesë e programit lëndor dhe zhvillohet si lëndë me 8 (tetë) ECTS, në vitin e dytë si më poshtë:



	<ul style="list-style-type: none"> • 4 javë mësimore praktikë profesionale pasive në semestrin e parë, të vitit të dytë • 4 jave praktikë profesionale aktive në semestrin e dytë, të vitit të dytë <p>Qëllimi i praktikës është aftësimi profesional i studentëve nëpërmjet praktikës në institucionet shkollore. Rol të rëndësishëm në këtë periudhë, luan ndihma e mësuesve mentore dhe mësuesve ndihmës të kualifikuara në arsimin gjithëpërfshirës, të cilët i ndihmojnë studentët me karakteristikat individuale, historikun, evidentimin e nevojave që kanë ata, mënyrën si organizojnë ditën mësimore. Studentët do të njohin aspektet dhe problematikat e punës me fëmijët me aftësi ndryshe, familjet dhe psikologun shkollor. Një praktikë e mirë i pajisë studentët me njohuri për karrierë dhe krijon përvojë reale për kërkesat e përditshme të profesionit që kanë zgjedhur. Kjo do të thotë se studentët do të jenë më të përgatitur për t'u hedhur në tregun e punës. Studentët do të zhvillojnë një sërë aftësish komunikuese dhe praktike me fëmijët dhe grupin e punës (mësuesja e klasës dhe mësuesja ndihmëse). Ato kanë lidhje të drejtpërdrejta me formimin e tyre, me zhvillimin profesional dhe me ushtrimin e profesionit.</p> <p><i>(Evidenca I.30. Rregullore e praktikës mësimore/profesionale FESHSH; Evidenca I. 9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special", Neni. 3, Neni 14; Evidenca II.9.2 Plani mësimor Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special, viti akademik 2022-2023; Evidenca II.27.1 Programeve lëndore (syllabuset) të Programit të studimit Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special" viti akademik 2022-2023, 2023-2024)</i></p> <p>(ANEKS-Tabelat Përmbledhëse. Tabelat 12.1, 12.2, 12.3 Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës)</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X
--	----------------	-----------------------	----------------------	----------------------------




IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Personeli akademik (me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme) dhe ndihmës akademik, që angazhohen në realizimin e programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, (ANEKS-Tabelat Përmbledhëse Tabelat 6.1. 6.2, 6.3 Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”) përmbushin kërkesat ligjore në fuqi të përcaktuara në Ligjin 80/2015, Neni. 59, pika 3,4,5,6. Drejtoria e shërbimeve ndihmës akademike- administrative administron dosjet që përmbajnë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të personelit akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme ose personel akademik të ftuar në Universitet duke përditësuar vazhdimisht bazën e të dhënave.</p> <p>Gjithashtu, personeli akademik që angazhohet në realizimin e programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, (ANEKS-Tabelat Përmbledhëse. Tabelat 12.1, 12.2, 12.3 Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës) ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik në mbulimin e lëndëve mësimore të programit të studimit pasi personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, ka së paku kualifikim të ciklit pasardhës. Ligji 80/2015, Neni. 59, pika 6)</p> <p>Niveli i kualifikimit i anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special” është në përputhje me natyrën dhe dhe veçorinë e lëndëve të programit sipas CV-së së stafit. [Tabelat 6.1. 6.2, 6.3 Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”]</p> <p><i>(Evidenca III.4. CV e stafit akademik për programin e studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”), gjenden kualifikimet me fushat e tyre të interesit dhe të kërkimitshkencorqë përputhen tërësisht me natyrën e lëndëve që mbulojnë këtë program studimi. Kualifikimet dhe publikimet e personelit akademik janë të përfshira në analizën e detajuar të aktivitetit të departamentit si pjesë e rëndësishme e Raportit Vjetor të NJBEMM.</i></p> <p><i>(Evidenca I.13. Raporti vjetori veprimtarisë mesimore shkencore NJBEMM 2018-2019; Evidenca I.13.1 Raporti i veprimtarisë mesimore shkencore NJBEMM 2019 -2020; Evidenca I.13.2 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore NJBEMM 2020-2021; Evidenca I.13.3 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore NJBEMM 2021-2022; Evidenca I.12. Raporti vjetor I FESHSH-së 2018-2019; Evidenca I.12.1. Raporti vjetor i FESHSH-së, 2019-2020; Evidenca I.12.4. Raporti vjetor i FESHSH-së, 2020-2021; Evidenca I.12.3. Raporti vjetor i FESHSH, 2021-2022)</i></p>



<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën mësimore të programit të studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi bazuar në Neni. n 59, pikat 3, 4, 5, 6 të Ligjit Nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe V.K.M Nr.418, datë 10.05.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe të degëve të tyre”. (Evidenca IV.1 V.K.M Nr.418, datë 10.05.2017, pika 2, gërma a, nënpika xii, pika 2, gërma b, nënpika i, nënpika ii; Evidenca II.13.2 Raporti i kapaciteteve pritëse viti akademik 2023-2024). [ANEKS-Tabelat Përmbledhëse, Tabelat 12.1, 12.2, 12.3 Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës] Personeli akademik efektiv ka së paku kualifikim të ciklit pasardhës dhe mbulon jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për programin e studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>UGJ garanton dhe dëshmon qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit. (Evidenca IV.3. Listë pagesa, Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore te personelit akademik Janar-Maj 2023; Evidenca IV.3.1 Model kontratë individuale e punës me kohë të pjesshme dhe kohëzgjatje të caktuar; Evidenca IV.3.2 Model kontratë individuale e punës me kohë të plotë dhe kohëzgjatje të pacaktuar)</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>UGJ harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore. (Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër Neni. 56; Evidenca I.2.Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Neni. 27, Neni. 29; Evidenca I.27. Rregullore e punësimit të personelit akademik, Neni. 3, Neni. 5, Neni. 8 dhe Neni. 9)</p> <p>NJBEMM, bazuar në nevojat e saj, përcakton kriteret e përgjithshme (Evidenca I.2 Rregullore e UGJ-së, Nenet 27) dhe specifike të punësimit të personelit akademik në përputhje me natyrën, strukturën, lëndët mësimore dhe përmbajtjen e programit të studimit. (Evidenca IV.4. Propozim për personel akademik me kohë të plotë; Evidenca IV.4.1. Propozim për personel akademik me kohë të pjesshme)</p> <p>Kërkesa për punësim i përcillet Rektorit të universitetit, ku pas miratimit, botohet në Buletinin e Prokurimeve Publike (Evidenca IV.4.2 Buletini prokurimeve publike) si dhe në faqen zyrtare të Universitetit.</p> <p>Rektori me urdhër ngre një komision “ad-hoc” për shqyrtimin dhe vlerësimin e kandidaturave për vendin vakant, me 5(pesë) anëtarë, i përbërë nga Dekani i Fakultetit i cili kryeson komisioni [(Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Neni. 33, gërma “h”, 3 (tre)] anëtarë pjesë të personelit akademik të Njesisë bazë dhe 1(një) anëtar nga Rektori. Struktura e manaxhimit të burimeve</p>



	<p>njerëzore mbështet komisionin ad-hoc në zhvillimin e procedurave konkurruese. (Evidenca IV. 6. Procedura e punësimit të personelit akademik në NJBEMM)</p> <p>Në rastin e konkursit të punësimit të personelit akademik me kohë të pjesshme komisioni "ad-hoc" ngrihet nga Dekani i Fakultetit. (Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Neni. 33, gërma "f")</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>UGJ siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore. (Evidenca I.1.Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni. 45; Evidenca I.2.Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni. 37)</p> <p>Pjesë përbërëse e programit të studimit dhe specifikës së tij është edhe angazhimi i personeli ndihmës akademik me karakter mësimor që kanë departamentet e tjera në FESHSH, të cilët zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale për vëndin përkatës të punës. (Evidenca IV. 7. Detyrat dhe ngarkesa e personelit ndihmes akademik; Evidenca I.14 Organograma e UGJ; Evidenca I.16.Organograma Njësia Bazë e Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies; Evidenca III.4. CV e stafit akademik për programin e studimit Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special")</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Bazuar në Statutin e UGJ-së (Evidenca I.1.Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Nenet 41, 42) funksionon Sektori i Shërbimeve juridike, personelit dhe sekretari-protokoll si pjesë e Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmës Akademike Administrativeve cila është struktura përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ parashikuar në rregulloren e saj (Evidenca IV.5. Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DSHNA Neni. 4, Neni. 5; Evidenca IV. 3. 3 Model dosje personeli NJBEMM) Këto të dhëna përfshijnë cv e personelit, kartën e identitetit, pozicionin e punës, diplomat dhe listat e notave, gradat shkencore dhe titujt akademik, dëshmi të gjuhëve të huaja, dëshmi të trajnimeve dhe kualifikimeve të ndryshme, dëshmi penaliteti, raport mjeko ligjor etj.</p> <p>Përsa i përket promovimit akademik dhe aktivitetit kërkimor shkencor të personelit akademik në UGJ funksionon sektori i kërkimit shkencor dhe marrëdhënieve me jashtë i cili mbledh, ruan dhe përditëson të dhëna mbi kërkimin shkencor të personelit akademik, pjesmarrjes ne projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, zhvillimit të kapaciteteve didaktike dhe kërkimore shkencore nëpërmjet mobiliteteve të ndryshme në institucionet e arsimit të lartë jashtë vendit si dhe pjesëmarrjes ne trajnime e ëorkshope. (Evidenca IV.5. Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DSHNA, Neni. 17).</p> <p>Të dhënat përfshijnë gjithashtu edhe angazhimin e e personelit akademik në çdo semestër dhe në çdo vit akademik dhe semestër si dhe planifikimin e kohës vjetore të punës të personeliit, që parashikohen në fillim të çdo viti akademik dhe ruhen në Departament. (Evidenca I.5 Rregullore e Njesise Kryesore FESHSH, Neni. 16; Evidenca I.7 Rregullore e Njesise baze te Edukimit dhe Metodologjisë Mësimdhënies Kreu III; Evidenca IV.8 Model i ngarkesës mësimore; Evidenca IV.8.1 Model planifikimi i kohës vjetore të punës).</p>



	<p>Në fillim të çdo viti akademik Departamenti parashikon ngarkesën mësimore të programit të studimit, (<i>Evidencë IV.8. Modeli i ngarkesës mësimore</i>) bazuar në të cilën pedagogët dorëzojnë në departament marrëveshjet e organizimit të kohës vjetore (<i>Evidencë IV. 8.1. Model planifikimi i kohës vjetore të punës</i>).</p> <p>Në këtë program studimi çdo Njësi Bazë nga FESHSH dhe FSHN, sipas lëndëve përkatëse përcaktojnë ngarkesën mësimore si për personelin akademik ashtu dhe atë ndihmës të angazhuar në këtë program studimi. (<i>Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër Neni. 45, pika 3</i>). Mbledhja, ruajtja dhe përditësimi për çdo vit akademik I këtyre të dhënave behet, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale (<i>Evidenca IV.2 Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale</i>).</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special", ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale. Praktika Profesionale ka një shtrirje për gjatë vitit të dytë e organizuar në praktikë profesionale pasive 4 javë mësimore dhe praktikë profesionale aktive 4 javë mësimore, gjithsej 8 ECTS e shprehur në përqindje – 6.7%.</p> <p>Praktika profesionale i aftëson studentët të përcaktojnë nevojën e fëmijëve që në moshën parashkollore si dhe se çfarë duhet të dinë dhe të jenë në gjendje të bëjnë ata. Në këtë mënyrë studentët do të jenë të aftë të menaxhojnë të nxënëit e pavarur, zgjidhjen e problemeve, si dhe zhvillimin e mendimit kritik, përgjegjësi për veten e për të tjerët. Këto aftësi dhe të tjera lidhen sot me konceptin e kompetencave për të nxënëit gjatë gjithë jetës, të cilat mundësojnë përgatitjen e individëve për pjesëmarrje cilësore dhe aktive në shoqëri. Studentët do të zhvillojnë një sërë aftësish komunikuese dhe praktike të cilat kanë lidhje të drejtpërdrejtë me formimin e tyre, me zhvillimin profesional dhe me ushtrimin e profesionit. Studentët atashohen pranë institucioneve të Arsimit Parauniversitar me mentor mësues ndihmës, të përzgjedhura dhe të përcaktuara nga marrëveshjet e nënshkruara mes institucionit të UGJ-së dhe Drejtorisë Rajonale të Arsimit Paruniversitar, Fier. (<i>Evidencë II.9.2. Plani mësimor i programit të Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special" 2022-2023; Evidenca I.30. Rregullore e praktikave të FESHSH; Evidenca I.31. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit</i>) Për zhvillimin e saj mënyrë efektive ngarkohen kryesisht personel akademik me kohë të plotë si përgjegjës të saj dhe mësues të shkollave të cilët janë rekrutuar dhe si personel akademik me kohë të pjesshme në NJBEMM. Të gjithë studentët pajisen me elementët e rregullores së praktikës profesionale që është një udhërrëfyes për zhvillimin e praktikës dhe vlerësimin të saj nga personat përgjegjës. Institucioni ka nënshkruar marrëveshje të posaçme për realizimin e praktikave profesionale për programin e studimit. (<i>Evidenca 1.31 Marrëveshjet institucionale për praktikën mësimore</i>).</p> <p>Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore/Njësi Bazë e Edukimit dhe Metodologjisë së mësimdhënies përgjegjëse për programin e studimit Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special", ka përmbushur detyrimet e</p>



	<p>përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel me kohëtë plotë dhe kohë të pjesshme, me karakter mësimor, për realizimin e praktikave mësimore në Arsimin Parauniversitar. Plani mësimor i programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, si dhe Rregullorja e Programit të studimit përcakton qartë detyrimet përmbyllëse.</p> <p>Bazuar në Rregulloren e UGJ-së, (Evidenca I.2. Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni. 93, pika 1), Rregulloren e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore (Evidenca I.5. Rregullore e FESHSH-së; Neni. 39, pika 1, pika 2) dhe Rregulloren e Programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special” (Evidenca I. 9. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, Neni. 23, Neni. 24, Neni. 25) studentët e ciklit të dytë të studimeve Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome që përfaqësojnë 12 kredite ose 10% të numrit total prej 120 (ECTS) të krediteve. (Evidenca.II.9.1. Plani mësimor Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, 2021-2022; Evidenca III.11. Programi i provimit përfundimtar në MP MNEGJ)</p> <p>NJBEMM në fillim të vitit të fundit të studimeve përcaktojnë fushat e studimeve për punimin e diplomës. Udhëheqësi i temës së diplomës përgatit programin e punës së studentit duke vendosur afatet e përafërta të realizimit të tij, përcakton grafikun e konsultimeve të programuara me studentin përgjatë të cilave konsultohet dhe kontrollohet puna e bërë sipas programit të miratuar [Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 61, Evidenca III.11.2. Manuali i punimit të diplomës, Shtojcat e Rregullores së Studimeve; Evidenca III.11.2 Fushat e punimit të diplomës NJBEMM] Njësia bazë ofron mundësitë për të shfrytëzuar infrastrukturën dhe bibliotekën për përgatitjen e temës së diplomës nën drejtimin e udhëheqësit.</p>								
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritisë që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Personeli mbikqyrës në ambientin pritisë që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale (drejtuese, mësuese të arsimit parauniversitar, mësues ndihmës) në bazë të marrëveshjeve të realizuara mes UGJ-së dhe Drejtorisë Rajonale Arsimore Parauniversitare, Fier ,si dhe Zyrës Vendore Arsimore Gjirokastrë, i ndihmon studentët në përmbushjen e detyrimeve, raportit përfundimtar të praktikës dhe është pjesë e procesit të vlerësimit të studentëve për praktikën profesionale përmes një praktike të konsoliduar në këtë drejtim.</p> <p>(Evidenca.II.9.2. Plani mësimor Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, 2022-2023; Evidenca 1.31 Marrëveshjet institucionale për praktikat mësimore; Evidenca I.30. Rregullore e praktikës mësimore/profesionale FESHSH).</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="523 1733 751 1805">Nuk përmbushet</td> <td data-bbox="751 1733 979 1805">Përmbushet pjesërisht</td> <td data-bbox="979 1733 1208 1805">Përmbushet kryesisht</td> <td data-bbox="1208 1733 1473 1805">Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						



Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>UGJ ushtron aktivitetin e tij në 3 (tre) godina universitare: Godina A me sipërfaqe 3255.5 m², Godina B me sipërfaqe 1937 m² dhe godina C me sipërfaqe 729.6 m², (Evidenca IV.9 <i>Infrastruktura e UGJ</i>). Këto godina janë të ndërtuara me materiale cilësore bashkëkohore të cilat plotësojnë kushtet higjieno-sanitare për studentët dhe personelin akademik e administrativ. (Evidenca IV.9.1 <i>Leje higjieno sanitare</i>). Godinat plotësojnë standartet teknike dhe ofrojnë akustikë të mirë dhe janë të izoluar nga zhurmat, luhatjet e temperaturës dhe lagështirës. Godinat shtrihen në qendër të zonës urbane larg zonave të zhvillimit industrial apo me ndotje, të cilat gjenden në periferi të qytetit.</p> <p>UGJ i plotëson normativat teknike të ndriçimit natyral, sipërfaqja e dritareve mbulon minimalisht (15 – 20) % të sipërfaqes së dyshemesë dhe ndriçimi është i orientuar nga krahu i majtë i studentit, dhe lartësia e ambienteve është jo më e vogël se 3.0 m (tavan-dysheme). UGJ ka një sistem të mbrojtjes së shkarkesave atmosferike si dhe një sistem të mbrojtjes kundra zjarrit. Çdo godinë është e pajisur me sinjalizues dhe në hollet e çdo godine janë të instaluar bombola kundra zjarrit si dhe hidratantë, të cilët janë të shoqëruar edhe me sinjalistikën përkatëse (Evidenca IV.9.2 <i>Çertifikatë për sigurinë nga zjarri</i>).</p> <p>Institucioni siguron në pjesën më të madhe të sallave dhe zyrave sisteme ajri të kondicionuar, ndërkohë që Godinat A, B dhe C kanë të instaluar sistemin e ngrohjes së centralizuar (kaldaja). UGJ disponon burime alternative për furnizimin me energji elektrike (1 motogenerator në Godinën A) dhe rezerva të mjaftueshme të ujit të përdorshëm, pasi uji është i pandërprerë 24 orë.</p> <p>Bazuar në Raportin e MASR-së mbi “Verifikimin e kapaciteteve pritëse për pranimet në programet e studimit, sipas kuotave të deklaruara për vitin akademik 2023-2024”, UGJ ofron një normativë të pritshme mesatare prej 2.5 m²/student, llogaritur kjo në dy fasha orare kjo normativë shkon në 5 m²/student (Evidenca II.13.2 <i>Raporti i kapaciteteve pritëse, viti akademik 2023-2024</i>)</p> <p>UGJ siguron mjediset të përshtatshme në funksion të veprimtarisë mësimore dhe në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit Bachelor në “Mësiësi për Arsimin Parashkollor” dhe lëndëve të tij, si dhe në përputhje me standartet dhe normativat për infrastrukturën, të përcaktuara në V.K.M Nr.418, datë 10.05.2017 “Për standartet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe të degëve të tyre. (Evidenca IV.1 <i>V.K.M Nr.418, datë 10.05.2017</i>; Evidenca II.13.2 <i>Raporti i kapaciteteve pritëse viti akademik 2023-2024</i>; Evidenca IV.9 <i>Infrastruktura e UGJ</i>). ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE Mjediset e Fakultetit/Njësië Bazë (Tabela 16)</p>

	Veprimtaria mësimore si leksionet, seminarët dhe laboratorët e lëndëve zhvillohen specifikisht sipa llojit të lëndës në të tre mjedisët e Godinabe A, B dhe C.
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Për realizimin e programit të studimit Master Profesional në “Mësisë në Arsimin Special”, UGJ ka vendosur në dispozicion të Njesisë Bazë të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimshënies mjedise mësimore si klasa, laboratorë, si dhe mjedise të tjera për personelin akademik dhe mndihmës akademik (të Njësive Bazë të tjera), të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që kanë akses të plotë në rrjetin Lan dhe WiFi, në ndihmë të përgatitjes, dhe të realizimit të procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. (Evidenca III.2. Inventari i mjeteve didaktike e teknologjike në NJBEMM; Evidenca III.3 Inventari i laboratorit pedagogjik NJBEMM)
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Për plotësimin e kërkesave të lëndëve mësimore, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special” janë në disponon jo vetëm mjediset didaktike dhe laboratorike të NJBEMM (Evidenca III.2. Inventari i mjeteve didaktike e teknologjike në NJBEMM; Evidenca III.3. Inventari i laboratorit pedagogjik në NJBEMM), por edhe të njësive të tjera ku zhvillohen lëndët nga personeli i tyre i angazhuar në këtë program studimi. Zhvillimii programeve lëndore nga personeli akademik që janë pjesë e Njësive bazë nga FESHSH kanë në dispozicion mjediset përkatëse laboratorike dhe didaktike të njësive përkatëse. (Evidenca IV.9 Infrastruktura e UGJ)
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Për realizimin e programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, UGJ siguron laboratorë të karakterit pedagogjik, të cilët janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që kanë akses të plotë në rrjetin Lan dhe WiFi Internet. UGJ zotëron laboratorë mësimorë të cilët janë të pajisur me pajisje elektronike dhe të IT-së, sinjal internet free, të cilat garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodave teknologjike bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies. (Evidenca IV.9. Infrastruktura e UGJ; Evidenca III.2. Inventari i mjeteve didaktike e teknologjike në NJBEMM; Evidenca III.3. Inventari i laboratorit pedagogjik në NJBEMM)
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të	Programi i studimit në strukturën e tij ka në vitin e dytë praktikë profesionale, e cila për nga specifika zhvillohet në mjediset shkollore të arsimit parauniversitar. Për realizimin e saj janë në dispozicion marrëveshjet institucionale dhe rregullore e praktikave. (Evidenca I.30 Rregullore e praktikave profesionale në FESHSH; Evidenca I.31 Marrëveshje institucionale për praktikën mësimore në FESHSH)



Handwritten signatures in blue ink at the bottom of the page, including several illegible signatures and the initials 'A. J.' and 'E.'.

posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	<p>Në zbatim të Rregullores së studimeve në UGJ, literature bazë e detyrueshme përbëhet nga tekstet mësimore dhe ciklet e leksioneve. (Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në UGJ, Neni. 27; Evidenca I.5 Rregullore e Njesisë Kryesore FESHSH, Neni. 22; Evidenca I.7 Rregullore e Njesisë Bazë të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies Neni. 15; Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, Neni. 21)</p> <p>Literatura bazë dhe ndihmëse e lëndëve që i përkasin fushës së edukimit ofrohet kryesisht në gjuhën shqipe dhe mbështetet kryesisht në tekste mësimore të botuara nga universitete të tjera ose cikle leksionesh të përgatitura nga lektorët mbi bazën e eksperiencave të universiteteve partnere brenda dhe jashtë vendit. Literatura bazë dhe ndihmëse miratohet nga Njësia Bazë me propozimin e titullarit/pedagogut të lëndës. (Evidenca II.22.1 Miratimi i literaturës bazë 2020-2021 në NJBEMM; Evidenca II.22 Miratimi i literaturës bazë 2021-2022, NJBEMM)</p> <p>Kjo literaturë e cila ofrohet kryesisht në gjuhën shqipe pasqyrohet në programet lëndore (Evidenca II.27.1 Programet lëndore (syllabuset) të Programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special” 2022-2023, 2023-2024), dhe u vihet në dispozicion studentëve në formë fizike dhe/ose elektronike, dhe garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në këtë program studimi.</p> <p>Gjithashtu dhe fondi i literaturës fizike dhe online në bibliotekë mbështet marrjen e dijeve të nevojshme në këtë program studimi.</p> <p>Literatura bazë dhe ndihmëse miratohet nga Njësia Bazë me propozimin e titullarit/pedagogut të lëndës (Evidenca I.5 Rregullore e Njesisë Kryesore FESHSH, Neni. 21, Neni. 22; Evidenca I.7 Rregullore e Njesisë Bazë të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies Neni. 15; Evidenca I.9 Rregullore</p>

	<p>e Programit të Studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, Neni. 21; Evidenca II.22.1 Miratimi i literaturës bazë 2020-2021 në NJBEMM; Evidenca II.22 Miratimi i literaturës bazë 2021-2022, NJBEMM) dhe pasqyrohet në programet lëndore të programit të studimit (Evidenca II.27.1 Programet lëndore (syllabuset) të Programit të studimit Master Profesional në “Mësuesi në Arsimin Special”, 2022-2023, 2023-2024).</p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Departamenti, përpara miratimit të buxhetit vjetor institucional, paraqet propozimin e tij për përditësimin e literaturës me botime të viteve të fundit. (Evidenca IV.10. Kërkesë për blerje librash. Evidenca V.10.1 Të dhëna për NJBEMM) Propozimet e Njesisë Bazë miratohen sipas procedurave përkatëse të Institucionit. Edhe Biblioteka paraqet kërkesat e saj për pasurimin e fondit të saj në çdo fillim viti akademik, duke kërkuar të ketë një zë përkatës në buxhet Përveç pasurimit periodik që realizohet me fondet e UGJ-së, literatura e bibliotekës pasurohet edhe përmes donacioneve të miqve të UGJ-së (Evidenca III.9 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>UGJ vë në dispozicion të studentëve dhe personelit akademik, në mbështetje të procesit mësimor dhe formimit të tyre profesional Bibliotekën Akadematike e cila ndodhet Godinën C të Universitetit.</p> <p>Biblioteka disponon 3 (tre) salla leximi, të cilat janë të pajisura me kompjutera dhe me mjete audio vizive. Biblioteka ka një fond librash në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaja, në të cilat gjendet një numër tekstesh të fushës së programit të studimit MP MAS. Biblioteka shërben edhe si sallë internet. (Evidenca III.9 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit)</p> <p>Të gjithë studentët kanë mundësi të barabarta në përdorimin e saj. Literatura mësimore mund të shfrytëzohet në ambientet e bibliotekës ose dhe jashtë saj. Studenti disponon një kartelë personale të përdoruesit, përmes të cilës siguron literaturën. Kartela personale e përdoruesit përmban informacionin si: numrin e kartelës, emër, mbiemër, atësinë, adresën e banimit, numrin personal të identifikimit, numrin e telefonit, fakultetin, degën etj, si dhe nënshkrimin e përgjegjësit të bibliotekës dhe lexuesit. (Evidenca IV.11 Biblioteka, Kartelë personale e përdoruesit).</p> <p>UGJ ka vënë në dispozicion edhe përdorimin e librarive elektronike ku studentët mund të shfrytëzojnë edhe materiale ndërkombëtare. (Evidenca III.9 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit)</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e</p>	<p>Literatura e ofruar, përmes Bibliotekës është multidisiplinare. Në bibliotekë gjenden tituj nga fusha të ndryshme studimi, Të interesuarit gjejnë në Bibliotekë literaturë për çështje të përgjithshme, për shkencën dhe diturinë, për filozofinë, psikologjinë, shkencat shoqërore dhe nëndarjet e tyre, ekonominë dhe nëndarjet e saj, drejtësinë, matematikën dhe shkencat e natyrës, shkencat e aplikuar si mjekësia dhe teknologjia, linguistika dhe letërsia, historia, gjeografia, si dhe materiale që trajtojnë artin, kulturën dhe sportin.</p> <p>UGJ ka vënë në dispozicion përdorimin e librarive elektronike ku studentët mund të konsultohen me materiale ndërkombëtare. (Evidenca III.9 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit). Stafi akademik i Njesisë Bazë të UGJ-</p>

veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	së që janë të angazhuar në këtë program studimi shfrytëzojnë dhe literaturën shkencore sipas profilit të tyre.
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	UGJ, në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, mbështur prej MAS, ka mundësuar për stafin akademik dhe studentet shërbimin e bibliotekës on-line "U-LIBRARY" (https://ulibrary.rash.al/) Në faqen ëeb të UGJ-së (https://uogj.edu.al/biblioteka-online/), personeli akademik dhe studentët kanë mundësi të aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit duke ndjekur udhëzimet e manualit përkatës (<i>Evidenca IV.11.1. Bibloteka manuali i perdorimit</i>) i cili gjendet po në këtë faqe. Ky shërbim ofrohet pa pagesë për studentët dhe stafin akademik. Falë abonimit të Bibliotekës në revista shkencore, është e mundur nga ana e studentëve/pedagogeve të shfrytëzohet literaturë online, e cila është në gjuhë të huaj. (<i>Evidenca III.9 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit</i>)
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka është e pajisur me kompjutera, programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. (<i>Evidenca III.9 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit</i>)
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka (<i>Evidenca IV.11.2. Rregullore e bibliotekës</i>) ofron shërbimin prej punonjësve të saj për studentët dhe personelin akademik çdo ditë të javës, e Hënë-e Premte (me përjashtim të ditëve zyrtare të pushimit) në orarin 8.00--19.00. orar ky në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. Orari është i shpallur në mjediset e institucionit dhe në hyrje të bibliotekës. Për çdo student kakartelë personale të përdoruesit. (<i>Evidenca IV.11.2 Rregullore e Bibliotekës; Evidenca IV.11 Biblioteka, Kartelë personale e përdoruesi</i>)
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah	Biblioteka ndjek dhe raporton mbi cilësinë e fondit fizik të saj dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah efektshmërinë e përpjekjeve për pasurim të fondit fizik, dhe atij online. (<i>Evidenca III.9 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit; Evidenca IV.11.2 Rregullore e Bibliotekës; Evidenca IV.11 Biblioteka, Kartelë personale e përdoruesi; Evidenca V.10.1 Të dhena për NJBEMM</i>)



sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë është pjesë e rrjetit akademik shqiptar RASH dhe QSHA. Nëpërmjet platformave që ofrojnë këto struktura realizohet procesi i aplikimit dhe regjistrimit on-line të kandidatëve (maturantëve U-Albania) në programet e Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, si dhe matrikullimi i studentëve bazuar në të dhënat e detajuara të përcjella nga Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë.</p> <p>Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë në përputhje me Neni. 101 të Ligjit të arsimit të lartë, Statutin e Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë (<i>Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Neni. 44</i>) si dhe Rregullore e Sekretarisë Mësimore (<i>Evidenca III.13 Rregullore e sekretarisë mësimore, Neni. 4</i>) administrojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • regjistrin themeltar të studentëve; • regjistrin e arritjeve akademike; • regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave <p>Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë disponon gjithashtu sistemin elektronik Pitagora (https://uogi.pitagora.rash.al/login), aplikacion softuerik i sekretarisë online i zhvilluar nga RASH (Rrjeti akademik shqiptar) që ofron funksionalitete për administratën, sekretarinë dhe përdoruesit fundor (student, pedagog, etj) për menaxhimin e të gjithë ciklit akademik të studimeve universitare: si regjistrimi në syllabuset e kurseve, vlerësimet, procesverbalet e provimeve, diplomimi, transferimet ndërmjet universiteteve dhe mbartja e krediteve të fituara, etj.</p> <p>Disa nga funksionalitetet kryesore janë:</p> <p>Hapësira didaktike: Struktura Akademike, Menaxhimi i Karrierës së Studentit, Provime dhe Tema e Diplomës</p> <p>Hapësira administrative: Pranimi dhe Regjistrimi, Orari dhe provimet, Menaxhimi i Studentëve</p> <p>Tarifat: Menaxhimi i Tarifave të studimit, Bursa për studentët, Periudha Financiare</p>

	<p>Diplomimi: Provimet e Shtetit, Praktika studentore, Diploma Online dhe Suplementi</p> <p>Në Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër ka funksionuar për disa vite edhe sistemi elektronik i automatizimit të proceseve të sekretarive mesimore dhe shërbimeve online për studentët ESSE3 me funksionalitetet e përcaktuara në Rregulloren e programit të dixhitalizimit të sistemit universitar Esse3 (<i>Evidenca IV.12 Rregullore e programit të dixhitalizimit të sistemit universitar Esse3</i>)</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Në Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër menaxhimi i dokumentacionit të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ realizohet nga Drejtoria e Shërbimeve Ndhmës Akadematike – Administrative, nëpërmjet Sektorit të Shërbimeve Juridike, Personelit dhe Sekretari Protokoll menaxhon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • regjistrin themeltar • dosjet personale të punonjësve • librezat e punës së punonjësve • dokumentacion tjetër të dhënë nga Rektori, apo administratori. <p>(<i>Evidenca IV.5.Rregullore e Drejtorisë së Shërbimeve Ndhmës Akadematike – Administrative, Neni. 3, Neni. 4, Neni. 5</i>)</p> <p>Sektori i kërkimit shkencor dhe marrëdhënive me jashtë administron dhe përditëson bazën e të dhënave të kërkimit shkencor të personelit akademik dhe kërkimor (<i>Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Neni. 82</i>)</p> <p>Bazuar rregulloren e FESHSH (<i>Evidenca I.5 Rregullore e Njesisë Kryesore FESHSH</i>), Fakulteti dhe Departamenti ruan me kujdes dokumentacionin përkatës në lidhje me personelin akademik si: ngarkesën vjetore mesimore, marrëveshjet e realizimit të kohës vjetore të punës, syllabuset etj. (<i>Evidenca IV.8 Model i Ngarkesës Mësimore; Evidenca IV.8.1 Model planifikimi i kohës vjetore të punës; Evidenca II.27.1.Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, viti akademik 2022-2023, 2023-2024</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër nëpërmjet sistemit elektronik Pitagora u siguron akses të dedikuar dhe konfidencial në informacione dhe dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit të ciklit të parë Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”.</p> <p>Çdo personel akademik e ndihmësakademik (sekretaria mesimore) ka akses në llogarinë e tij ku shfaqen të dhëna rreth lëndëve, sezoneve të provimeve, oraret e tyre dhe listën e studentëve që janë regjistruar për të frekuentuar këto lëndë. Nëpërmjet këtij sistemi, pedagogu dhe/ose personeli ndihmësakademik akseson dokumente të tipit procesverbale me rezultatet e studentëve sipas llojit të detyrës ose sezonit.</p> <p>Ndërsa studentët mund të aksesojnë informacione dhe të dhëna rreth statusit të tyre, lëndëve që mund të frekuentojnë, vlerësimet e çdo forme kontrolli në çdo lëndë etj. Secili përdorues e menaxhon në mënyrë të pavarur llogarinë e tij. (https://uogj.pitagora.rash.al/login) Gjithashtu informacionet dhe dokumentacionet në lidhje me programin e studimit si Rregullore e programit të studimit, Misioni i programit të studimit, plani mësimor, struktura mësimore, oraret mësimore etj janë</p>

	të publikuara edhe në Faqen zyrtare Web të Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër (https://uogj.edu.al/)			
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Format e komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve përfshijnë përveç faqes Web dhe postës elektronike zyrtare edhe platformatelektronike si: Office 365, Teams etj. (https://uogj.edu.al/platforma-office-365-dhe-teams-për-mësimin-online/); (Evidenca III.1.4 Manual i përdorimit të platformës TEAMS për stafin akademik; Evidenca III.1.5 Manual i përdorimit të platformës TEAMS për studentët) Gjithashtu, në kuadër të projektit Erasmus plus Tecomp në Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër është pilotuar edhe platforma elektronike “Learning Key” me funksionalitete si Krijimi i kurrikulës, Krijimi i detyrave të shtëpisë, Platforma e testimit, Klasë virtuale, Programuesi i klasës, Kalendarit personal, Menaxhimi i grupeve, Krijimi i brandit personal etj. (Evidenca IV.15 Urdhër për përdorimin e platformës Learning Key)][adresa Lerning key http://www.tecomp.ni.ac.rs/]			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Platformat elektronike të sipërpërmenduar (ESSE3, Pitagora, Office 365, Teams, Learning Key) garantojnë monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. Sipas nevojave, këto sisteme mundësojnë raportime individuale mbi ecurinë akademike të studentëve, pagesën e tarifës së studimit, monitorimin dhe afatet e hedhjes së vlerësimeve nga ana e personelit akademik etj.			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Në faqen zyrtare Web të NJBEMM, bazuar në Statutin e Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër (Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Neni. 60), publikohen: <ul style="list-style-type: none"> • Informacionet që lidhen me programin e studimit si: Rregullorja e programit të studimit, Misioni i programit të studimit, plani mësimor i tij, struktura mësimore, orari mësimor, kalendarit i provimeve etj. • Informacione mbi NJBEMM dhe personelin akademik të tij. • Informacione mbi aktivitetet e ndryshme etj. të cilat janë në gjuhën shqipe dhe angleze. Faqja zyrtare web http://uogj.edu.al/			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për	Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër harton një raport financiar të kostove dhe mbështetjes financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit. Hartimi i këtij raporti financiar bazohet në Statutin e Universiteti “Eqrem Çabej”

<p>programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Gjirokastër dhe bëhet sipas modelit të buxhetit të shtetit, i përcaktuar në udhëzimin përkatës të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. (Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Neni. 103)</p> <p>Projekt buxheti vjetor hartohet nga administratori, mbi bazën e propozimeve të njesive kryesore dhe njesive bazë, mbështetur në planin strategjik të zhvillimit të Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër, planin buxhetor afatmesëm dhe miratohet nga Bordi i Administrimit me propozim të Senatit Akademik. (Evidenca IV.13 Propozim buxheti njësisia bazë; Evidenca I.3 Strategjia e zhvillimit të Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër 2020-2025, Kreu Financat dhe Burimet Financiare, faqe 34; Evidenca IV.13.4 Projekt Buxheti për vitin 2023 dhe programi i buxhetit afatmesëm 2023-2025). Pas miratimit buxheti i detajuar kalon për menaxhim në Drejtorinë e Shërbimeve Universitare dhe delegohet në varësi të kërkesave apo nevojave të njesive.</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase</p>	<p>Plani i financimit institucional përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë. (Evidenca IV.13.1 Raporti vjetor financiar për vitin 2020; Evidenca IV.13.2 Raporti vjetor financiar për vitin 2021; Evidenca IV.13.3 Raporti vjetor financiar për vitin 2022) [ANEKS-Tabelat Përmbledhëse-Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit (Tabela 18)]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij në menyre periodike. Drejtoria e Shërbimeve Universitare harton dhe paraqet Raportin Financiar Vjetor, sipas kërkesave ligjore në fuqi ku paraqiten të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet. (Evidenca IV.16.2 Raporti vjetor financiar për vitin 2020; Evidenca IV.16.3 Raporti vjetor financiar për vitin 2021; Evidenca IV.16.4 Raporti vjetor financiar për vitin 2022)</p> <p>Gjithashtu në mënyrë periodike Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër, si çdo institucion public, i nënshtrohet auditit financiar prej Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe MAS (Evidenca IV.14 Raporti përfundimtar i KLSH-së për performancën e Universiteteve; Evidenca IV.14.1 Raport i MASR AUDIT 2018; Evidenca IV.14.2 Raport i MAS AUDIT 2022)</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Drejtoria e Shërbimeve Universitare dhe Administratori raportojnë për realizimin e buxhetit të miratuar në vitin paraardhës në Senatit akademik të Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër dhe Bordin e Administrimit. (Evidenca IV.13.1 Raporti vjetor financiar për vitin 2020; Evidenca IV.13.2 Raporti vjetor financiar për vitin 2021; Evidenca IV.13.3 Raporti vjetor financiar për vitin 2022)</p>

<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Burimet e financimit të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, si institucion publik janë dy :</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Financim nga buxheti i shtetit; 2. Financim nga të ardhurat detyësore të cilat sigurohen nëpërmjet studenteve si: tarifat e regjistrimit, tarifat e shkollimit, dhe të ardhurat nga shërbime të tjera që ofron institucioni. <p>Më qëllim mirë menaxhimit të këtyre fondeve dhe sigurimit të një qëndrueshmërie financiare, gjatë analizës financiare vjetore shqyrtohet edhe realizimi i treguesve mbi zbatimin e politikës financiare të vet institucionit. (<i>Evidenca IV.13.1 Raporti vjetor financiar për vitin 2020; Evidenca IV.13.2 Raporti vjetor financiar për vitin 2021; Evidenca IV.13.3 Raporti vjetor financiar për vitin 2022</i>) [ANEKS-Tabelat Përmbledhëse, Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit (Tabela 18)]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>


<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>




V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p> <p>Pranimet e studentëve në Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër në të gjitha programet e studimeve bëhen me vendim të Senatit Akademik, në përputhje me standartet shtetërore, të kapaciteteve akademike dhe infrastrukture, kuotave dhe kritereve të propozuara nga Njësia bazë si dhe legjislacionin në fuqi. (Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Neni. 62; Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Neni.50; Evidenca I.5 Rregullore e Njesisë Kryesore FESHSH, Neni. 17; Evidenca I.7 Rregullore e Njesisë bazë të EMM, Neni. 10; Evidenca V.1 Udhëzim-Nr.12-datë-30.6.2023-Për-procedurat-e-aplikimit-dhe-të-regjistrimit-në institucionet-e-arsimit-të-lartë; Evidenca V.1.1 Urdhër i përbashkët RASH dhe QSHA nr. 10 datë 10.07.2023, Për miratimin e kalendarit 2023-2024; Evidenca V.2. Kuotat e pranimit viti akademik 2023 – 2024; Evidenca V.2.1 Kriteret e panimit për vitin akademik 2023-2024; Evidenca II.13.1 Kriteret e pranimit të studentëve 2022-2023. Evidenca II.13. Vendim SA për kriteret 2022-2023; Evidenca II. 13.3 Kuotat e propozuara të pranimit të studentëve 2022-2023; Evidenca II.12. Vendim SA për kuotat 2021-2022 Evidenca II.11.1 Kuotat e popozuara të pranimit të studentëve 2021-2022)</p> <p>Kohëzgjatja normale e studimeve në programin Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special” është 2 (dy) vite akademike. Programi i studimit është i organizuar në lëndë dhe i vlerësuar me kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) Programi i referohet nivelit 7-të të Kornizës Shqiptare të Kualifikimit.</p> <p>Studenti në përfundim të programit të studimit duhet të grumbullojë 120 kredite. Studentët në programet e ciklit të dytë të studimeve diplomohen me provim përfundimtar ose punim diplome. Në përfundim të programeve të ciklit të dytë lëshohet diploma: Diplomë universitare Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”.</p> <p>(Evidenca II.9.1 Plani mësimor Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, viti 2022-2023; Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”; Evidenca II.5. Model diplome)</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë</p>	<p>Statuti i Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër (Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Neni. 65, pika 6 dhe KREU XI) përshkruan qartë kriteret e pranimit të studentëve në ciklin e dytë të studimeve si dhe të drejtat</p>

<p>dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>dhe detyrimet e studentëve gjatë studimeve universitare, të cilat udhëhiqen nga parimi i barazisë.</p> <p>Rregullorja e Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Rregullorja e FESHSH-së dhe Rregullorja e Njesisë Bazë (Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër; Evidenca I.5. Rregullore e Njësise Kryesore FESHSH; Evidenca I.7 Rregullore e Njesisë Bazë të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies; Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastër) përmbajnë në mënyrë të detajuar procedurat dhe praktikat e trajtimit të studentëve që nga regjistrimi i tyre, e deri në përfundim të studimeve, apo procedurat dhe praktikat e transferimit të tyre, gjë që garanton qartësisht politika dhe procedura transparente për trajtim të barabartë dhe të drejtë për të gjithë kandidatët dhe studentët e programit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special” (Evidenca V.3 Dosja personale e studentit; Evidenca II.20 Procedurë e transferimit të studentëve)</p> <p>Në faqen zyrtare web të institucionit publikohen informacione mbi kriteret dhe kuotat e pranimeve për çdo vit akademik si dhe Rregulloret institucionale për ecurinë akademike të studentëve.</p> <p>(https://uogj.edu.al/kriteret-dhe-kuotat-e-pranimit/; https://uogj.edu.al/statuti-i-universitetit/; https://uogj.edu.al/rregullore-e-universitetit/)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve aplikant propozohen nga Njësiti Bazë (Evidenca.V.2 Kuotat e pranimit viti akademik 2023–2024; https://uogj.edu.al/kriteret-dhe-kuotat-e-pranimit/)</p> <p>Propozimet nga njësiti bazë, përcillen në Rektorat dhe miratohen nga Senati akademik. (Evidenca V.2.1 Vendim Senati për miratimin e kriterëve 2024-2025 dhe kuotave për 2023-2024)</p> <p>Këto kriteret janë në përputhje me VKM-të në fuqi.(Evidenca V.1.2 VKM. Nr 436 për kriterin e mesatares; Evidenca.V.1.3 Vendimi Nr. 46 i kriterit të mesatares i përditësuar)</p> <p>Kuotat e pranimit të studentëve të ciklit të dytë të miratuara nga Njësiti Bazë në raport me kapacitetin pritës, parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj nga Republika e Kosovës si dhe nga trojet shqip folëse të shteteve të tjerë. (Evidenca V.2. Kuotat e pranimit viti akademik 2023-2024; Evidenca V.2.1 Vendim Senati Akademik për miratimin e kriterëve 2024-2025 dhe kuotave 2023-2024)</p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme</p>	<p>Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p> <p>Pranimi i studentëve realizohet sipas sistemit meritë-preferencë, ku programet e studimit të ofruara nga Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër, u bëhen të ditura paraprakisht kandidatëve për studentë në faqen zyrtare. Gjithashtu, në</p>



<p>ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>faqen zyrtare publikohen edhe kriteret e pranimit, të përcaktuara për program të dytë studimi.</p> <p>Në Rregulloren e Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Rregulloren e FESHSH, Rregulloren e Njesisë bazë (<i>Evidenca I.2 Rregullore e Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni. 50; Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni. 55; Evidenca I.5 Rregullore e Njesise Kryesore FESHSH, Neni. 17; Evidenca I.7.Rregullore e Njesisë Bazë të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies, Neni. 10</i>) përshkruhen kriteret dhe procedurat e regjistrimit, ecuria akademike, procesi i transferimit dhe kriteret dhe procedurat e diplomimit.</p> <p>Informacioni mundësohet gjithashtu nëpërmjet faqes zyrtare ueb të Universitetit, (www.uogj.edu.a;) sekretarisë mësimore e FESHSH-së, sistemit të sekretarisë mësimore (https://uogj.pitagora.rash.al/login) si dhe shpalljeve në këndin e njoftimeve.</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p> <p>Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë nëpërmjet zyrës së Alumni, Këshillit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar dhe Fakultetet e tij, përfshirë edhe Fakultetin e Edukimit dhe Shkencave Shoqërore dhe NJBEMM, realizojnë komunikimin me publikun e interesuar për ndjekjen e programit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, nëpërmjet disa formave:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Publikimit në faqen Web të UGJ të informacioneve rreth programeve të studimit, përmbajtjes së tyre, diplomave që ofron dhe mundësive të punësimit, kriterëve të përgjithshme e të veçanta për ndjekjen e tyre etj. (http://uogj.edu.al/fakultetet/fakulteti-i-edukimit-dhe-shkencave-shoqerore/feshsh-departamente/departamenti-i-edukimit-dhe-metodologjise-se-mesimdhenes/demm) - Organizimit të takimeve promovuese, me nxënës maturan të shkollave të mesme. - Informimit nëpërmjet rrjeteve sociale. - Informimit nëpërmjet mediave lokale. - Informimit nëpërmjet fletëpalosjeve dhe posterave <p>(<i>Evidenca V.2. Kuotat e panimit për vitin akademik 2023-2024; Evidenca V.2.1 Vendim Senati Akademik për miratimin e kriterëve 2024-2025 dhe kuotave 2023-2024; Evidenca II.15 Pjesëmarrje në Panair Work and Study 2022; Evidenca II.15.1 Pjesëmarrje në Panair Work and Study 2023; Evidenca V.4. Kalendari i zhvillimit të ditëve të informimit të maturanëve; Evidenca V.4.1 Relacion mbi ecurinë dhe realizimin e ditëve të informimit të maturanëve; Evidenca V.4.2 Relacion mbi ecurinë dhe realizimin e ditëve të hapura për maturanët; Evidenca V.4.3 Fletëpalosje Universiteti; Evidenca V.4.4 Poster Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë</i>)</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon</p>	<p>Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë parashikon kuota të posaçme dhe kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe</p>




përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara.	shtresave të margjinalizuara si dhe zbaton udhëzimet përkatëse për aplikimin dhe regjistrimin e tyre. (Evidenca V.2 Kuotat e pranimit viti akademik 2023–2024; Evidenca V.2.1 Vendim Senati Akademik për miratimin e kriterëve 2024–2025 dhe kuotave 2023–2024; Evidenca V.1. Udhëzim-Nr.12-datë-30.6.2023-Për-procedurat-e-aplikimit-dhe-të-regjistrimit-në-institucionet-e-arsimit-të-lartë)			
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër parashikon kuota të posaçme dhe kriteret për përzgjedhjen për kandidatët nga shtetet e tjera dhe kryesisht nga Republika e Kosovës si dhe nga trojet shqipfolëse të shteteve të tjera si Maqedoni e Veriut, Mali i Zi, Preshevë, Bujanovc dhe Medvegje dhe të Huaj. (Evidenca V.2. Kuotat e pranimit viti akademik 2023–2024; Evidenca V.2.1 Vendim Senati Akademik për miratimin e kriterëve 2024–2025 dhe kuotave 2023–2024; Evidenca V.1. Udhëzim-Nr.12-datë-30.6.2023-Për-procedurat-e-aplikimit-dhe-të-regjistrimit-në-institucionet-e-arsimit-të-lartë)			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Institucioni harton politika dhe realizon procedurat përkatëse të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë sipas vendimeve të Bordit të Administrimit në Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër. (Evidenca II.14 Vendime BA për bursat dhe kategoritë e vecanta; Evidenca II.14.4 Vendim Senati për heqjen e tarifës në programet e mësuesisë; Evidenca II.14.5 Vendim Bordi i Administrimit për heqjen e tarifës për programet e mësuesisë)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Institucioni informon në mënyrë të plotë dhe të hollësishëm studentët që në vitin e parë të studimeve të tyre, në lidhje me procedurat e përparimit akademik dhe kalimin nga një vit në tjetrin. Me fillimin e viti akademik, studentët marrin informacione të rëndësishme në lidhje me procesin mësimor, planin mësimor, strukturën mësimore, orarin mësimor, pedagogun e lëndës, të publikara në ambjentet e FESHSH dhe në faqen zyrtare web(https://uogj.edu.al/) të institucionit. Në fillim të çdo semestri pedagogët ju prezantojnë studentëve syllabuset e lëndëve, procedurat për përparimin akademik, detyrimet mbi frekuentimin e lëndës format e kontrollit të dijes gjatë lëndës dhe vlerësimit të studentëve etj.

	<p>Gjithashtu informacionet në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimin nga një vit në tjetrin janë të përshkuara hollësisht në rregulloret institucionale. (Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Kreu VI,VII; Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Kreu III,IV,V,VI,VII,VIII; Evidenca I.5 Rregullore e Njesisë Kryesore FESHSH Kreu V,VI,VII; Evidenca I.7 Rregullore e Njesisë Bazë të EMM, Kreu V,VI,VII,VIII)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme., njohjes dhe transferimit të krediteve midis programeve të të njëjtit cikël studimi, dhe në fusha studimi të njëjta ose të përafërta, në fillim të vitit akademik, brenda Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër dhe në institucione të tjera të arsimit të lartë sipas përcaktimeve në Statutin e Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër-së (Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Neni. 72) dhe Rregullores së Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër-së (Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni. 65; Evidenca I.5. Rregullore e Njesisë Kryesore FESHSH; Evidenca I.7 Rregullore e Njesisë Bazë të EMM, Nenet 23, 24)</p> <p>Informacion më i detajuar, sidomos në lidhje me dokumentacionin e nevojshëm, merret pranë sekretarisë mesimore dhe nëpërmjet shpalljes së njoftimeve në stendat e informimit në Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër. Procedura e njohjes dhe ekuivalentimit të lëndëve mesimore nga programi i mëparshëm i studimit në programin e studimit në Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër kryhet nga Komisioni i njohjeve dhe ekuivalentimit të lëndëve mesimore, i ngritur pranë NJBEMM-së. (Evidenca V.5 Ekuivalentim lëndësh mesimore NJBEMM; Evidenca V.5.2 Program lëndor dokument për studentë e diplomuar; Evidenca II.20 Procedure e transferimit të studentëve)</p> <p>Gjithashtu, NJBEMM kryen procedura njohjeje [(Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni. 92, pika 2; Evidenca V.5.1 Njohje e krediteve nga mobilitetet Erasmus+) në kohë dhe me efikasitet në lidhje me periudha studimi që studentët e NJBEMM-së realizojnë në kuadër të programeve të shkëmbimit(mobiliteteve) Erasmus+]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar ne Rregulloret institucionale (Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër Kreu VI,VII; Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Kreu III,IV,V,VI,VII,VIII; Evidenca I.5 Rregullore e Njesisë Kryesore FESHSH, Kreu V,VI,VII; Evidenca I.7 Rregullore e NJBEMM, Kreu V,VI,VII) Njësia Bazë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit., duke përfshirë: sistemin e vlerësimit, format e vlerësimit, format e kontrollit te dijeve, kushtet për hyrjen në provim, sezonet e provimeve, organizimin e provimeve, komisionet e provimit, zhvillimin e provimit, shpalljen e rezultateve, te provimit, ankimmimin dhe përmirësimin e notës. Ky informacion u bëhet me dije studentëve në fillim si dhe gjatë vitit akademik.</p>



<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Në programet e studimit të ciklit të dytë studentët diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome, mbështetur në Kreun VIII Diplomimi, të Rregullores së Studimeve në Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, (Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Nenet. 59, 60, 61, 62, 63, dhe 64), në Rregulloren e Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë (Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni. 93) në Kreun VII Diplomimi, të Rregullores së FESHSH (Evidenca I.5 Rregullore e Njesisë Kryesore FESHSH, Nenet 39, 40) në Rregulloren e programit të studimit MP MAS (Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, Kreu V) si dhe planin mësimor të programit të studimit. (Evidenca II.9.2 Plani mësimor Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, 2022-2023)</p> <p>Në rregulloren e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Rregulloren e FESHSH dhe Rregulloren e programit të studimit në Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, përcaktohet qartë pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit duke përgatitur dhe mbrojtur një punim diplome. (Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni. 59, pika 3; Evidenca I.5. Rregullore e Njesisë Kryesore FESHSH, Neni. 39, pika 2; Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, Kreu V, Neni 23, pika 2).</p> <p>NJBEMM asiston studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të punimit të diplomës ose të provimit të përgjithshëm përfundimtar.</p> <p>NJBEMM, në fillim të vitit të fundit të studimeve përcaktojnë fushat e studimeve për punimin e diplomës (Evidenca III.11.2. Miratimi i fushave të diplomës). Udhëheqësi i temës së diplomës përgatit programin e punës së studentit duke vendosur afatet e përafërta të realizimit të tij, përcakton grafikun e konsultimeve të programuara me studentin përgjatë të cilave konsultohet dhe kontrollohet puna e bërë sipas programit të miratuar. Para mbrojtjes së tezës së diplomës udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer nga studenti dhe lejon mbrojtjen e punimit duke firmosur tezën e diplomës.</p> <p>Punimi i diplomës bëhet duke mbajtur në konsideratë udhëzimet në Manualin e punimit të diplomës, sipas shtojcës bashkëngjitur Rregullores së studimeve në Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë. (Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni. 61; Evidenca III.11.1. Manuali i punimit të diplomës, Shtojcat e Rregullores së Studimeve; Evidenca III.11.2. Miratimi i fushave të diplomës).</p> <p>Studentët të cilët diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar asistohen nga NJBEMM, duke ju vënë në dispozicion të tyre Programin e provimit të përgjithshëm përfundimtar. (Evidenca III.11. Programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar Master Profesional në “MNEGJ”)</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në</p>	<p>Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë organizon takime të hapura dhe publikon udhëzues</p>

mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	të posaçëm për informimin e maturantëve dhe të interesuarve mbi programet e studimit në Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë. Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë informon gjithashtu edhe nëpërmjet spoteve televizive dhe fletëpalosje promovuese programet e studimit që ofron. (Evidenca II.15 Pjesëmarrje në Panair work and Study 2022, Evidenca II.15.1 Pjesëmarrje në Panair Work and Study 2023; Evidenca V.4 Kalendarit i zhvillimit të ditëve të informimit të maturantëve; Evidenca V.4.1 Relacion mbi ecurinë dhe realizimin e ditëve të informimit të maturantëve; Evidenca V.4.3 Fletëpalosje Evidenca V.4.4 Poster Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë)			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Rregullorja e studimeve në Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë (Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë) dhe Rregullorja e Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë (Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Kreu VI,VII; Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, Neni 5, Neni 6) përcaktojnë qartë strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Në fillim të çdo viti akademik, NJBEMM organizon takim informues me studentët e vitit të parë të studimeve. ku informohen rreth procesit mësimor, strukturës mësimore të vitit akademik në të cilën detajohet kohëzgjatja e vitit akademik, ndarja e tij në semestra, si dhe periudha e provimeve, planit mësimor dhe lëndëve mësimore përkatëse, objektivave formuese të programit të studimit, Rregullores së Programit të studimit si dhe Rregulloreve të tjera Institucionale, vendndodhjes së auditorëve, laboratorëve mësimore, zyrave dhe sekretarive, orarit mësimor, orarit të shfrytëzimit të bibliotekës, përdorimit të faqes zyrtare web të Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë etj. Informacionet e mësipërme mund të aksesohen elektronikisht edhe nëpërmjet faqes zyrtare Web-it të Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë.
